

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PROGRAMI: MËSIMDHËNIE E GJUHËS DHE  
LETËRSISË SHQIPE**



## **TEZA MASTER**

**Përfaqësimi i shkrimtarëve të letërsisë së sotme në programet  
mësimore, klasa 6-9**

***Mentori:***

Prof. Asoc. Dr. Atdhe Hykolli

***Kandidatja:***

Shqipe Gashi

Prishtinë, Janar 2022



© [2021]-[Shqipe Gashi]

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

## Abstrakti

Nëpërmjet këtij punimi synohet të tregohet përfaqësimi i shkrimtarëve të letërsisë së sotme shqipe në programet e shkollave të Kosovës, nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë. Ne dijmë se ka shumë autorë të talentuar të letërsisë sonë për fëmijë dhe të rinj dhe se janë shumë produktivë me shkrimet e tyre, mirëpo neve na intereson të dijmë se si qëndron përfshirja e tyre në planprogramet mësimore të shkollave të Kosovës. Synohet të mësohet se a u është dhënë hapësirë e mjaftueshme që ata të flasin me lexuesit e tyre, për të cilët kanë krijuar dhe janë sakrifikuar duke pasur parasysh vitet e krijimit të tyre dhe gjendjen ekonomike e politike në Kosovë. Studimi do të realizohet duke mbledhur shkrimet e autorëve të cilët janë të përfshirë në planprogramet shkollore 6-9, por edhe shkrime nga studiuesit dhe kritikët e ndryshëm letrarë.

Gjuha dhe letërsia synon t'u përshtatet përherë e më mirë nevojave kumtuese të folësve. Mirëpo, këto nevoja kumtuese janë të lidhura me shkollimin, me arsimin, me kulturën e me faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë, të cilët, veç e veç e së toku, i shtrojnë njeriut nevoja më të mëdha kumtuese, për plotësimin e të cilave atij i lypset një sasi më e madhe mjetesh për t'u shprehur. Zhvillohen e përparojnë njerëzit, rriten dhe shumëfishohen kërkesat e tyre dhe kjo pasqyrohet edhe në gjuhë edhe në kulturë. Kjo arrihet kur kemi kulturë të leximit në shkolla dhe në shoqëri.

Ne do të mundohemi të tregojmë vendin që zënë autorët e letërsisë së sotme shqipe në librat e leximit të shkollave tona duke u mbështetur në plan programin mësimor të hartuar nga MASHT-i.

Qëllimi i hulumtimit është që duke ditur rolin dhe rëndësinë e autorëve të letërsisë së sotme shqipe dhe temat që ata kanë trajtuar të zgjojmë interesimin e brezit të ri për t'i njohur dhe përvetësuar idetë e tyre.

**Fjalët kyçe:** Letërsi e sotme, autorët përfaqësues, lexim, planprogram, etj.

## **Abstract**

This paper aims to show the representation of writers of the contemporary Albanian literature in Kosovo school curricula, from sixth grade to ninth grade. We know that there are many talented authors of our literature for children and young people and that they are very productive with their writings, but we are interested to know how their inclusion in the curricula of Kosovo schools is. The aim is to find out whether they have been given enough space to talk to their readers, about whom they have created and sacrificed given the years of their creation and the economic and political situation in Kosovo. The study will be conducted by collecting the writings of authors who are included in school curricula 6-9, but also writings from various scholars and literary critics.

Language and literature aim to adapt better and better to the communicative needs of speakers. However, these communicative needs are related to schooling, education, culture and other extralinguistic factors, which, separately and to the present, pose the greatest communicative needs to man, for the fulfillment of which he needs a greater amount of means of expression. People develop and prosper, their demands grow and multiply and this is reflected in both language and culture. This is achieved when we have a culture of reading in schools and in society.

We will try to show the place that the authors of today's Albanian literature occupy in the reading books of our schools based on the curriculum developed by MEST (Ministry of Education, Sports, and Technology).

The purpose of the research is to awaken the interest of the younger generation to know and acquire their ideas, knowing the role and importance of the authors of today's Albanian literature and the topics they have addressed.

**Keywords:** Contemporary literature, representative authors, reading, curriculum, etc.

## FALËNDERIM

Për realizimin e këtij punimi të temës së diplomës në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, niveli Master – Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit, falënderoj për zemërsisht së pari mentorin tim, Prof. Asoc. Dr. Atdhe Hykollin, për përkrahjen dhe bashkëpunimin në çdo kohë si dhe për të gjitha sugjerimet dhe angazhimin e palodhshëm që më ka ofruar gjatë realizimit të këtij punimi. Jam gjithashtu falënderuese ndaj anëtarëve të komisionit për punën dhe vlerësimin që kanë bërë në realizimin e këtij punimi të diplomës.

Falënderimi më i veçantë shkon për familjen time, të cilët më kanë mbështetur në çdo hap të shkollimit e deri në realizimin përfundimtar të këtij punimi.

Falënderoj gjithashtu të gjithë ata bashkëpunëtorë, mësimdhënës, si dhe miqtë e mi që më ndihmuan që ky punim hulumtues të marrë formatin e duhur dhe që më përkrahën deri në finalizimin e tij.

## Përmbajtja

Abstrakti .....	4
Abstract.....	5
FALËNDERIM .....	6
NË VEND TË PARATHËNIES.....	9
HYRJE.....	12
I. SHQYRTIMI I LITERATURËS .....	21
Gjatë shqyrtimit të literaturës hasa në shumë shkrime sa i përket përfaqësimit të autorëve të letërsisë së sotme shqipe si dhe kulturën e të lexuarit te nxënësit. ....	21
II. PËRFAQËSIMI I LETËRSISË SË TRADITËS NË LIBRAT SHKOLLORE.....	23
2.1. Tipet e prozës së Naim Frashërit .....	23
2.2. Klasifikimi i poezisë së Naim Frashërit.....	25
2.3. Fabulat e Naim Frashërit.....	27
2.4. Koristandin Kristoforidhi (1827-1895).....	28
III. FILLESAT E LETËRSISË BASHKËKOHORE SHQIPE .....	33
IV. LETËRSIA NË SHKOLLË.....	41
4.1. Përfaqësimi i letërsisë në shkolla.....	42
4.2. Formimi i kulturës së leximit në shkolla .....	43
4.3. Formimi kulturës letrare në shkolla .....	44
4.4. Teksti mësimor .....	45
V. STRUKTURA NË LIBRIN E LEXIMI LETRAR 6.....	49
5.1. Poezia lirike .....	49
5.2. Poezia atdhetare .....	50
5.3. Poezia e peizazhit.....	51
5.4. Poezi me tematika të ndryshme .....	51
5.5. Poezia epike .....	53
5.6. Përmbajtje e përgjithshme .....	54
5.7. Proza poetike.....	58
5.8. Lloje të tjera të prozës dhe të dramës .....	59
5.9. Struktura për përzgjedhjet letrare nga letërsia shqipe.....	59
5.10. Struktura për përzgjedhjet letrare nga letërsia botërore.....	62
5.11. Shkrimet joletrare dhe struktura didaktike.....	63

5.12. Qasja e veçantë për elementet letrare edhe joletrare.....	65
VI. STRUKTURA NË LIBRIN LEXIMI LETRAR 7.....	66
6.1. Poezia lirike .....	66
6.2. Poezi me tematika të ndryshme .....	68
6.3. Poezia epike .....	69
6.4. Krijimet në prozë e dramë .....	70
6.5. Përzgjedhjet në prozë nga letërsia shqipe .....	70
6.6. Krijimet në prozë poetike.....	72
6.7. Përzgjedhjet në prozë nga letërsia botërore .....	73
6.8. Krijimet në dramë .....	74
6.9. Tekstet joletrare .....	75
6.10. Qasja e veçantë për elementet letrare edhe joletrare.....	77
VII. ANALIZA E TË DHËNAVE .....	78
7. 1. Formulimi i problemit dhe qëllimet e hulumtimit .....	78
7. 2. Pyetjet e hulumtimit.....	78
7. 3. Hipoteza .....	78
VIII. METODOLOGJIA E PËRDORUR .....	79
8.1. Realizimi i pyetësorit .....	79
IX. REZULTATET E STUDIMIT .....	80
X. PËRMBLEDHJE .....	81
XIII. SHTOJCA.....	92



## NË VEND TË PARATHËNIES

Dokumentet kurrikulare hartohen mbi filozofi të ndryshme dhe: ndryshojnë krahas zhvillimeve në shoqëri. Ato ndryshojnë nga shteti në shtet edhe në të njëjtën periudhë kohore. Në këtë kontekst, mund të hasim dokumente kurrikulare apo kurrikula me mësuesin në qendër, me nxënësin në qendër, të orientuara në përmbajtje, në rezultate, në njohuri akademike, në nevojat reale të nxënësve, në lëndë mësimore, në lëndë të integruara apo fusha kurrikulare (Orstein &, Humnkins, 2003, fq.45), në standarde, në kompetenca të nxënies tërë jetësore, e filozofi të tjera, (Inistituti i Kurrikulës dhe Standardeve të Shqipërisë, 2007, fq.15-16).

Kështu, nëse Kosovës i bëjmë një retrospektivë tridhjetëvjeçare në fushën e arsimit, por edhe vendeve përreth, shohim se kurrikulat e tyre për këtë periudhë janë hartuar mbi filozofi të ndryshme. Kurrikulat, respektivisht Planet dhe programet mësimore të Kosovës para luftës së fundit (Minstra- e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës-së Kosovës, 1996), por edhe planet dhe programet e vendeve përreth (Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste dhe Autonome të Kosovës, 1989), të kësaj kohe, në qendër kishin përmbajtjen (Shatri, 2006, fq. 863), respektivisht temat dhe njësitë e lëndëve mësimore (Gashi, 1997, fq. 114). Puna e mësuesve ishte fokusuar në realizimin e përmbajtjeve të përcaktuara në planprograme: sipas afateve të parapara. Nxënësit ishin në pozitën e marrësit dhe në pozitën e reprodukuesve të informatave të marrura nga mësuesit dhe tekstet mësimore. E gjithë puna arsimore fokusohej në zhvillimin e njohurive faktike të nxënësve. Disa nga planprogramet e kësaj kohe ishin unike me Republikën e Shqipërisë, gjë që lë të kuptojmë se edhe kurrikula e Shqipërisë kishte këtë qasje.

Pas luftës, respektivisht në fillim të këtij shekulli kur në Kosovë filloi ristrukturimi i sistemit arsimor, u hartua Korniza e Kurrikulit të Ri (2001) që kishte për bazë apo pikënisje nxënësin. Ajo ishte e orientuar në fusha të kurrikulës, në objektiva dhe në rezultate të nxënies. Kjo filozofi veç ishte prezente në vendet e zhvilluara të kohës (Irlandë, Ontario, ShBA). Sipas kësaj qasje pikë referimi i gjithë organizimit të arsimit, respektivisht planifikimit, mësimdhënies dhe vlerësimit do të duhej të ishte nxënësi, gjegjësisht mundësitë, interesat dhe stilet e tij të nxënies. Puna arsimore do të duhej të fokusohej në përgjigjen e pyetjes Si? Si të zhvillohen njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat te secili nxënës? Rëndësi t'u kushtohej procedurave të zhvillimit të tyre. Sllogani i të nxënit ishte të mësojmë si të mësojmë. Tërë

filozofia e kurrikulës mbështetej në katër shtyllat e Delorit (UNESCO, 1996) si: të mësosh për të ditur, për të vepruar, për të qenë dhe për të jetuar së bashku. Mbi këtë filozofi deri diku u hartuan edhe planet dhe programet mësimore të viteve 2002-2006.

Vitet e fundit shumica e shteteve të Evropës, kurrikulat e tyre i kanë mbështetur në filozofinë e zhvillimit të kompetencave të nxënies tërë jetësore. Kjo filozofi promovon nxënien gjithëpërfshirëse, mësimdhënien dhe nxënien e integruar, të pavaur dhe në bashkëpunim. Ajo ka për qëllim përgatitjen e qytetarit që do të jetë i gatshëm të përballlet me sfidat e shekullit XXI, për çka po synon edhe kurrikula e Kosovës (2011). Në të ardhmen ndoshta do të hartohen dokumente kurrikulare mbi filozofi të reja, sepse këtë e kushtëzojnë zhvillimet shoqërore. Më poshtë do të kemi mundësi të shohim se si shtetet e Evropës, por edhe Kosova u janë qasur zhvillimit të kompetencave.

Dokumentet kurrikulare strukturën përmbajtjesore dhe funksionale e mbështetin në teori të ndryshme të nxënies. Kjo vërehet në qëllimet dhe parimet e kurrikulës, në nivelet e arritshmërisë të shprehura në formë të objektivave, standardeve apo rezultateve të nxënies, në përmbajtjet mësimore, në planet mësimore, në mësimdhënie dhe në vlerësim, përkatësisht në të gjitha elementet e kurrikulës, varësisht se si është strukturuar ajo.

Kurrikulat aktuale të vendeve të zhvilluara por edhe të atyre në zhvillim janë ndërtuar mbi një kombinim të disa teorive. Në to hasen Teoria e Piazhësë, Teoria Vigotskit (Woolfolk, 2011, fq. 48), Teoria Bihevisoriste (Musai, 1999, fq. 93-94), Teoria Konstruktiviste, Inteligjencat e Shumëfishta të studiuara nga Gardneri (Gardner, 2003, fq. 191-218), Hierarkia (taksonomia) e Blumit (Grup autorësh, 1997, fq. 106-126) e taksonomi të tjera të fushave afektive e psikomotorike. Ato i mundësojnë shkollës, përkatësisht mësuesve që të marrin parasysh dëshirat, interesat, potencialet, stilet dhe përvojat e nxënies, si dhe kulturën dhe mjedisin në të cilën edukohen nxënësit për të zhvilluar te ta njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet, vlerat e tyre individuale dhe shoqërore. Të gjitha këto karakteristika mundësojnë mësimdhënien efektive dhe të nxënies së suksesshme dhe janë pjesë e studimeve të teorive të lartpërmendura.

Kurrikula e orientuar në objektiva thuhet se mbështetet në Teorinë Bihevisoriste, sepse zhvillimi i njohurive dhe i shkathtësive varet nga efektiviteti i stimuljeve dhe ndjek një vijë të nxënies, respektivisht të nxënies bëhet përmes mësimin lëndor. Ndërsa kurrikula e orientuar në rezultatet e të nxënies mbështetet në Teorinë Sociokonstruktiviste, sepse promovon të nxënies

duke ndërvepruar dhe të nxënit gjithëpërfshirës apo holistik. Reforma e kurrikulës në arsimin parauniversitar në Kosovë përbën një nga shtyllat kryesore të reformës së sistemit të arsimit në Kosovë, e cila synon të sigurojë rritjen e kompetencave të nxënësve në përputhje me trendet ndërkombëtare dhe kërkesat e shoqërisë. Nga ana tjetër kërkesat e reformës së kurrikulës janë mjaft sfiduese dhe komplekse që kërkojnë një qasje të kujdesshme për futjen në sistem të zbatimit të kurrikulës së re në të gjitha shkollat e Kosovës. Një nga kërkesat e kurrikulës së re është që shkolla vetë të hartojë planet dhe programet mësimore për lëndë dhe klasë, duke u bazuar në Kurrikula Bërthamë për shkallët dhe nivelet përkatëse të arsimit parauniversitar. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është në vitin e dytë të pilotimit të kurrikulës së re. Pilotimi i kurrikulës në vitin e parë (2013/2014) përfshinte 10 shkolla, ndërsa në vitin e dytë (2014/2015) janë shtuar edhe 82 shkolla, duke përfshirë Shkolla Fillore, Shkolla të Mesme të Ulëta, Gjinnaze dhe Shkolla profesionale. Përkundrajt faktit se jemi në vitin e dytë të pilotimit të kurrikulës, akoma nuk është bërë një vlerësim gjithëpërfshirës i procesit të pilotimit të kurrikulës, i cili do të orientonte në rishikimin apo plotësimin e dokumenteve kurrikulare dhe zhvillimin e materialeve mbështetëse për shkolla, mësimdhënës dhe sektorë të tjerë të arsimit të përfshirë në procesin e zbatimit të kurrikulës. Për të gjykuar nëse procesi i zbatimit të kurrikulës së re është duke ecur mirë në fazën e pilotimit dhe pritet që t'i kontribuojë shtrirjes së zbatimit të kurrikulës së re në shkallë vendi, është e nevojshme që të kryhen analiza dhe vlerësime të ndryshme dhe krahasime të rezultateve të arritura për këtë proces. Kësaj kërkese, pritet t'i kontribuojë ky studim modest i mbështetur në vlerësimet e shkollave që janë duke e pilotuar kurrikulën e re. Zhvillimi apo rishikimi i kurrikulave është proces që lidhet me ndryshimet në arsim dhe ka për qëllim t'i përgjigjet sfidave me të cilat ballafaqohet shoqëria, apo t'u përshtatet zhvillimeve në shoqëri, arritjeve në shkencë, teknologji, arritjes së vizionit që e përcakton shoqëria për të ardhmen, etj. Arsyeshmëri të tilla, të përafërta me këtë që u tha më lart, gjejmë në shumicën e kurrikulave të zhvilluara në këto vitet e fundit. Këtë e gjejmë edhe në hyrje të dokumentit të Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë, ku theksohet se zhvillimi i kurrikulës së re është bërë me qëllim të ballafaqimit me sfidat, si: nevoja për ndërtimin e një shoqërie të dijes, integrimi në epokën digjitale, rritja e ndërvarësisë dhe e lëvizshmërisë, të mësuarit për të jetuar së bashku, zhvillimi i qëndrueshëm (MASHT /KKK, 2011 fq. 10).

## HYRJE

Tema që kam zgjedhur për punim diplome në studimet Master është mjaft sfiduese në vete. Për faktin se trajtimi, hulumtimi për letërsinë kërkon qasje serioze, të kujdesshme dhe permanente. Aq më tepër që tema e ime ka specifika të veçanta pasi ka për hulumtim përfshirjen e autorëve të letërsisë së sotme në programet shkollore.

Përmes këtij punimi përpiqem që të pasqyroj në mënyrë sa më objektive praninë e autorëve të ditëve të sotme në librat e letërsisë shkollore. Duke pasur për synim që të vlerësohet drejtë e sa më saktë përfshirja e tyre në plan-programe e tanishme dhe nga hulumtim do të dalin përfundime e rekomandime nëse duhet të këtë një hapësirë më të gjerë në plan-programet e lëndës "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" për këtë etapë të letërsisë dhe veprat autorëve të saj apo është e mjaftueshme kjo hapësirë që zënë sot ose edhe të sugjerohet ndonjë e gjetur nga hulumtimi kësaj teme. Punimi do të jetë i ndarë në tre kapituj. Ku secili kapitull do të mundohet të pasqyroj dhe ta trajtoj në thelb tezen e vet. Në kapitullin e parë trajtoj fillimet e letërsisë së sotme/bashkëkohore shqipe, përfaqësuesit kryesor të saj dhe rolin në zhvillimin e kësaj etape të letërsisë gjër në ditët e sotme. Me pas veprat që mund të konsiderohen se sollën letërsinë e sotme dhe që vazhdojnë ta pasurojnë atë. Kapitulli i dytë ka për fokus hulumtimin e përfshirjes së autorëve të sotëm në programet shkollore. Niveli i pranisë së veprave të tyre në plan-programet shkollore, si dhe të vlerësohet nëse është mjaftueshëm e pasqyruar në programet e shkollave letërsia e sotme shqipe. Po ashtu, të observohet/analizohet lënda "Gjuhë e letërsi shqipe", gjegjësisht materialet që u ofrohen nxënësve për letërsinë e sotme shqipe. Ndërsa kapitulli i tretë që është edhe kapitulli i fundit trajton autorët kryesor të kësaj faze transformuese shumë të rëndësishme të letërsisë shqipe. Shkrimtarët si Migjeni, Lasgushi e deri të Podrimja e Kadare i kanë dhënë hovë dhe ngjyrë tjetër letërsisë shqipe në përgjithësi duke e vendos atë në hartën e letërsive botërore. Ky kapitull përmes veprave të tyre do të përpiqet të paraqes ndikimin në formësimin e përgjithshëm letrar të nxënësit por edhe të mësimdhënësit në qasje sa më adekuate ndaj kësaj epoke letrare.

Përmes këtyre kapitujve synoj që të përmbledh dhe të hulumtoj aq sa mundem për përfshirjen në programet shkollore të Kosovës, të letërsisë së sotme shqipe dhe njohurive që kanë nxënësit për këtë periudhë letrare dhe ndikimit të saj tek ta.

Për këtë punim të diplomës kam realizuar një pyetësor me nxënës dhe arsimtarë dhe kam bërë intervista me njohës të letërsisë për të arritur në përfundime sa më relevante. Pyetësorin dhe shumicën e intervistave i kam zhvilluar në shkollën ku punoj (SHMT “Skënder Luarasi”), por kam zhvilluar edhe intervista të pa standardizuara me kolegë të profesionit, të shkollave tjera. Përmes këtyre aktorëve dhe metodave tjera hulumtuese kam tentuar që të “godas” në shenje trajtimin e mirëfilltë të temës sime.

Ajo që më ka shtyrë që në mënyrë sa më unike të zgjedh të bëjë këtë temë për punim diplome sa do të thjeshtë është ndjesia që kam për këtë periudhë të letërsisë që vazhdon edhe në ditët e sotme. Për vlerat që ka dhe për efektin jo vetëm letrar por edhe jetësor që mund të lë tek nxënësit. Përmes këtij punim tentohet që të nxitet edhe me shumë leximi në tërësi të nxënësit e njëkohësisht me këtë edhe fokusi tek letërsia dhe krijuesit e sotëm shqiptar.

Shpresoj që punimi i do të jetë kontribut dhënës për nxënësit, kolegët e mi dhe të gjithë studiuesit e të pasionuarit e letërsisë, e në veçanti ata/ato të letërsisë së sotme shqipe. Në fund të punimit do të mundohem të jap edhe rekomandimet përkatëse lidhur me përfshirjen e letërsisë së sotme shqipe në plan programet shkollore të lëndës "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe".

### **Objekti i temës**

Tema e ime, për objekt hulumtimi ka studimin, analizimin, vëzhgimin apo observimin e përfshirjes së letërsisë së sotme shqipe në programet shkollore të Kosovës. Jam e vetëdijshëm se letërsia ka edhe etapa, përudha e faza të tjera të saj po aq të rëndësishme, të cilat kanë qenë pararendëse të letërsisë së sotme. Por, fokusi i im do vazhdoj të mbetet thellësisht në hulumtimin e temës bosht, në përpjekje permanente për t'i dhënë përgjigje sa më të thukët tezave të mia fillestare.

Përmes kësaj teme tentohet që të vlerësohet niveli i përfshirjes së letërsisë së sotme në plan programet e lëndës përkatëse si dhe afektimi që kanë nxënësit ndaj kësaj faze letrare por edhe mënyra se si transmetohet nga mësuesit e Gjuhës kjo periudhë letrare. Nga gjithë kjo do të qartësoheshin intervenimet e mundshme që mund të bëhen në programe.

### **Qëllimi i temës**

Qëllimi i temës është në korrelacion me objektin e hulumtimit dhe është i orientuar drejt përcaktimit të hartimit të politikave, rekomandimeve, përfundimeve, teknikave të ndryshëm e deri në fillesat e një kurrikule të përgjithshme edhe për lëndët e tjera në shërbim të

përmirësimit dhe fitimit të njohurive shtesë dhe të domosdoshme, jo vetëm për një periudhë letrare ose lëndë por nga ky studim të shihet mundësia edhe për vlerësime të lëndëve tjera. Pra nga induksion drejt deduksionit. Për të arritur një qëllim të tillë duhet një sinkronizim i thukët i të gjithë atyre që përballen çdo ditë me sfidën e mësimdhënies dhe mësim nxënies. Dhe prijës i këtij “karvani” duhet të jetë arsimtari/ja, profesori/profesoresha e lëndës, gjegjëse si njohës/njohëse me i/e mirë dhe saj në ndryshime pozitive për nxënësit dhe mësimdhënësit.

### **Rëndësia e temës**

Programet shkollore janë një sfide e përhershme e sistemit arsimor, e hartuesve të tyre dhe në masë të madhe kjo sfidë rëndon të mësimdhënësit si zbatues të atyre programeve shkollore. Nga aty profesorët mund të vlerësojnë nëse në programet përkatës janë në koordinim me mundësitë, kapacitetet absorbuese që kanë nxënësit. Çdoherë duke vënë nxënësin në qendër, duke pas parasysh se çfarë është e nevojshme që ai të mësoj nga çdo lëndë, çdo kapitull e çdo periudhë letrare në këtë rast, periudhën e Letërsisë së sotme shqipe dhe përfaqësimit të autorëve të saj.

Njëkohësisht me këtë autoritetet hartuese të plan programeve duhet të kërkojnë/dëgjojnë sugjerimet e mësimdhënëseve në mënyrë që të ofrohen programe me të përshtatshme, me kualitative e adekuate që nxënësit të arrijn nivele me të larta të njohurive specifike e të përgjithshme.

Me këtë, mund të kuptojmë se për të arritur këtë shkallë të reflektimit na duhet bashkërenditje e të gjithë faktorëve që ndërlidhen direkt me hartimin e programeve dhe vlerësimin e tyre. Andaj, rëndësia e trajtimit të kësaj teme qëndron në vlerësimin se deri në çfarë mase janë të përfaqësuar autorët e letërsisë së sotme shqipe dhe a janë të përfaqësuar në mënyrë të duhur në programet shkollore. Dhe një temë e këtij lloji mendoj, është rëndësishme dhe në koherencë me sfidat që përballen sistemi arsimor i vendit tonë.

Ballafaqimi i ditëpërditshëm me tekstet mësimore e bëri të pashmangshëm edhe thellimin mbi to. Vetë puna e përditshme me libra, e që në njëfarë forme është bekim, ngjalli një kureshtje për mënyrën se si hartohen këto tekste, përmbajtjen didaktike dhe krahasimin me tekste të tjera qoftë brenda Kosovës, qoftë në rajon.

Në anën tjetër mungesa e hulumtimeve, ani pse kohëve të fundit janë në rritje, në kriteret e hartimit të teksteve shkollore dhe, njëkohësisht, paraqitja e shumë problemeve në këto tekste e

bën të nevojshme interesimin e secilit që sadopak ka mundësi. Ndërkaq, rëndësia e teksteve cilësore për nxënësit e klasave përkatëse është përcaktuese edhe për të ardhmen e shoqërisë. Prandaj, gërvishtja sado e vogël që mund të bëhet nga secili, është një kontribut i rëndësishëm për brezat e rinj.

Cilësia e teksteve mësimore është reflektim i një arsimi cilësor në vend. Ndërkohë, çdo hulumtim me idenë e krijimit të alternativave për përmirësimin dhe pasurimin e teksteve mësimore, është e barasvlershme me ngritjen e kësaj cilësie në arsim. Në këto kohë, ndoshta teksti mësimor nuk e ka rolin e mëparshëm, por megjithatë, ai është njëri ndër burimet e pazëvendësueshëm të informacioneve. Andaj, si i tillë nuk guxon të jetë jociësor. Problemet e gjetura në tekstet e tanishme, sidomos ato të pjesës didaktike, assesi nuk duhet të shndërrohen në argumente të hedhjes poshtë të çdo gjëje. Përkundrazi, si edhe në këtë punim, këto probleme duhet të drejtohen mbi logjikën e shëndoshë, e cila vlerëson atë që është dhe jep rekomandime se si duhet të jetë edhe më mirë se siç është. Kjo frymë logjike përshkon edhe tërësinë e këtij punimi, i cili, pavarësisht gjithçkaje, tenton të nxjerrë disa rekomandime për tekstet në të ardhmen, e të cilat shpejt priten të ndryshojnë.

Megjithëkëtë, më shumë se rekomandime e probleme, në këtë punim paraqitet një pasqyrë e tërësishme e strukturës didaktike në tekstet e Leximit letrar VI dhe Leximit letrar VII me autorë dhe botues të ndryshëm. Aty-këtu, gjatë procesit të punës, duke nxjerrë këtë pasqyrë dhe duke i krahasuar mes vete shihen edhe hapësira që mund ta plotësojnë njëra-tjetrën. Vlerë e shtuar në këtë punim janë edhe përgjigjet e oponentëve që merren çdo ditë me tekstet, pra e arsimtarëve/eve dhe nxënësve/eve.

Fillet e letërsisë shqipe për fëmijë në Kosovë, posaçërisht poezisë, i venerojmë në kohën e LNC-së (të ashtuquajtur atëbotë), kur botoheshin buletine, fletushka ilegale, si dhe revista “Zani i popullit” dhe “Liria”, e kur poezitë dhe prozat e tyre i botojnë: Mark Krasniqi, Fadil Hoxha, Mehmet Hoxha, Hajdar Dushi, Nexhip Habibaj, Hivzi Sulejmani, Tahir Jaha' etj., shumë sish ishin të pranishëm edhe te fëmijët, edhe pse nuk ishin të shkruara për këta lexues.

Pra, derisa në Kosovë pas vitit 1941 filluan të hapeshin shkolla në gjuhën shqipe, falë angazhimit të ish-ministrit të atëhershëm Ernest Koliqi, i cili kishte dërguar më se 200 mësues nga Normalja e Elbasanit, në Kosovë filluan të dalin edhe revistat e gazetatat në gjuhën shqipe, si: “Rilindja”, “Pionieri”, “Gazeta e pionierëve”, “Jeta e re”, “Përparimi” etj., kur krijimtaria

për fëmijë fillon të zhvillohej më hovshëm se kurrë më parë. Po kështu, fill pas daljes së “Gazetës së pionierëve” që dilte në Prishtinë, katër vjet më vonë, më 1950 në Shkup filloi të dalë edhe revista për fëmijë “Gëzimi”, të cilat atëherë e loznin një rol shumë të rëndësishëm për të botuar dhe për ta zhvilluar letërsinë shqipe në Kosovë, Maqedoni dhe më gjerë. Kështu, atëbotë veç sa u themelua shtëpia botuese “Mustafa Bakija”, e cila më vonë do ta merrte emrin “Rilindja”, në Prishtinë. Në fillim zunë të botohen disa nga veprat e klasikëve të njohur të letërsisë për fëmijë, si: “Princesha e shtatë vëllezërit e Pushkinit, “Timuri dhe çeta e tij” dhe “Dimka” të Gajderit, “Përralla” e Krillovit, “Udhëtimet e Guliverit” e Sviftit, “Liza në botën e çudive” e Karolit etj., si dhe botimi i ca veprave të autorëve jugosllavë, si të Nazorit, Lovrakut, Aleksiqit, Dikligit etj. Por, që nga viti 1953 edhe në Kosovë filloi botimi i librave për fëmijë nga vetë autorët tanë shqiptarë, si botimi i përmbledhjeve “Gjethet e reja” e Rexhep Hoxhës, “Përrallat e gjyshit” e Mark Krasniqit, “Vjersha” të Mehmetali Hoxhës dhe Lutfi Rusit etj (Musai, B, 2003).

Pra, letërsia shqipe për fëmijë në Kosovë, që nga viti 1953 e këtej e filloi një zhvillim më të hovshëm, kur me penat e tyre filluan të shkruanin jo vetëm nëpër gazeta e revista, të cilat ishin bërë literaturë e domosdoshme për të ndihmuar dhe kultivuar krijimet artistike për fëmijë, e më vonë do të dalin edhe shume krijues të mirëfilltë të kësaj letërsie, e cila u begatua me zhanre e gjini të ndryshme.

Letërsia shqipe për fëmijë pothuajse deri në fund të viteve të '50-ta, qoftë në Shqipëri, Kosovë e gjetiu, te të gjithë krijuesit shqiptarë ishte në vazhden e traditës, meqë në krijimet e tyre pikë takoheshin qoftë gjuha, stili, figuracioni, forma, konceptimi, fusha asociative e koncepcioneve etj., edhe pse aty-këtu, tek ndonjë krijues vërehej ndonjë “thyerje rregullash”, ku shfaqej ndonjë risi që jepte shenjë se do ta pritnim brezin tjetër paksa me risi që dallonte nga pararendësit. Ky brez krijuesish më të avancuar apo me shprehje më modernë nëpërmjet formës, gjuhës, stilit dhe figuracionit do të duket gjatë viteve të “60-ta. Megjithatë, ne në këtë rast do të përqendrohemi te periudha e brezit të parë të shkrimtarëve shqiptarë në Kosovë, të cilët kush më pak e kush më shumë ishin të lidhur ngushtë me traditën, e ku ndikimet e shkrimtarëve të traditës, si të Naim Frashërit, Asdrenit, Ndre Mjedës, Qamil Guranjakut e ndonjë tjetri ndikuan edhe te Rexhep Hoxha, Mark Krasniqi, Mehmedali Hoxha, Anton Çetta, Vehbi Kikaj e te disa të tjerë, ishin evidente. Këto ndikime kryesisht shquheshin për strukturën



kompoziconale, ku mbizotëronte strofa katrena (katërvargëshe), nota e theksuar e didaktizmit, si dhe mënyra e realizimit të krijimeve të tyre, me përjashtim të disa të tjerëve që po bënin përpjekje për të sjellë risi, qoftë në formë, apo në përmbajtje. Karakteristikë e veçantë e këtyre krijuesve ishte se krijimet e tyre, posaçërisht poezia, sikur i qëndronte besnike rrugës së trasuar nga pararendësit, si fundament për t'i orientuar sidomos poetët e rinj, ku me po ato forma dhe figura mundoheshin të jenë në vazhdimësinë e traditës po me rimë e ritëm, strofa dhe figuracion si më parë, atë çfarë e kishin trashëguar më parë dhe që s'kishin dashur apo s'kishin ditur t'ia linin formës a përmbajtjes së të shkuarit me fjalën e shkruar që e kishin vënë në shërbim të popullit në edukimin e brezave të rinj, nga të cilat në fund të viteve të '60-ta do të dalin disa krijues të rinj, sidomos gjatë viteve të '70-ta, që do të sjellin risi në letërsinë shqipe në Kosovë. Siç vërehet, poezia jonë për fëmijë, si ajo për të rritur, "Me vlerat më të shquara është vazhdim i kësaj tradite, (Qosja, R., 1986) e cila, natyrisht, në rrjedhat e saj më vonë inkuadron me ndjeshmëri të re në transformimin e jetës bashkëkohore në afirmimin e hapësirës së fëmijërisë dhe gërshetimin e humorit, lojës dhe imagjinatës, si tre komponentë shumë të rëndësishëm të artit për të vegjlit, duke derdhur në tërë këtë frymëzim edhe diçka të traditës të së kaluarës sonë pozitive.

Studimet e deritashme kanë hedhur dritë mbi fillimet e letërsisë shqipe gjatë kësaj periudhe, pas Luftës së Dytë Botërore e këtej, kur zanafillën e saj e karakterizojnë krijimet letrare publicistike, e cila është etapa e parë e formimit si letërsi, e që më vonë, gjatë viteve '50, 60, \*70 e këtej vjen duke u pasuruar si në formë, ashtu edhe në përmbajtje, si në aspektin sasior, po ashtu edhe në atë cilësor. Gjatë kësaj periudhe (1945-1960), derisa në Shqipëri, krahas poezisë, mori hov dhe u zhvillua dukshëm edhe proza e shkurtër, ndërsa në Kosovë krijuesit për fëmijë numëroheshin me gishtërinjtë e dorës, d.m.th. ata si më të afirmuar ishin 4-5 veta, si: Rexhep Hoxha, Mark Krasniqi, Anton Çeta, Vehbi Kikaj, Rrahman Dedaj, Rifat Kukaj etj (Elshani, Y, 1985).

Pra, derisa periudha (1945-1950 ) konsiderohej si etapa e provës së letërsisë për fëmijë që ishte në rrugën e realizimit socialist, letërsia e viteve '50-60 konsiderohej si etapa e dytë e periudhës së formimit më të avancuar të saj me synim përpjekje për të arritur dhe kaluar në gjinitë e mëdha, si në prozë, ashtu edhe në poezi. Kështu, zotërimi gjithnjë e më mirë i metodës krijuese artistike, njohja më e thellë e jetës, e botës së brendshme dhe interesave të

fëmijëve, si dhe fitimi i përvojës në këtë fushë të krijimtarisë çoi një numër shkrimtarësh të brezave të ndryshëm, që nga vitet e '50-ta e këtej, drejt pasqyimit më të gjerë të jetës. Ky ndryshim, avancim i kësaj letërsie gjeti shprehje në sa e sa vepra letrare, në poezi e më vonë në prozë, e aty-këtu edhe në dramën në Kosovë, sidomos në fillim të viteve të '60-ta e këtej (Shita, V, 1980).

Tashmë edhe në Kosovë numri i krijuesve filloi të shtohet nga brezi në brez, ata po shtoheshin nga viti në vit, e që më vete ata po sillnin forma, stile, motive dhe konceptione më të avancuara në letërsinë për fëmijë (Boriqi, H., 1977).

Derisa në letërsinë shqipe mund të numërojmë një varg veprash të mira, me një dinjitet letrar për të vegjlit, me frymë të shëndoshë edukative, siç janë veprat (romanet): “Shpella e Piratëve” e Petro Markos, “Debatiku” e “Djemtë e lagjes sonë” e Sylejman Vaqarit, novelat “Ciku e Beni” e Naum Priftit, “Ne gjahtarët e fshatit dhe Lica jonë e dashur” e Loni Papës, mandej përmbledhjet e tregimeve të Tefik Gjylit “Piciruku”, “Shqiponjat e vogla” e Kole Jakovës, “Briarta” dhe “Mbreti i divave” të Shefqet Musarajst “Na hoqën çatinë” e Aleks Çaqit, “Letër nga fqinjët” e Gjergj Vlashit, “Dhurata më e bukur”, “Tregimet” e Mojsi Zaloshnjës, “Kujtime fëmijërie” e “Lotët e natës” të Sotir Andonit, “Baloshi”, “Kur isha i vogël” të “Ligor Dodani”, përmbledhja e përrallave të Dhimitër Paskos, “Xinxifilua”, vjershat e Sotir Comores, “Çil, çil trëndafil”, libri i parë i Ziko Cikullit për fëmijë “Lepurushet higjienushet”, mandej tregimet për fëmijë të moshës parashkollore, vjershat e Adelina Mamaçit nga libri “Bubi i vogël”, përmbledhja e vjershave të autorëve të tjerë, si Xhevat Beqaraj, Odhise Grillo, Ramadan Pasmaçi, Bardhosh Gaçe, Xhevahir Spahiu, Shpresa Vreto, Dionis Bubani, Sulejman Meto, Petraq Risto etj (Shita, V, 1980).

Dihet mirëfilli se te ne në Kosovë, që në fillim të zanafillës, me letërsisë shqipe për fëmijë filloi të merret një numër i gjerë njerëzish, shtresash të ndryshme, si: nxënës, arsimtarë dhe punëtorë të tjerë të kulturës, në fillim me përmasa më të vogla, e më vonë gjithnjë e më shumë. Kështu filloi të funksionojë kjo letërsi. Në këtë drejtim, kontribut të madh dhanë edhe letrarët e shquar, që shkruanin edhe për të rritur, ata të letërsisë shqipe për fëmijë, si: Esad Mekuli, Tajar Hatipi, Enver Gjerqeku, Josip Rela, Rexhep Hoxha, Anton Çetta, Mark Krasniqi, Maksut Shehu, Azem Shkreli, Anton Pashku dhe disa të tjerë, të cilët dhanë shumëçka nga opusi i tyre i gjithmbarshëm letrar. Pra, nëpërmjet një numri të madh të rinjsh e

fëmijësh që paraqiten në të përkohshmet e tyre "Pionieri" e "Harabeli" në Prishtinë, "Gëzimi" e "Fatosi" në Shkup, pastaj në faqet e fëmijëve të gazetave "Rilindja" e "Flaka e vëllazërimit", në revistat "Zëri i rinisë", "Shëndeti" etj., një plejadë e tërë shkrimtarësh paraqitet me përmbledhjet e veta të vjershave, tregimeve, ose edhe me romane për fëmijë, si: Tajar Hatipi, "Rrethimi"; Mark Krasniqi, "Borëbardha", "Posta e porositur" e "Drita e parë"; Esad Mekuli, "Drita"; Rexhep Hoxha, "Gjethet e reja", "Picimuli", "Mbi krahët e fluturës" e "Vjersha" dhe romani "Lugjet e verdha"; Maksut Shehu, "Kunora e kuqe", "Jemi dy motra", "Kangë maji", romani "Nipi i minatorit" etj., vepra këto që e begatuan letërsinë tonë shqipe, si me sasi, po aq edhe me cilësi (Shita, V, 1980).

Ndërkaq, më vonë, gjatë viteve të mëvonshme shfaqet një plejadë e tërë shkrimtarësh të rinj, të cilët merreshin kryesisht me letërsinë për fëmijë, si: Vehbi Kikaj me "Gurrat" dhe "Zogu i argjendtë"; Rrahman Dedaj, "Mëshehtësia"; Qamil Batalli, "Buzëqeshjet"; Rifat Kukaj, "Harmonika e vogël", "Rrëfejzat", "Gjerdani i blertë"; Ali Huruglica, "Zani i zemrës", e Abdylazis Islami me veprën "Mëngjesi në fshat" (Shita, V, 1980).

Më vonë, krahas këtyre krijuesve shfaqen edhe krijimet letrare për fëmijë, si nga: Gani Luboteni, Ali D. Jasiqi, Mirko Gashi, Sylë Rama, Zija Berisha, Ymer Elshani etj (Shita, V, 1980).

Në veprën "Poezia shqipe për fëmijë" (1872-1980), prof. dr. Agim Deva konstaton se vargu i atyre kritikëve dhe historianëve të letërsisë në një mënyrë, apo në një tjetër, e dha dhe e tha fjalën e tyre lidhur me ndonjë çështje të letërsisë për fëmijë. Është i gjatë vargu që kap afër njëqind emra (konstaton prof. dr. A. Deva), prej të cilëve duhen veçuar studiuesit më cilësorë: Bedri Dedja, Vehbi Bala, Muzafer Xhaxhiu, Hasan Mekuli, Hamit Boriçi, Adriatik Kallulli, Vehap Shita (Deva, A, 1982) si dhe shumë të tjerë.

Në studimin e lartpërmendur, varësisht nga temat, motivet dhe qasjet tjera, nëpër periudha të ndryshme të zhvillimit të letërsisë shqipe për fëmijë gjatë etapës kohore (1972-1980) d.m.th. brenda përbrenda një shekulli e gati një dekade (plot 108 vjet) të plota të historikut të letërsisë shqiptare.

Me këtë rast, sipas kriterit alfabetik do t'i përmendim poetët më në zë shqiptarë, sipas burimeve të hulumtuara nga prof. dr. Agim Deva:

Dritëro Agolli, Vehbi Bala, Qamil Batalli, Anton Berisha, Nol Berisha, Xhevat Beqaraj, Dionis Bubani, Skender Buçpapaj, Nonda Bulka, Tino Bushi, Qamil Buxheli, Gjon Buzuku, Fasil Canaj, Qerim Capi, Aleks Çaçi, A. Z. Çajupi, Fehrat Çakërri, Koço Çamçe, Qamil Çami, Behxhet Çerma, Anton Çetta, Jakup Çitaku, Miranda Dule, Ymer Elshani, Zymer Elshani, Kristo Floçi, Naim Frashri, Sami Frashëri, Bekim Gaçe, Pëllumb Gaçe, Sandër Gega, Luigj Gurakuqi, Qamil Gurakuqi, Milto Sotir Gurra, Fatmir Gjata, Enver Gjerqeku, Mehmet Gjevori, Tasim Gjokutaj, Arif Gjyli, Teufik Gjyli, Nexhip Habibaj, Zejnullah Halili, Bekim Harxhi, Hasan Hasani, Tajar Hatipi, Skender Hasko, Mehmedali Hoxha, Rexhep Hoxha, Ali Huruglica, Abdylaziz Islami, Nehat Islami, Tahir Jaha, Kolë Jakova, Sokol Jakova, Nasho Jorgaqi, Zef Jubani, Ismail Kadare, Ibrahim Kadriu, Miliovor Kallupi, Muhamet Kërveshi, Vehbi Kikaj, Vedat Kokona, Mark Krasniqi, Alqi Kristo, Konstandin Kristoforidhi, Rifat Kukaj, Lutfi Lepaja, Adelina Mamaqi, Hamdi Meqaj, Esad Mekuli, Ndre Mjeda, Naim Morina, Hilë Mosi, Shefqet Musaraj, Marta Naraçi, Papa Kristo Negovani, Millosh Gjergj Nikolla, Loni Papa, Ramadan Pasmaxhiu, Lasgush Poradeci, Naum Prifti, Ilo Qafëzezi, Gjerasim Qiriazi, Bedri Rama, Josip Relaj, Latif Rusi, Zihmi Sako, Llazar Siliqi, Afërdita Skënderi, Gani Spahiu, Hivzi Sulejmani, Avdi Shala, Maksut Shehu, Filip Shiroka, Ymer Shkreli, Skender Tapia, Faruk Tasholli, Shpresa Vinca-Tuda, Abdulla Thaçi, Hasan Ulqini, Selman Vaçari, Nuhi Veselaj, Nuhi Vinca, Vasil Xhaçko, Gani Xhafolli, Moisi Zaloshnja, Moikom Zeqo etj (Deva, A, 1982).

Letërsia shqipe për fëmijë në Kosovë, që nga fillimi (së pari në periodik, gazeta, revista) e deri më tash është zhvilluar në rrethana, kushte nga më të ndryshmet, por kontinuiteti i saj është ruajtur nga brezi në brez, duke marrë mësim edhe nga letërsitë e kombeve e kombësive, me qëllim që të bëhet sa më e plotë, por në plan të parë duke bërë përpjekje të pareshtura që të ruhet identiteti i saj ashtu siç duhet.

## I. SHQYRTIMI I LITERATURËS

**Gjatë shqyrtimit të literaturës hasa në shumë shkrime sa i përket përfaqësimit të autorëve të letërsisë së sotme shqipe si dhe kulturën e të lexuarit të nxënësit.**

Qëllimi kryesor i shqyrtimit të literaturës nga ana jonë është që t'i jap kërkuesit (dhe lexuesit) një kuptim mbi dijen mbi kërkimin e propozuar, që do të jetë gjithashtu synimi ynë gjatë realizimit të këtij punimi.

Gjatë realizimit të këtij punimi vetëm literatura shkencore do të përfshihet në shqyrtimin e literaturës, kjo literaturë përfshinë: librat bazë, revistat profesionale, librat teorikë, monografite universitetare, librat akademik, librat studiues shkencor, dhe jo çdo lloj literature.

Për këtë fushë kanë shkruar dhe kanë kontribuar shumë autor, si: Rexhep Qosja, Sabri Hamiti, Xhevat Sylaj, Bardhyl Musai etj.

Libra nga autorë të tjerë ka pak rreth kulturës së leximit dhe komunikimit me shkrim të nxënësve në shkollat tona.

Të gjitha këto që u përmendën e ka edhe shumë të tjera do të më ndihmojnë rreth këtij hulumtimi. Gjithashtu ndihmesë do të jetë edhe hulumtimi në dy shkolla të mesme të ulëta në Kosovë (SHMU).

Sa i përket shqyrtimit të literaturës do të bëjmë një përmbledhje të qëllimshme të asaj që thotë literatura ekzistuese për problemin që është duke u studiuar, duke përfshirë citime specifike dhe parafrazime të ideve të caktuara nga literatura. Po ashtu, do të bëjmë të qartë arsyeshmërinë dhe relevancën e kontributit teorik për hulumtimin tonë dhe mundësinë e studimit të mëtejshëm të problematikës së zgjedhur.

Në literaturën bazë do të analizojmë librat e *Leximit letrar dhe gramatikat* të klasëve 6-9, të shkollave fillore në Kosovë, ku nga këta libra do të nxjerrim pjesët ku ka autorë të letërsisë së sotme shqipe dhe mandej do t'i trajtojmë, do t'i klasifikojmë sipas llojeve, do t'i analizojmë tipet, funksionin, karakterin e tyre edukues etj. Këta libra shkollor, ju dedikohen nxënësve, dhe janë të shkruara në bazë të planit dhe programit shkollor.

Ky punim në fushën e arsimit dhe edukimit ka funksion e tipare të përbashkëta me kërkimet shkencore në fusha të tjera të shkencës, por kur është fjala për karakteristikat e kërkimeve në edukim, atëherë mund të arrijmë në përfundim se në këtë fushë, për arsye të natyrës së

shtrirjes institucionale, qëllimit dhe synimeve, ekziston trajtim i veçante i disa aspekteve të edukatës dhe të arsimit, vështrimin e tyre, klasifikimin, aplikimin etj.

Duke pasur parasysh faktin se letërsia e sotme apo siç njihet edhe si Letërsia bashkëkohore është mjaft e gjerë këtë e konstatojmë ne por, edhe teoricientet bashkëkohorë theksojnë se të merresh me studimin e letërsisë bashkëkohore do të thote te ballafaqohesh me një mori problemesh të natyrës estetike, metodologjike, terminologjike etj. dhe t'i ekspozohesh rrezikut permanent të gabimeve intelektuale, të vlerësimeve të paqendrueshme etj (Vinca, A., 1985).

Me qindra njerëz të penës, të kulturës e të mendimit shqiptar, të poezisë, artit, ekonomise, filozofisë, fesë; u persekutuan dhe u pushkatuan pa gjyq. “Njeriu i ri” socialist e vizatoi hartën e re të kulturës shqiptare sipas kërkesave të veta, duke dëmtuar kështu palcën e identitetit kombëtar shqiptar (Zejnullah, Rr, 2009).

Romani mbizotëroi në letërsinë shqiptare bashkëkohore, sikurse edhe në letërsitë e tjera bashkëkohore evropiane. Letërsia shqiptare që kishte qenë letërsi e poezisë, tani e tutje mund të quhet letërsi e romanit dhe e poezisë. A i mendojnë të gjitha këto hartuesit e plan-programeve të letërsisë, autorët e leximeve letrare, autorët e teksteve historiko- letrare, që do të mësohen në shkolla? Plan-programet tona të letërsisë në shkolla, disa nga leximet letrare dhe disa nga tekstet historiko- letrare, që përdorën në shkollat tona, nuk e dëshmojnë këtë (Qosja, R, 2006).

## II. PËRFAQËSIMI I LETËRSISË SË TRADITËS NË LIBRAT SHKOLLORE

Pavarësisht se letërsia e traditës ka më shumë karakter moralizues, duke qenë e ndërtuar kryesisht mbi fabulën, kjo pjesë e letërsisë për fëmijë është mjaft përfaqësuar në librat shkollorë.

Kjo bëhet ndoshta edhe duke dashur që nxënësit të njihen me fillimet historike të kësaj letërsie dhe njëkohësisht me përmbajtjen e saj.

Fillimi i kësaj letërsie shënohet tek me tri veprat e Naim Frashërit, dedikuar pikërisht fëmijëve, siç janë veprat: *Vjersha për mësënjëtoret e para*, Dritë, Bukuresht, 1886, *E këndimit çunavet këndonjëtorja*, copë e dytë, *E këndimit çunavet këndonjëtorja*, Copë e dytë, të botuara po më 1886 në Bukuresht.<sup>1</sup>

Poeti ynë kombëtar Naim Frashëri është edhe një nga themeluesit e letërsisë shqiptare për fëmijë.

Prozat për fëmijë të Naim Frashërit gjenden në dy vëllimet e tekstit *E këndimit çunavet Këndonjëtorja* (Bukuresht, 1886). Aty ka proza që u dedikohen fëmijëve, po edhe proza mbi fëmijët, në të cilat vogëlushët janë personazhe.

Nga qëllimi e synimi që kërkon të realizojë autori, mund të dallojmë këto tipa të prozës së Frashërit.

### 2.1. Tipet e prozës së Naim Frashërit

Tregimi dituror. Në këto krijime autori synon t'u japë fëmijëve njohuri për natyrën, për *gjithësinë* e shoqërinë. I tillë është, për shembull: *Vash'e urtë*, ku bëhet fjalë për diellin e yjet, çka janë ata, si janë krijuar, si lëvizin. Në fund Naimi jep porosinë e tregimit nëpërmjet fjalëve që e ëma i thotë së bijës: *Këndo e mëso të març vesh gjithësinë dhe Perëndinë* (Bishqemi, A, 2008).

Për shkak të mbingarkesës mësimore disa prej këtyre prozave qëndrojnë më afër artikullit moral se sa tregimit të mirëfilltë. Porosia e tyre diturore dhe morale sendërtohet përmes ngjarjesh, përmes situatash dhe pamjesh ndijore-figurative. Në prozën me titull *Kalorësi*,

Naim Frashëri e shquan porosinë: njeriu duhet ta pranojë si të mirën ashtu edhe të keqën, sepse e keqja, herë herë, mund të ketë një të mirë.

Tregimi atdhetar. Këtu synohet edukimi atdhetar i të vegjëlve. Për këtë qëllim Naim Frashëri shfrytëzon figurat historike, ngjarjet, anekdotat historike, gojëdhënat. Kështu ai tregon anekdotën për *Themistokliun* që detyrohet të ikë prej Spartës në Persi, por pastaj më me qejf do të pijë helmin sesa t'i prijë ushtrisë persiane kundër atdheut të vet.

Te proza *Skënderbegu*, porosia sendërtohet drejtëpërdrejtë përmes mendimit për trimërinë e njohur të shqiptarëve që Skënderbeu ia shkruan një mbreti të huaj, që dikur i kishte thënë disa fjalë kundër shqiptarëve (Dedja, B., 1978).

Në krijimtarinë e Naimi Frashërit, kryesishtë, shquan prirja romantike, në prozën për fëmijë me temë historike a bashkëkohore, ku më pak e ku më shumë, duket edhe një prirje realiste.

Ndër tregimet më të bukura të Naimit është *Ahmeti*, ku tregohet historia e një djali të vogël nga Egjipti, që udhëtonte në një anije dhe mbetet papritur në ishullin e Mitilinës (në detin Egje), pa ndihmë e pa përkrahje. Po fati i tij nuk qe i keq. Anija mbytet dhe prindërit e pandehin të vdekur djalin. Në të vërtetë, në ishull u gjenden njerëz të mirë, të cilët e rritën si birin e tyre. Në rrjedhë të kohës, Ahmeti u vjen në ndihmë bamirësve të tij. Naimi shpreh kësisoj dashurinë ndaj njerëzve të mirë dhe besimin se e drejta dhe e mira gjithnjë do të fitojnë (Bishqemi, A, 2008). Po kështu, ndër krijimet më të bukura të Naimit zënë vend tregimet, që bëjnë fjalë për kafshët dhe marrëdhëniet e tyre me njerëzit. Të tilla janë tregimet: *Qeni dhe besa e tij*, *Kali*, *Qengji*, *Dimri etj.* Te tregimi i parë, lexuesit i ngel në mendje figura e qenit Xhuf, i cili jep jetën për të ruajtur pasurinë e të zotit të tij.

Në tregimin *Dimri* kemi një vajzë të mbarë, Kaçen, që gjatë stinës së dimrit ushqen një zog të vogël, i cili miqësohet me vogëlushen. Disa nga këto proza kanë veçori të tregimit, disa të fabulës (të përrallës). Ato zhvillohen përmes kallëzimit të drejtë (i mjeri) dhe prej bashkëbisedimit ndërmjet dy personazheve (*Drudhë e bukësë*), prej anekdotës (*Themistokliu*) etj. Artistikisht më të suksesshme mund të quhen ato proza që prej rrafshit realist ngrihen në rrafshin fantastik. Këto janë prozat, në të cilat rolin e personazheve e marrin shtazët e ndryshme, si qengji, qeni, ujku, dhelpra, gomari, lejleku, korbi, breshka etj. Të gjitha prozat për fëmijë të Naim Frashërit kanë përmbajtje fare të thjeshtë, të dhënë në vija të përgjithshme, pa thellime psikologjike dhe tematike, në të cilat vetëm përvijohen idetë e porositë morale. Në



to rregullisht ballafaqohen idetë e kundërta, e mira dhe e keqja, e bukura dhe e shëmtuara, urtësia dhe mosdija.

## 2.2. Klasifikimi i poezisë së Naim Frashërit

Poezia diturore. Naim Frashëri si iluminist që ishte, i kushton rëndësi ngjitjes diturore të njerëzve, veçanërisht fëmijëve. Ai nuk ngurron që përhapjes dhe popullarizimit të dijes t'i flijojë edhe poezitë (Bishqemi, A, 2008). Ndryshe nga proza, te vjershat fëmijët nuk janë personazhe të tyre (përjashtim disa prej abulave). Këto janë poezi shpjeguese për gjithësinë, për natyrën, për njeriun. Qëllimi i tyre është të përhapë e të popullarizojë njohuritë deri ku kishte arritur dija (astronomia). Në to mund të mësohet se Toka është trup qiellor që sillet rreth Diellit, kurse Hëna rreth tokës.

*Dheu është një yll i qiellit,*

*Që lëvrin në hapësirë,*

*I vjen rreth e rrotull Diellit,*

*Merr të ngrysur e të gdhirë.*

*Djellinë e ka atë,*

*E hënënë e ka bijë,*

*Bashkë me ta dit'e natë*

*Rron si ç'është një fëmijë* (Bishqemi, A, 2008).

Në disa vjersha të tjera mësohen një sërë njohurish për dukuritë natyrore: se si krijohet shiu, bora, era, rrufeja; njohuri për kontinentet; për njeriun e racat e njerëzve etj. Në disa këto krijime shfaqen edhe ndjenja patriotike të Naimit. Kështu, në vjershën *Dituritë* ai tregon se populli shqiptar është ndër të parët në ata popuj më të lashtë që erdhën nga Hindia dhe zunë vend në kontinentin evropjan:

*Pellazgër qenë syresh të parët*

*Dhe bijtë e tyrë ne shqiptarët*

Poezia morale. Të tilla janë vjershat: *Njerëzia, Fjala, Mejtimi, E vërteta*, gjithashtu *Fjalët e të urtit* dhe fabulat. Virtytet që Naim Frashëri dëshiron t'i zhvillojë te fëmijët janë: në radhë të parë është dija, e cila është kusht themelor për ngritjen morale të njeriut. Te vjersha - *E vërteta* thuhet:

*Njeriu q'është'i pamsuar*

*Nga kafshët s'është'i çquar.*

Ose te *Fjalët e të urtit*, që gjithashtu janë shkruar ne vargje, vlerat e dijes jepen në mënyrë të tërthortë:

*Kusaria, ligësia,*

*Dhe sa të këqija janë*

*Te e gjithë njerëzia*

*Padijen mëmë e kanë.* (Bishqemi, A, 2008).

Bamirësia është njëra prej cilësive të rëndësishme morale të njeriut:

*Duhet që nga vogëlia,*

*Bërë zakon mirësia.*

Në *Fjalët e të urtët*, bamirësia rrudhet deri në ndjenjën e mëshirës:

*Në mos ke, e në nios ep dot,*

*Për të mjerën lësho një lot.*

Naim Frashëri përpiqet për një edukim të ri të fëmijës, që do të mbështetet në dituri e jo në fe. Në tekstin e Gjuhës shqipe për klasën e dytë, Naimi është i përfaqësuar me poezinë *Gjuha jonë*. Fëmijët nuk e kanë të zhvilluar ende mirë ndjenjat kombëtare dhe njohuritë themelore rreth gjuhës e prejardhjes sonë. Prandaj, kjo poezi është ndër më të bukurat, pikërisht, për këtë arsye që fëmijët, dalëngadalë fillojnë të piquen edhe kombëtarisht krahas zhvillimit të tyre fizik e psikik.

### 2.3. Fabulat e Naim Frashërit

Fabulat konsiderohen ndër krijimet më të bukura të Naim Frashërit dhe janë mjaftë të këndshme për lexuesit e vegjël. Te përmbledhja *Vjersha për mësonjëtoret e para* përfshihen 23 fabula. Këto i botoi së pari gjatë vitit 1885, në revistën *Dituria*, në një rubrikë të veçantë *E vërteta ndër përralla*. Fabulat e Naimit shprehin protestën kundër shtypësve, padrejtësive shoqërore dhe dënojnë moralin e kalbur. Një pjesë e tyre janë shkruar me plot dinamizëm dhe me gjuhë të përshtatshme, si: *Dimri e vera*, *Kunadhja e veshur si këndes*, *Ujku dhe qengji*, *Dragoi dhe ujku*, *Qeni dhe hieja* etj.

Karakteristikë e këtyre fabulave është origjinaliteti i tyre. Poeti ynë ka bërë një punë me të vërtetë krijuese me to. Ai merr nga burimi disa detaje a elemente dhe i përpunon më tej në mënyrën e vet të shprehurit, me stilin e tij individual, me talentin e vet poetik (Bishqemi, A, 2008).

Qëllimi i autorit me fabula nuk është vetëm didaktik e moralizues. Autori së pari përpiqet të na japë një krijim të bukur artistik. Dhe, pasi lexuesi të jetë kënaqur me ngjarjen tërheqëse, me detaje të ndryshme, me dialogje dhe sjelljet e ndryshme të personazheve kafshë, autori arrin në porosinë morale. Pra, porosia morale jepet gati gjithmonë në fund të krijimit dhe në formë proverbe.

Te fabula *Gjinkalla dhe miz'e dheut*, ndërsa fabulistët e tjerë klasikë botërorë e vdesin urie gjinkallën dembele, Naimi vepron ndryshe. Miza e dheut i jep asaj ushqim sa për të mbajtur veten gjallë deri në pranverë dhe e këshillon:

*Pa shih tjetër herë,  
Sa pa shtrëngua, pa prishur moti,  
Të mbledh gjë ndë verë.*

Te fabulat e Naimit në përgjithësi zotëron karakteri narrativ. Veç ka edhe të tilla ku aksioni zhvillohet pa komente dhe pa ndërhyrjen e autorit. Dhe këto janë nga krijimet më të bukura. Ja si fillon fabula

*Të dy qetë dhe ujku:  
Ishte një fushë me lule shumë,  
Nëpër mes të saj shkonte një lumë...*

Fryma popullore është mjaft e pranishme në këto fabula. Edhe fillimi i tyre shpesh është si në përrallat tona popullore, pa zgjatje, por duke përshkruar mjedisin ku do të zhvillohet ngjarja.<sup>8</sup> “Për sa i përket vargut, ai është i larmishëm, më së shumti me numër të vogël rrokjesh dhe zakonisht vargje të përziëra. Kësisoj, fabulat e Naim Frashërit janë krijime poetike pothuajse origjinale. Si krijime të diferencuara vetëm për fëmijë, të parat në këtë letërsi mund të konsiderohen dy vjershat, të botuara në *Alfabetarin e gjuhës shqipe* të Naum Veqilharxhit më 1844, për të vazhduar me botime abetaresh si në *Abetar shqip* të Konstandin Kristoforidhit, ku zë vend edhe përralla *Dy dhitë* (1866), si dhe disa përkthime me diskurs fetar, të përkthyer prej Konstandin Kristoforidhit. E po këtij autori është edhe vjersha tashmë e njohur *Ylli i vogël lartë në qiell*, botuar me 1872 (Bishqemi, A, 2008).

Tregimi *Gjahu i Malsorëve* K.Kristoforidhi e botoi tek më 1902. Distanca kohore mes këtyre botimeve është me vite. Këta janë hapat e parë të letërsisë shqipe për fëmijë, të ngadalshëm e të rrallë. Më pastaj, në mënyrë më të mirëfilltë do të paraqiten autorë si: Zef Jubani, Thimi Mitko, etj (Qemiri, B, 2011). Emra jo të paktë, për atë kohë të krijimit të kësaj letërsie u shkolluan dhe jetuan në qendra të ndryshme të botës, klasikë të letërsisë shqipe për fëmijë të Rilindjes Kombëtare, të cilët edhe sot lexohen që nga klasat e para, si: K.Kristoforidhi, S.Frashëri, F.Shiroka, L. Gurakuqi, Naimi, Mjedja, Çajupi etj.

#### **2.4. Koristandin Kristoforidhi (1827-1895)**

*Abetar shqip* është vepra e parë origjinale e Kristoforidhit për fëmijë. Në këtë vepër, përveç pjesës së abetarës, përfshihen edhe copa këndimi me karakter letrar, tregime fetare si: *Kurbani i Nojës dhe Ylberi*, *Të gjeturit e Moiseut*, *Jezusi ndërmjet mjeshtrave* etj.

Në copat e këndimit Kristoforidhi na paraqitet si prozator për fëmijë. Aty ai mundohet t'u japë të vegjëlve disa njohuri shkencore mbi kafshët dhe jetesën e tyre. Të tilla janë: *Qeni*, *Dhia*, *Shqipeja*, *Merimanga* etj (Bishqemi, A, 2008).

*Abetari* i Kristoforidhit ka rëndësi edhe për dy krijime të tjera, siç janë vjersha *Ylli lart në qiell* dhe përralla *Dy dhitë*.

Vjersha *Ylli lart në qiell* mendohet të jetë përshtatur nga letërsia angleze, ndoshta nga poeteshat angleze En dhe Xhein Teiler. Ajo është përshtatur aq bukur, e krijuar aq bukur, me

mjeshtëri e frymëzim, sa mund të konsiderohet poezi origjinale. Ajo zgjon te fëmija dëshirën dhe kërkimin për të njohur dukuritë e botës dhe për të menduar mbi to.

Përralla *Dy dhitë* është ndërtuar mbi bazën e një subjekti të fabulistëve klasikë. Megjithatë, mund të quhet një rikrijim origjinal. Subjekti i saj ka dy vija, që ndjekin njëra-tjetrën: I-historia e dy dhive që takohen në një udhë të ngushtë në mal e që i lirojnë rrugën njëra-tjetrës; II-fati i keq i dy dhive të tjera kokëforta që takohen në një dru mbi përrua e nuk i lëshojnë rrugë shoqja-shoqes. Përveç idesë edukative që autori na nxjerr tërthorazi, vlen të theksohet edhe fakti që në këtë përrallë Kristoforidhi na e jep ngjarjen në mjedisin karakteristik shqiptar.

Tregimi *Gjahu i malësoreve*, të cilin e shkroi më 1884, Konstandin Kristoforidhi nuk arriti ta botonte sa ishte gjallë. Për herë të parë ky krijim artistik e pa dritën e botimit në revistën *Albania* të Faik Konicës më 1902.

Krijimi është shkruar në tri versione gjuhësore: në toskërisht, në gegërishten e Veriut dhe në gegërishten e Shqipërisë së Mesme (Aliu, A, 1986).

*Gjahu i malësoreve* është një prozë që përshkruan një ditë gjahu që bëjnë malësorët në malin e Tomorit. Në të nuk ka ngjarje, nuk ka konflikt, pra nuk ka edhe fabul të shquar. Vendin kryesor aty e zë dialogu midis personazheve, ndërsa teksti midis dialogëve është i pakët, i kursyer. Këto tekste përdoren për të treguar se ç'bëjnë personazhet ose paraqesin situata pamore e dëgjimore të cilat e gjallërojnë atmosferën, (ardhja e gjahtarëve në Kodrën e Kuqe, nisja e tyre për gjah, pushimi i shkurtër, kënga për Skënderbeun, zëri i bririt, ndërsimi i qenëve, krismat e pushkëve), etj.

Në tërësi proza *Gjahu i malësoreve* është një kallëzim simbolik. Kjo të bie në sy si në përmbajtje ashtu edhe në formë. Kallëzimi ka simbolikë jo vetëm temën, po edhe shumë përbërës të veçantë të strukturës së tij: vendin ku shkojnë për gjah malësorët (mali i Tomorit), këngën që këndojnë gjahtarët (për Skënderbeun) emrat e gjahtarëve (Gegë, Toskë, Arbën), kafshët që gjuajnë (dhelpra); simbolik është bashkimi i Gegës, Toskës e Arbërit në gjuetinë e dhelprës, simbolikë janë edhe dialogët që shënojnë zërin popullor me poezinë e musikën e gjuhës së tij, veprimin kolektiv etj. I gjithë tregimi ka një ngjyrim kombëtar dhe shpreh nevojën për bashkim kundër dhunës, dinakërisë, kundër pushtuesit të huaj osman (Bishqemi, A, 2008).

Me bashkimin e tytave të pushkëve të gjahëtarëve toskë e gegë, autori thërret për një bashkim gjithëshqiptar pa dallim feje dhe krahine kundër okupatorit shumëshekullor turk.

Puna e Kristoforidhit u frymëzua nga idealet e lëvizjes kombëtare. Ai më së miri arriti të dëshmonte në teori dhe në praktikë, unitetin e shqipes si dhe unitetin e vet kombit shqiptar.

## 2.5. Papa Kristo Negovani (1875-1905)

Duke vazhduar traditat më të mira të shkrimtarëve të Rilindjes, Negovani luftoi me të gjitha mundësitë për edukimin e brezit të ri, për përhapjen e gjuhës shqipe dhe për zgjerimin e pjesëve të leximit për fëmijë.

Duke e ndjekur rrugën e Naimi Frashërit, edhe Negovani botoi vëllime me vjersha për të vegjlit. E tillë është përmbledhja *Vjershë shkresëtoreja*. Pas vdekjes së autorit u botua edhe një vëllim tjetër me vjersha *I drunjt kryq*, ku cilësia artistike shënon rritje (Bishqemi, A, 2008).

Në këto vëllime ka vjersha që i kushtohen natyrës, si: *Marsi, Dimri, Vera, Të katër kohët e motit* etj. Vjershat e tjera u kushtohen fëmijëve, jetës së tyre në familje e në shoqëri, sjelljes së hijshme, dashurisë ndaj prindërve apo ndaj punës, gjuhës shqipe etj. Të tilla janë vjershat: *Të dy diemtë, Mendimi i djalit të mirë, Gjumaraku dhe këndezi, Gruaja punëtore* etj.

Krijimet poetike të Negovanit kanë karakter atdhetar, fetar e didaskalik. Veç duhet thënë se në to ka shumë moralizime:

*Kur do të qortosh të tjerët  
Vështro veten përnjëherë,  
Mos edhe ti për të qortuar  
Je dhe del i turpëruar.*

Disa prej këtyre vjershave kanë një ngjarje të thjeshtë. Kështu te *Te dy djemtë* tregohet për një plak që rrëzohet udhës me baltë. Dy djem e shohin. I pari fillon të qeshë, ndërsa i dyti nxiton ta ndihmojë. Së fundi autori shtron pyetjen para lexuesve.

*Tani thoni vetë ju,  
Cili është i lëvduar  
Edhe cili i mallkuar.*

Në krijimtarinë poetike të Negovanit, rëndësi të veçantë kanë fabulat. Numri i tyre arrin rreth 45 sosh: *Dhelpra dhe rrushtë, Dragoi dhe dhelpra, Ujku, qengji dhe dhelpra* etj. Sikurse Naimi ashtu edhe Negovani zgjedh tema që u përgjigjen qëllimeve të mësuesit dhe edukatorit atdhetar, Ai godet veset njerëzore ose ushqen veti të mira te bashkëatdhetarët, bën përpjekje për ta vënë pendën në shërbim të lëvizjes atdhetare (Bishqemi, A, 2008). Krijimet letrare të Negovanit kanë karakter atdhetar. Fabula *Pula dhe dallëndyshja* drejtohet kundër shovinizmit grek. Pula gjen ca vezë gjarpëri dhe, pa menduar më gjatë, vihet t'i ngrohë e t'i çelë. Një dallëndyshe e sheh dhe e qorton rëndë. Në - strofën e fundit autori nxjerr moralin duke thënë se kështu e kemi pësuar edhe ne nga armiqtë e mallkuar:

*Ne nga zgjedha i shpëtuam,  
Për vete gjë s'trashëguam.  
Ata gjuhën na shkretojnë,  
Shqip nuk duan të dëgjojnë.*

Në fabulat e Negovanit ndjehet ndikimi i folklorit tonë. Rëndom porosia morale jepet me anë të ndonjë proverbe. Folklori ka ndikuar edhe në metrikën, ku dominojnë vargjet 6 dhe 8 rrokëshe, si në poezitë popullore. Te Negovani nuk kemi gërshetime vargjesh të gjata me të shkurtra, gjë që do t'i bënte më të gjalla krijimet.

Në prozë Negovani dha ndihmesë me vepra të gjata. Ai mund të quhet themelues i tregimit të gjatë (novelës) për të vegjlit. Vlejnë të përmenden rrëfenjat *I drunjt kryq* dhe *I vogli Donat Argjendi*. Libri *I vogli Donat Argjendi* doli më 1900, si botim i shoqërisë atdhetare të Konstancës. Donati i vetëm i gjeneralit shqiptar Argjendi. Gjenerali shkon në luftë për të mbrojtur atdheun dhe plagoset rëndë. Gruaja e tij, Tefta, lë foshnjën e vet dhe niset te i shoqi. Në këtë kohë, nga pakujdesia e njerëzve të shtëpisë, Donatin e vogël e rrëmbejnë kusarët, të cilët duan ta përdorin si mjet për t'i shpëtuar drejtësisë. Kalon kohë dhe Donati rritet në shpellën e kusarëve.

Më vonë arratiset dhe, me ndihmën e një bariu, bie në duart e priftit Savë, i cili i jep mësimet e para. Me kujdesen e tij djali kthehet përsëri te prindërit, kusarët zihen e dënohen. Fundi i rrëfimit është një himn, që i këndon lumturisë familjare dhe që dënon të keqën shoqërore.

Rrëfimi është i pasur sa i përket ideve. Në qendër të subjektit është ideja e triumfit të së mirës dhe të çdo gjëje njerëzore. Nëpërmjet kësaj, autori dëshiron të tregojë se e keqja, sado përçude

që të jetë, mund të mposhtet nga forcat pozitive të shoqërisë. Këto forca autori i ka paraqitur nëpërmjet personazheve të rrëfenjës (Bishqemi, A, 2008).

Diçka më tepër se tregimi i Kristoforidhit, që, siç e kemi përmendur, ka merita të veçanta si punë krejt origjinale, këtu kemi përpjekjen e parë për formimin e personazheve me fizionomi pak a shumë të përcaktuar, si Teftën, Donatin, Savën. Gjeneral Argjendi është një pasanik patriot, luftëtar për lirinë e atdheut dhe baba i mirë. Zonja Tefta një grua besnike, mëmë e pasionuar për fëmijën e vet. Muzaka, megjithëse ndodhet në çetën e kusarëve, ka shpirt të mirë dhe e do Donatin. E keqja shoqërore mishërohet me figurat e armiqëve dhe të kusarëve. Ky tekst tek fëmijët përcjell një mesazh shumë domethënës pasi që gjithmonë e mira duhet të triumfojë, pas një beteje shumë të ashpër dhe të gjatë Donati kthehet prap në familje, ky fund i lumtur i Donatit sjell lumturi edhe për lexuesit e vegjël.

Kristoforidhi si shumë nga shkrimtarët për fëmijë merr pjesë në tekstet e leximit me disa nga krijimet e tij. Në leximin e klasës së parë, Kristoforidhi përfaqësohet me poezinë shumë të njohur për fëmijë *Ylli i vogël*.



### III. FILLESAT E LETËRSISË BASHKËKOHORE SHQIPE

Pas Luftës së Dytë Botërore letërsia shqiptare eci në një rrugë mjaft të vështirë e komplekse. Karakteristikë kryesore e kësaj periudhe është shkëputja jo e natyrshme e letërsisë nga tradita e saj dhe ndikimi i fuqishëm, po ashtu jo i natyrshëm, që ushtroi mbi të përvoja krijuese e metodës së realizmit socialist. Veçoria tjetër, mbase më e rëndësishme dhe me pasoja më të rënda, është se letërsia shqiptare do të zhvillohej e ndarë nga një kufi politik brutal dhe kufizimet e një regjimi diktatorial. Kështu do të kemi: letërsi të zhvilluar brenda kufirit të shtetit shqiptar; të shqiptarëve në përbërje të ish Jugosllavisë, kryesisht në Kosovë dhe në Maqedoni, si dhe të shqiptarëve të diasporës.

Këto karakteristika ndikuan fuqishëm në rrjedhën e letërsisë shqiptare në përgjithësi, si dhe në fizionominë, strukturën artistike apo frymëzimin tematik të saj. Gjatë katër dhjetëvjetëshave të parë të shekullit XX e sidomos gjatë viteve '20 e '30 letërsia shqiptare pari një zhvillim të hovshëm dhe të gjithanshëm. U rrit si numri i krijuesve, ashtu dhe numri i veprave letrare të botuara, të cilat u ngritën në një shkallë më cilësore artistike, duke krijuar premisat për një komunikim më të afërt me përvojat e përgjithshme letrare në Evropë. Përmes shkrimtarëve të talentuar, të shkolluar nëpër qendra të ndryshme të Evropës, në letërsinë shqiptare filloi të depërtojë fryma e drejttimeve dhe e ndjeshmërive të reja krijuese letrare të kohës. Siç dihet, gjatë këtij harku kohor shkrimtarë të mëdhenj të letërsisë shqiptare, si: Fishta, Konica, Noli, Poradeci, Koliqi, Migjeni, Kuteli, shënuan disa nga kulmet më të larta të letërsisë shqiptare, në llojet dhe zhanret e gjinive të ndryshme. Në këtë kontekst letrar llojet e gjinisë lirike do të jenë ato që përparojnë, por një hov të dukshëm do të marrin edhe llojet epike, drama, kritika dhe teoritë letrare.

Krejt ky fluks i pasur krijuesish të talentuar të moshave të ndryshme, të nxitur dhe të mbështetur nga shtypi periodik letrar i drejttimeve dhe i shkollave të ndryshme, do të vazhdojë, thuajse po me këtë ritëm dhe gjatë pjesës së parë të viteve '40.

Për çudi, jehona e hovit të tillë krijues nuk u ndërpre menjëherë pas përmbysjes së pushtimit nazist dhe vendosjes së pushtetit komunist. Pati një tolerancë gjatë ditëve të para të pushtetit të ri ndaj frymës së lirë, liberale në krijimtarinë artistike, e cila do të vazhdojë ta ketë këtë fat edhe për dy tre vjet. Por siç dihet, tanimë nuk ishte më ai rreth individualitetesh të jashtëzakonshëm krijuesish të viteve '30. Noli e Koliqi do të vazhdojnë të krijojnë nëpër

Evropë e Amerikë, por të shkëputur krejtësisht nga letërsia në Shqipëri dhe pa kurrfarë ndikimi mbi të. Lasgushi kishte pushuar së krijuari. Migjeni dhe Fishta nuk ishin më. Nga ky rreth kolosësh të letërsisë shqiptare, vetëm Kuteli do vazhdojë të jetë vazhdimi i natyrshëm i letërsisë së Pasluftës duke botuar sa herë i hiqej censura. Do të vazhdojnë fare ndryshe krijimtarinë e nisur që më parë: Petro Marko, Vedat Kokona, Shefqet Musaraj, Fatmir Gjata, Sterjo Spasse, Nonda Bulka, Dhimitër Shuteriqi etj. Nga poetët që krijuan në vitet e para të çlirimit dhe që krijimtaria e tyre pati jehonën e entuziazmit kolektiv të këtyre viteve, janë: Aleks Çaçi, Luan Qafëzezi, Llazar Siliqi, etj (<http://www.gjuhashqipe.com/sq/Albanologji/Letërsia-moderne-shqiptare>, qasur me 26.05.2018 , n.d.).

Kështu, pas luftës dhe gjatë viteve '50 do të duket qartë orientimi i ri në fushën e letërsisë shqiptare, si në rrafshin tematik, dhe në atë të përvojave dhe të metodave e prosedeve krijuese. Tematikisht letërsia u përqendrua kryesisht, në jehonën e lirisë së fituar nga Lufta Nacionalçlirimtare, kurse ngjyrimi i aktualitetit dhe i botës reale u reduktua kryesisht në bardhë e zi. Si përvojë shkrimi, veprat letrare të kësaj periudhe shpesh do të qëndrojnë ndërmjet gjuhës së rrëfimit letrar dhe atij propagandistik. Kryesisht këtë vullë proceduese kanë romanet e para gjatë viteve '50. Po kaq skematik ishte dhe mendimi kritik zyrtar i asaj kohe, që do ta përkrahte këtë letërsi.

Nga fundi i viteve '50, e sidomos me fillimin e viteve '60, pra pas një dekade e gjysmë që nga çlirimi, do të bëhen hapat e parë për ta nxjerrë nga ky shabllon letërsinë shqiptare. Në këtë kontekst duhet përmendur, pikërisht viti 1958, kur Petro Marko do të botojë romanin e tij të parë "Hasta la Vista", që sjell një tjetër tematikë në romanin shqiptar, një tjetër frymë dhe ndjeshmëri në paraqitjen e personazheve (tanët dhe të huajt). Dy vjet më vonë ai do të botoi dhe romanin "Qyteti i fundit" me prirje për të shmangur skematizmin. Pas tij Ismail Kadare boton romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1962), që, shtegun e paralajmëruar nga romanet e Petro Markos, do ta ngrëjë në një nivel ndërkombëtar (<https://adriana-letersia.blogspot.com/p/letersia-e-moderne.html>, qasur me 26.05.2018 , n.d.).

Pas romaneve të dy autorëve të përmendur, gjatë viteve '60, Jakov Xoxa do të botojë romanin "Lumi i vdekur" që, nga një aspekt tjetër procedura, do të konsolidojë prirjen e romaneve shqiptarë, për të kërkuar rrugë të reja në paraqitjen e botës shqiptare. Pas Jakov Xoxës do të paraqitet Dritëroi Agolli me një seri romanesh, Dhimitër Xhuvani, Ali Abdihoxha, Skënder Drini, Sabri Godo, Vath Koreshi etj., ndërsa majën e poezisë lirike do ta

zënë Fatos Arapi, Ismail Kadareja dhe Dritëro Agolli, të cilët do të çelin një rrugë të mbarë dhe për një brez poetësh të rinj të talentuar si: Dhori Qiriazhi, Bardhyl Londo, Xhevahir Spahiu, Frederik Rreshpja, Natasha Lako etj.

Në fushën e kulturës në përgjithësi dhe në atë të letërsisë në veçanti, gati për gjysmë shekulli, u ndie e ashpër dhuna e shtetit diktatorial (Shqipërisë së kohës) ndaj intelektualëve që e kundërshtuan me forcë atë, qoftë nëpërmjet deklaratave apo artikujve në shtyp, qoftë dhe nëpërmjet veprave të tyre. Kështu prej censurës shtetërore e pësuan shumë rëndë mjaft njerëz të letrave, të cilët ose u pushkatuan, ose qëndruan me vite të tëra në burg apo mundën të arratisen dhe ta kalojnë tërë jetën e tyre jashtë atdheut. Të tillë janë: Arshi Pipa, Sejfulla Malëshova, Mitrish Kuteli, Petro Marko, Musine Kokalari, Trifon Xhagjika, Bilal Xhaferi, Kasëm Trebeshina, Pjetër Arbnori, Astrit Delvina, Frederik Rreshpja, Visar Zhiti etj <http://www.gjuhashqipe.com/sq/Albanologji/Letërsia-moderne-shqiptare>, qasur me 26.05.2018

Sejfulla Malëshova (1900 - 1971), i njohur me emrin letrar Lame Kodra, është nga personalitetet e para disidente në kulturën shqiptare të Pasluftës. Shumica e poezive të Lame Kodrës janë botuar në vëllimin Vjersha (Tiranë, 1945), ku ai e quan veten poeti rebel. Sipas Malëshovës, Shqipërisë i duhej integrimi kulturor dhe jo izolimi nga Evropa Perëndimore. Ai thoshte se detyra e intelektualëve shqiptarë: Është që të vendosin lidhje të ngushta kulturele me popujt e Ballkanit, me Bashkimin Sovjetik, me Anglinë, Amerikën dhe me gjithë botën demokratike e progresive.

Në vitin 1953, me një guxim të hapur intelektual, Kasëm Trebeshina (1926) i dërgoi një "promemorie" Enver Hoxhës, duke e paralajmëruar se: ... shkatërrimi më i madh do të ndodhë në botën shpirtërore shqiptare. Shpërblimi për guximin e tij ishin tërë ato vjet burgimesh e persekutimesh dhe ndalimi i botimit të veprave të tij. Edhe pse vepra e tij nuk është botuar e plotë, nga kritika serioze Trebeshina ka vlerësime nga më të lartat.

Ndërkaq, në vitet '60 botohet në Tiranë romani Shkrimtari i Mehmet Myftiut (1930), i cili merret me fatin e artistit në diktaturë. Ky roman është ndër veprat e para disidente në vendet e Lindjes. Ai denoncoi hetuesinë, internimet dhe burgjet komuniste dhe rifuti në letërsi tema dhe personazhe tabu, që i kishte përjashtuar letërsia zyrtare e kohës.

Po në vitet '60, me përmbledhjen e tij të parë me tregime Njerëz të rinj, tokë e lashtë, Bilal Xhaferi (1935-1987) solli një lirizëm të ngrohtë dhe tepër human në letërsinë shqiptare. Ai rishfaq personazhin e punëtorit me virtytet dhe dobësitë njerëzore, duke iu kundërvënë punëtorit të trajtuar bardhë e zi në letërsinë skematike. Ndërsa vëllimi i tij "Lirishta e kuqe" u ndalua dhe u hoq nga qarkullimi.

Pati dhe shkrimtarë të tjerë që talenti i tyre u ndërpre në mes dhe ata madje as nuk arritën të botojnë deri para viteve '90 veprat e tyre, si: Astrit Delvina (1920 - 1990), një vëllim i tij me tregime "Ëndrra me ngjyra" u botua në vitin 1996; Pjetër Arbnori (1930), disa novela dhe romane të tij janë botuar pas viteve '90.

Vëllimi poetik i Trifon Xhagjikës (1932 - 1963) "Atdheu është lakuriq" që u botua më 1994, ilustron në mënyrë bindëse jo vetëm evoluimin e tij drejt një koncepti të ri estetik, duke u shkëputur nga realizmi socialist, por ai bën një kthesë të vërtetë në bindjet dhe ndjesitë e tij artistike. Në vjershën me titull "Apotheza e ditëve tona" autori e vizaton me ngjyra dramatike gjendjen e dyzimit të individit dhe të shoqërisë shqiptare.

Ndërsa Zef Zorba (1920 - 1993) me librin e tij të botuar mbas vdekjes "Buzë të ngrira në gaz" (1994), dëshmon se është një poet hermetik, me forma poetike të panjohura në poezinë shqipe. Poezia e tij është shenjë e një tjetër kohe, e kohës universale që nuk e përxinin përmasat e kohës kur ai jetoi. I lirë të botojë pas viteve '90 është dhe poeti Visar Zhiti (1952), i cili në disa nga vëllimet e poezi (Hedh një kafkë të këmbët tuaja - libri i burgut, Mbjellia e vetëtimave etj.) arrin të reflektojë në një mënyrë tejet të ndjeshme raportin ndërmjet tragjikes individuale dhe asaj kolektive dhe të rrezatojë dashuri e paqe në realitetin më tronditës (<http://www.gjuhashqipe.com/sg/Albanologji/Letërsia-moderne-shqiptare>, qasur me 26.05.2018, n.d.).

Por përveç këtyre shkrimtarëve që e pësuan me internime apo burgje, censura shtetërore do të binte dhe mbi veprat e shkrimtarëve të tjerë, paçka se ata kishin mundur të krijonin popullaritet në masën e madhe të lexuesve dhe në një farë mënyre e kishin fituar një status mbrojtës. Kështu vepra e tyre ose ndalohej fare ose detyrohej shkrimtari ta ripunonte atë përsëri. Kështu ndodhi me disa vepra të Ismail Kadarese, Dhimitër Xhuvanit, Fatos Arapit, Qamil Buxhelit, Naum Priftit, Dritëro Agollit, Xhevahir Spahiut, Koço Kosta etj.

Ndërsa, letërsia shqiptare që zhvillohej në Kosovë, kishte afërsisht këto karakteristika: e shkëputur nga letërsia amë dhe nga një pjesë e traditës letrare, ajo pothuajse nuk ishte fare në kontakt me të dhe nuk ishte e informuar për atë që ndodhte në fushën e letërsisë brenda kufirit të shtetit shqiptar. Edhe para luftës, në Kosovën letrare herë pas here ilegalisht, mbase edhe mund të depëronte ndonjë vepër ose autor nga periudha e viteve '30, kryesisht përmes atyre pak nxënësve që shkolloheshin aso kohe në Shqipëri. Pas luftës, në vitet '50, krijuesit e parë të letërsisë shqiptare në Kosovë, për mbështetje kishin kryesisht letërsinë gojore (të pasur), fare pak vepra nga fondi letrar i traditës si dhe përvojat e huaja letrare, në radhë të parë ato sllave (<http://www.giuhashqipe.net/albanologji/albanologji.aspx?id=275>, qasur me 26.05.2018 , n.d.) Nga emrat e shkrimtarëve, të cilët e kishin filluar veprimtarinë e vet letrare para luftës, do të përmendim këtu vetëm Esat Mekulin dhe Hivzi Sulejmanin. Mekuli u shqua me lirikën e angazhuar shoqërore dhe kombëtare të shkruar gjatë viteve '30, ndërsa i dyti solli përvojën e parë më serioze në llojin e prozës së gjatë me romanin dy vëllimesh "Njerëzit I" dhe "Njerëzit II", si dhe "Fëmijët e lumit tim". Para tyre Hivzi Sulejmani do të shkruante disa nga tregimet, që edhe sot tingëllojnë moderne.

Ishte poezia ajo që arriti majat e letërsisë shqiptare në Kosovë, duke filluar nga fundi i viteve 50 e sidomos me emrat: Din Mehmeti, Fahredin Gunga, Rrahman Dedaj, Enver Gjerqeku, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Besim Bokshi, Egrem Basha, Sabri Hamiti. Ndërsa në prozë dallohen: Anton Pashku, Ramiz Kelmendi, Azem Shkreli, Nazmi Rrahmani, Rexhep Qosja, Mehmet Kraja, Musa Ramadani etj. Edhe në Kosovë shumë shkrimtarë patën fatin të burgosen, të persekutohen apo të arratisen e të jetojnë jashtë truallit të tyre. Pushteti serb ushtronte dhunën më të egër ndaj intelektualëve që me pushtetin e fjalës përpiqeshin të afirmonin vlerat kombëtare shqiptare. Kështu e pësuan rreptë nga kjo censurë: Adem Demaçi, Ramadan Rexhepi, Kapllan Resuli (i cili pasi u arratis në Shqipëri u burgos edhe atje). Krahas letërsisë shqiptare që krijohet dhe botohet kryesisht në Prishtinë, ajo krijohet dhe botohet edhe në mesin e shqiptarëve të Maqedonisë, kryesisht me prozën dhe poezinë e Murat Isakut, Abdylaziz Islamit, e më pas, me veprën letrare të Resul Shabanit, Adem Gajtanit, Agim Vincës, Din Mehmetit etj. Vlen të përmendet dhe një personalitet i shquar i kulturës, Luan Starova, (shqiptari më i përkthyer sot pas Kadaresë), por shumica e veprave të tij nuk janë në

gjuhën shqipe (<http://www.giuhashqipe.net/albanologji/albanologji.aspx?id=275>, qasur me 26.05.2018 , n.d.)

Edhe pse e zhvilluar në kushte të një izolimi gjeografik e ideologjik, fati dhe perspektiva e letërsisë bashkëkohore shqiptare duhet vështruar në një kontekst dhe më të gjerë gjeografik, d.m.th dhe përtej kornizës ngushtësisht nacionale. Pavarësisht ngã zhvillimet brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe brenda viseve etnike si: Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, kjo letërsi pati dhe njohu zhvillime dhe në diasporë. Sa i takon zhvillimeve të saj në diasporë, letërsia shqiptare mund të shikohet gjeografikisht brenda dy vatrave (<https://adriana-letersia.blogspot.com/p/letersia-e-moderne.html>, qasur me 26.05.2018 , n.d.). Vatra historike e diasporës shqiptare: Itali, Greqi, Rumani, Bullgari, Turqi etj. Vatra të reja të diasporës shqiptare: Gjermani, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj.

a) Zhvillimet më të rëndësishme të letërsisë bashkëkohore shqiptare në diasporë ndodhën në Itali, aty ku sot e kësaj dite jetojnë rreth 90.000 arbëreshë, që vazhdojnë të flasin shqipen. Në përgjithësi mund të thuhet se një "rilindje" e letërsisë arbëreshe ndodhi diku rreth fundit të viteve '50, kur dhe nisi të botohej revista "Shejzat" nga Ernest Koliqi në Romë e më pas revistat "Zgjimi", "Katundi ynë", "Zjarri", "Zëri i Arbëreshëve", "Lidhja", "Bota shqiptare" etj. Këto revista ndikuan në krijimin dhe publikimin e një brezi poetësh e shkrimtarësh që shkruan në arbërisht. Veç të tjerash, një pjesë e tyre funksionoi dhe funksionon dhe si shtëpi botuese, duke publikuar kolana të tëra me poezi dhe vepra të tjera letrare.

Ndër shkrimtarët më të rëndësishëm të kësaj vatre duhen përmendur: Françesk Solano (1914), i njohur me pseudonimin Dushko Vetmo, i lindur në Kozencë. Pas një periudhe të gjatë qëndrimi në Argjentinë, Uruguai dhe Kili, ku dhe shugurohet prift, Solano kthehet në vendlindje. Aktiv në shumë fusha të letrave, ai është kryesisht poet, prozator dhe dramaturg.

Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë: Burbuqe t'egra, 1946, Shkretëtira prej gurit, dramë, 1974, Tregimet e Lëmit, etj.

Domenico Bellizzi (1931), prift nga Frasnita, i njohur me pseudonimin Vorea Ujko, është një ndër trashëgimtarët më të denjë të Jeronim De Radës e Zef Serembes. Ai me poezinë e tij arriti nivele të spikatura të ligjërimit poetik, veçanërisht me veprat: Zgjimet e gjakut, Këngë arbëreshe, 1982, Hapma derën zonja mëmë, 1990 etj.

Karmell Kandreva (1931), poet, bartës i identitetit kombëtar me anë të një ligjërimi poetik original si dhe luftëtar i angazhimit social të arbëreshëve në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës origjinale, ka shkruar triologjinë poetike: Shpirti i arbërit rron; Shpirti i arbërit rron. Arbëreshi tregon; Shpirti i arbërit rron. Vuan dega e hershme.

Zef Skiro Di Maxhio (1944), poet, përkthyes dhe dramaturg i shquar. I angazhuar edhe si drejtor i revistës "Bota shqiptare", i shquar për tonin e tij ironik e shpesh sarkastik, ai është autor i rreth dhjetë librave poetikë, ndër të cilat vlen të përmenden: Nëpër udhat e parajsat shqiptare e t'arbreshë. Poemë gjysmë serioze arbëreshe, Orëmira, Për tokën fisnike të Horës etj.

Padyshim që letërsia arbëreshe vazhdon jetën me të tjerë shkrimtarë, shumica syresh të rinj, duke luajtur kështu një rol të rëndësishëm jo vetëm në diversitetin kulturor shqiptar, por edhe atë italian.

Një tjetër vatër e rëndësishme historike, ku kanë lulëzuar shkrimet shqipe që në fundin e shekullit XIX dhe ku jeta kulturore e elementëve shqiptarë ka qenë e organizuar më së miri, është Rumania.

Një ndër personazhet më të rëndësishëm të letrave bashkëkohore shqiptare është Viktor Eftimiu (1889 - 1972), autor i rreth njëqind vëllimeve letrare të shkruara në rumanisht. Mjaft prej veprave dramatike të tij janë ndërtuar mbi bazën e motiveve shqiptare e të fëmijërisë së tij në malet e vendlindjes. Po aq e rëndësishme sa dhe Rumania në pikëpamje të jetës kulturore shqiptare mbetet edhe Bullgaria, ku janë njohur organizime të hershme të komunitetit shqiptar. Një figurë që vlen të merret në konsideratë nga njerëzit e letrave shqipe, është Thoma Kaçori, i cili shkroi në shqip disa romane e libra me tregime.

b) Në vatrat e reja të zhvillimit të letërsisë bashkëkohore shqiptare hyjnë ato vende në të cilat emigruan për motive kryesisht politike një pjesë e shkrimtarëve të talentuar shqiptarë, që duke mos 11 pajtuar me diktaturën dhe duke ndjerë etjen për liri, realizuan në periudha të ndryshme të regjimit komunist eksodet e sforcuara.

Një nga shkrimtarët e diasporës me peshë më të madhe që jetoi e krijoi në Gjermani, është Martin Camaj (1925 - 1992). Vepra e tij hyn në fondin më të shquar të letërsisë bashkëkohore shqiptare. Ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës zhvilloi veprimtarinë më të madhe studimore e letrare Arshi Pipa (1920- 1997), një ndër punëtorët më të mëdhenj të letrave

shqipe, intelektual i shquar, poet, përkthyes, studiues e polemist. Më 1944 ai drejtoj revistën "Kritika" dhe po këtë vit botoi librin e parë me poezi Lundërtarë. Në SHBA, ku emigroi në vitin 1958, punoi si profesor në disa universitete amerikane deri sa doli në pension. Si dëshmi e asaj që kishte përjetuar në kampet dhe burgjet komuniste ai botoi në Romë vëllimin me poezi Libri i burgut 1959, dhe më vonë dhe vepra të tjera. Një ndihmesë të jashtëzakonshme Arshi Pipa do të japë dhe në studimet letrare, sociologjike e politike me vepra të dorës së parë, ku operon me metoda moderne studimi.



#### IV. LETËRSIA NË SHKOLLË

Letërsia në jetën e secilit popull, pra në jetën edhe të popullit shqiptar, është veprimtari qenësore krijuese, e cila krijohet nga shkrimtarët përmes veprave të tyre dhe që vlerësohet e lexohet nga populli. Sipas Safete Statovcit e tillë është edhe për shkak se përmes letërsisë shënohet historia shpirtërore e popullit. "Pra meqenëse se nëpërmes letërsisë shënohet historia shpirtërore e popullit, me të gjitha veçoritë, tiparet, virtytet e veset e tij, me gëzimet e hidhërimet, festimet e zhgënjimet, fitoret e dështimet, pra me përjetimet e tij në të gjitha planet, atëherë vetëkuptohet sesa peshë ka kjo veprimtari në jetën e një populli, e po kështu edhe te populli ynë" (Grup autoresh, 2008).

Në historinë e shkollave tona shqipe mësimi i letërsisë ndërlidhej pashmangshëm edhe me formimin atdhetar, kulturor, psikologjik, moral e shoqëror. Sigurisht, jo në mënyrën që mësohet sot, sepse rrethanat ekstrapolitike e, si rrjedhojë, ekstraletrare kanë qenë në fillim pamundësi për shkak të vonesës si popull në hapjen e shkollave shqipe dhe më pastaj shpeshherë në kundërshtim me misionin fisnik të letërsisë. Rast më i freskët ka qenë sistemi totalitar në Shqipërinë shtetërore, ku letërsia brenda dhe jashtë shkollës ka qenë në shërbim të ideologjisë partiake. Situatë më e mirë nuk ka qenë as në Kosovën e ndodhur brenda ish-Jugosllavisë.

Megjithëkëtë, letërsia shqipe e ajo botërore, në shkollat shqipe, pavarësisht rënieve të kohëpaskohshme, suksesshëm është ngritur mbi çdo furtunë që ka mund t'i sjellë ndonjë periudhë e caktuar. Kjo suksesshmëri përballë furtunave të llojllojshme kundrejt letërsisë vjen më shumë edhe për shkak të kompleksitetit që mbart po vetë letërsia. Një kompleksitet pozitiv të letërsisë e shpjegon profesor Riza Brada, sipas të cilit, me artin letrar, jeta paraqitet dhe interpretohet në kompleksivitetin e vet sociologjik, psikologjik, etik, filozofik e gjuhësor. "Në artin letrar, kjo jetë, me aftësitë e fjalës së bukur dhe të imagjinatës krijuese, paraqitet dhe interpretohet me kompleksivitetin e saj sociologjik, psikologjik, etik, filozofik dhe gjuhësor të materializuar estetikisht përmes përshtypjeve shqisore, emocionale dhe të argumentuar me forcën e të menduarit krijues, imagjnativ, me të cilën, duke e portretuar artistikisht, begaton shpirtin e lexuesit me emocione fisnike dhe e armatosë intelektin e tij me fakte dhe bindje që ta ndryshojë për të mirën e njeriut" (Brada, R, 2005).

Në shumë shtete të ndryshme statusi i letërsisë në shkolla trajtohet në mënyra të ndryshme, por megjithatë, qëllimi përfundimtar është i njëjtë. Përmes mësimit të letërsisë në shkolla, nxënësve i krijohen kushtet në përputhshmëri me kërkesat psiko-intelektuale të aftësohen në mënyrë të përshtatshme që të kontaktojnë, të pranojnë, të përjetojnë, të kuptojnë dhe të interpretojnë veprën e lexuar letrare. Në shkollat e Kosovës letërsia trajtohet në mënyrë të integruar si një nga fushat e veçanta të gjuhës amtare, pra të gjuhës shqipe.

#### **4.1. Përfaqësimi i letërsisë në shkolla**

Meqenëse teksti mësimor është njëri nga burimet thelbësore ku nxënësi merr mësimet për kulturën letrare, atëherë edhe përpilimi i tekstit letrar duhet të bëhet në përputhshmëri me moshën e nxënësve. Strukturimi i dijeve letrare duhet të bëhet në simetri me rrethanat historike, politike e shoqërore, në të cilat është zhvilluar letërsia jonë dhe ajo botërore. Të gjitha këto paraqiten në fakte si dije themelore dhe pastaj jepen të thelluara në varësi me nivelet e larta shkollore. Për rëndësinë e kësaj pjese, pra në veçanti për përmbajtjet mësimore, me theks të veçantë flet edhe studiuesja Safete Statovci. Ajo ndër të tjerat thotë se përmbajtjet letrare në tekstet e letërsisë duhet të konsiderohen si më të rëndësishmet. “Çështjen e interpretimit të këtyre përmbajtjeve letrare në një tekst të letërsisë duhet konsideruar si një moment nga më të rëndësishmit, andaj puna e mësimit duhet të ketë qasje metodike dhe profesionale të gjithanshme, që t'u mundësojë nxënësve t'i kuptojnë përmbajtjet letrare, ta marrin informacion e nevojshëm për këtë nivel arsimit” (Statovci, S, 2005).

Ndërkaq, po e njëjta studiuese, vë në pah disa kritere të cilat duhet t'i përmbahet hartuesi në sistematizimin e përmbajtjeve mësimore. Këto kritere sipas studiueses Statovci janë: “*vënia në qendër të përmbajtjes të thelbit njohës të njësisë mësimore; ruajtja e koherencës së përmbajtjeve mësimore në mënyrë të integruar; radhitja suksesive e përmbajtjeve mësimore; rënditja koncentrike e niveleve përmbajtjesore të njësisë mësimore dhe parimi i koncentruar i përmbajtjes së njësisë mësimore*” (Statovci, S, 2005). Përpos këtyre kritereve studiuesja thekson edhe kriterin kronologjik, ku datat historike duhet të merren parasysh. Ky kriter shton peshën pedagogjike dhe njëkohësisht i bën përshtypje nxënësve. Respektimi i kritereve të lartcekura, po veçmas edhe atij kronologjik, pa dyshim, njësinë mësimore e bën më të kapshme për nxënësin dhe më tërheqëse. Sidomos, kriteri kronologjik ka peshë të madhe

pedagogjike, sepse duke u aktualizuar një kontekst historik, shtohet pesha pedagogjike për një datë historike qoftë për historinë tonë kombëtare, qoftë për historinë botërore.

## **4.2. Formimi i kulturës së leximit në shkolla**

Me gjithë kërkesat që i vë vetes shkolla është edhe kërkesa për përvetësimin e njohurive, zhvillimin e aftësive dhe formimin e shprehive për të lexuar nxënësi. Rol të rëndësishëm në krijimin e këtyre shprehive e aftësive të nxënësit ka edhe mësimdhënësi i letërsisë. Ky i fundit këto shprehje e aftësi, para së gjithash, duhet t'i ketë për vete dhe me modelin e tij të reflektojë pastaj edhe te nxënësit. Sepse, në vetvete, edhe vetë lënda e letërsisë ka këtë mision. “S’ka dyshim se misioni i vetë lëndës së letërsisë është që gjatë leximit të krijojë te nxënësit përshtypjet artistike njohëse, ndjeshmërinë intelektuale dhe të prekë gjendjen emocionale shpirtërore të tyre, krahas peshës së madhe që ka për nxitjen për lexime të reja, duke ngjallur ndjenjën e së bukurës, pra kriterin estetik si një nga funksionet kryesore të letërsisë”,

Ndërkohë, profesor Riza Brada, flet në veçanti vetëm për kulturën e leximit, të cilën e sheh bazament edhe për kulturën letrare në përgjithësi. “Kultura e leximit është nocion i gjerë. Kjo kulturë ka të bëjë me përvetësimin e njohurive, me zhvillimin e aftësive dhe me formimin e shprehive psiko-intelektuale për shfrytëzimin aktiv dhe të vetëdijshëm të fjalës së shkruar dhe të shtypur si burim dhe mjet i njohurive, në kuadër të fjalës së bukur si krijimtari letrare artistike” (Brada, R, 2005).

Po ashtu, profesor Brada (2005), paraqet edhe pikat më të rëndësishme që përfshihen brenda kulturës së leximit. Sipas tij, kultura e leximit përfshin: *përvetësimin e njohurive, zhvillimin e interesimeve, zhvillimin e qëndrimit kritik dhe zhvillimin e nevojës për të krijuar*. Këto pika janë të rëndësishme edhe për natyrën e studimit tonë, pasi që tekstet letrare në veçanti, duhet të jenë të hartuara dhe të përshtatura në vijë të drejtpërdrejtë edhe me formimin e kulturës së leximit të nxënësit.

Pra, shikuar në përgjithësi, hartuesit e teksteve të letërsisë, gjithmonë duhet ta kenë parasysh ndikimin që kanë këto tekste në formimin e kulturës së leximit të nxënësit. Kur kemi krijuar kushtet për formimin e kulturës së leximit të nxënësit në veçanti, kemi krijuar kushtet edhe të formimit intelektual të nxënësit në përgjithësi. Rol përcaktues ka edhe mësimdhënësi, i cili

duhet të ketë kulturë letrare dhe të jetë i përgatitur profesionalisht. Kjo gjë bëhet e domosdoshme edhe për faktin se çdo mësimmxënie mbështetet mbi të lexuarit.

### **4.3. Formimi kulturës letrare në shkolla**

Formimi i kulturës së leximit është parakusht për formimin e kulturës letrare. Meqë letërsia në shkolla mësohet në të gjitha nivelet shkollore e përshtatur me kërkesat psiko intelektuale të nxënësve, afërmendsh është se formimi i kulturës së leximit dhe formimi i kulturës letrare është qëllim në vete.

Në çdo shoqëri të botës letërsia është bërë pjesë e planprogrameve shkollore, sepse, sipas Hysen Matoshit, edhe për shkak se letërsia është veprimtari që quhet plotëni e botës njerëzore. “Letërsia është veprimtari njerëzore që unifikon si asnjë tjetër në një mendje dhe zemrën e njeriut, arsyen dhe ndjenjën, përkatësisht letërsia përbën atë që mund të quhet plotëni e botës njerëzore. Nëpërmjet saj pasurohet mendja, por fisnikërohet edhe shpirti i njeriut” (Matoshi, H, 2008).

Edhe pse interpretimet letrare krahas fenomeneve të botës nuk janë shkencore, ato prapëseprapë krijojnë njohuri më të gjëra për çështje a dukuri në një fazë të caktuar jete. Një përmbajtje e mirë letrare në cilindo gjini e paraqitur në tekstet letrare apo qoftë edhe si krijim i shkëputur e i përshtatur për nxënësit, është motivuese për të formuar kulturën e leximit (gjë shumë me rëndësi në procesin edukativo-arsimor) dhe për të formuar kulturën letrare në përgjithësi.

Ajo çka vlen të përmendet këtu është përfshirja e dimensionit didaktik sipas profesorit Riza Brada. Ky dimension, sipas tij, përfshin: “njohjen dhe zotërimin e nocioneve nga historia e letërsisë, nga teoria e letërsisë dhe nga kritika letrare; zhvillimin e aftësive, të shkathtësive dhe të shprehive për lexim dhe shfrytëzim permanent të letërsisë si ushqim të mendjes dhe të shpirtit të njeriut dhe zhvillimin e aftësive për kultivimin e fjalës së bukur në të folur dhe në të shkruar deri në nivel krijimtarie” (Brada, R, 2005). Nga ky kuptim didaktik i formimit të kulturës letrare nuk nënkuptohet vetëm të lexuarit mekanik, por edhe të lexuarit logjik dhe të lexuarit kritik.

Brenda kulturës së gjithmbarshme njerëzore janë edhe kultura e leximit dhe kultura letrare, prandaj edhe përkushtimi i formimit të këtyre kulturave brenda veprimtarisë shkollore duhet të jetë me theks të veçantë. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet teksteve letrare gjatë hartimit, si dhe rolit përkushtues të mësimdhënësit gjatë gjithë këtij procesi brenda shkollor.

Në këtë pjesë rol të rëndësishëm kanë lekturat shkollore dhe pashmangshmërisht përkushtimi që tregojmë për letërsinë popullore. Faktorë të tjerë në krijimin e kulturës së leximit, në veçanti dhe, kaliturës letrare në përgjithësi, janë edhe familja, shtëpitë botuese e institucionet që botojnë për fëmijë, bibliotekat e qytetit e bibliotekat brenda shkollës, si dhe moshatarët,

#### **4.4. Teksti mësimor**

Nga një vështrim teorik, në vijim, do të sjellim përcaktime, përkufizime apo definicione orientuese për tekstin mësimor. Dihet se shumëllojshmëria e këtyre përcaktimeve nga studiues të shumtë, ka për qëllim definimin e plotë apo thjesht përpjekjen për definim të plotë të tekstit mësimor.

Në fillim, këtu, po sjellim përkufizimin e tekstit mësimor sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe. Sipas këtij Fjalori, teksti mësimor përkufizohet si në vijim. “1. Materiale të shkruara ose të shtypura për studimin e diçkaje, lëndë mësimore e shkruar ose e shtypur në një libër a në një dispensë; pjesë të shkëputura nga një ose nga disa vepra letrare të shtypura së bashku për qëllime mësimore; libër, dispensë, përmbledhje etj., që përmban këto materiale. P.sh.: tekst mësimor; 2. Pjesë e një materiali të shkruar ose të shtypur pa shënime e shpjegimet për të, pjesë e një libri pa parathënien ose pasthënien, pa titujt e kapitujve etj. Teksti dhe fotografitë (ilustrimet, skicat). Tekst me shënime (me shpjegime)” (Grup autoresh, 2006).

Përkufizim të tekstit mësimor kemi edhe te Ligji për botimin e tyre. Ky ligj e përkufizon kështu tekstin mësimor. “Teksti shkollor është libër (që ndryshon nga librat e tjerë në përdorim) themelor për secilën lëndë, i shkruar në bazë të planit dhe të programit mësimor, në të cilin përmbajtjet i ofrohen nxënësit me aparaturë didaktike të rregulluar, me qëllim që nxënësit t'i përvetësojnë dituritë e nevojshme, t'i zhvillojnë aftësitë e tyre dhe kulturën e punës, duke ofruar material për punë të pavarur dhe krijuese. Recensenti e vlerëson shoqërimin e përmbajtjes dhe të ilustrimeve me aparaturë didaktike”, (Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik, nr. 02/L-67, qershor, 2006).

Një përcaktim të tekstit mësimor e gjejmë edhe në librin *Fjalor termash në edukim*. Sipas këtij fjalori, teksti shkollor është: “Dokument shkollor, ku shtjellohen njohuritë shkencore të një lënde të caktuar në pajtim me kërkesat e programit; mjet pune për nxënësit, një nga burimet kryesore për të fituar njohuri e shprehje mësimore-edukative dhe në të njëjtën kohë mjet për organizimin dhe zhvillimin e punës së pavarur. Së bashku me programet dhe planet mësimore, tekstet shkollore përcaktojnë brendinë e të mësuarit në shkollë” (Zuna, A, 2009). Po ashtu, përkufizime për tekstin mësimor gjejmë edhe te *Fjalori enciklopedik i pedagogjisë* botuar në Zagreb. Ja njëri ndër përkufizimet e tekstit mësimor në këtë fjalor. "Teksti mësimor - mjet mësimor, libër në të cilin është shtjelluar në mënyrë shkencore dhe të përshtatshme lënda mësimore sipas programit mësimor të lëndës përkatëse. Teksti mësimor është njëri nga burimet e rëndësishme të diturisë. Ai përmban dituritë më qenësore që nxënësit duhet t'i përvetësojnë sipas programeve të caktuara mësimore” (Grup autoresh, 1978).

Përcaktim për tekstin mësimor gjejmë edhe te *Pedagogjia për shkollat pedagogjike*. Këtu teksti mësimor përkufizohet si. "Fjala e gjallë e mësuesit dhe teksti shkollor plotësojnë reciprokisht njëri-tjetrin. Teksti shkollor shërben jo vetëm për pajisjen e nxënësve me njohuri të reja, por edhe si mjet për organizimin dhe zhvillimin e punës së pavarur”, (Grup autorësh., 1972, f. 46). Ndërkaq, në Didaktikën botuar në Beograd nga dy autorët e njohur Dr. T. Pedranoviq dhe Dr. P. Nickoviq, ndër të tjera gjejmë këtë përkufizim. "Teksti mësimor është mjet mësimor dinamik i punës dhe tip i veçantë i librit kompleks shkollor, i cili organikisht është i inkoperuar në procesin mësimor dhe ka funksion të shumëfishtë të ndihmës për zhvillimin optimal të nxënësit dhe merr pjesë drejtpërdrejt në komunikimin e gjallë të ndërsjellë midis nxënësit, arsimtarit dhe përmbajtjeve mësimore”, (1976, f. 312). Edhe në Didaktikën e botuar në Sarajevë nga Dr. Nikola Filipoviq kemi këtë definicion për tekstin mësimor. “Teksti mësimor është mjet mësimor tekstual, në të cilin shtjellohen dhe shpjegohen mënyra të përshtatshme shkencore e didaktike faktet, ligjshmëritë, teoremat dhe qëndrimet me qëllim që frekuentuesit t'i përvetësojnë dituritë e nevojshme, t'i zhvillojnë aftësitë e tyre mendore, të fitojnë shprehinë dhe kulturën e punës me libër”, (Filipoviq, N., 1977).

Për tekstin mësimor gjejmë përkufizime edhe te *Didaktika* e botuar në Tiranë. Në këtë libër teksti shkollor është: "Dokumenti bazë në duart e nxënësit që shërben si burim themelor

për përvetësimin e njohurive, të shkathtësive e të shprehive si dhe mjet kryesor në duart e mësuesve për procesin mësimor” (Grup autoresh, 2006).

Për përkufizimin e tekstit mësimor është i vlefshëm edhe mendimi i studiuesit Abdyl Ramaj: “Me shpikjen e shtypit libri bëhet mjet mësimor masiv dhe burim thelbësor i diturisë në duart e nxënësve në përdorim mësimor dhe jashtë mësimor. Kështu, teksti mësimor bëhet fenomen i ri didaktik, i cili shkakton kthesë të vërtetë në mësim. Tash funksioni i arsimtarit në mësim, megjithëse në esencë nuk ndryshon, nuk është më i vetmi burim i diturisë në mësim. Në mësim tash janë të pranishëm” tërthorazi më shumë arsimtarë, më shumë ekspertë, të cilët, me anë të librave dhe teksteve mësimore, në mënyrë të tërthortë kumtojnë, në të vërtetë komunikojnë me nxënësit. Arsimtari tash bëhet ndërmjetës midis tekstit mësimor dhe burimeve të tjera të diturive dhe nxënësve. Pra, ky ndërmjetësim arrihet në mënyrën më efikase me interpretimin didaktik, përkatësisht me drejtimin e nxënësve nëpër përmbajtje mësimore të formësuar didaktike në tekstin mësimor”, (Ramaj, A., 1999, f. 95).

Pra, nga kjo paraqitje e shkurtër vërehet se përpjekja për përkufizimin e tekstit mësimor nuk ka qenë edhe aq e lehtë dhe se autorë të shumtë në këtë drejtim kanë pasur qasje të ndryshme për tekstin mësimor. Megjithatë, këtu pjesa më e madhe e autorëve si në emërtim, si në atributet që ia japin tekstit mësimor janë më afër njëri-tjetrit, anipse nuancat dalluese janë të pranishme të secili prej tyre.

Edhe komponenti se kujt i destinohet teksti mësimor është i pranishëm te autorët e lartpërmendur. Sipas tyre, teksti mësimor i destinohet nxënësit apo studentit. Nga vetë ky komponent e kuptojmë se teksti mësimor është libër i formësuar me aparaturë didaktike dhe me funksion të veçantë për nxënësin dhe përvetësimin e diturive dhe zhvillimit të aftësive në përputhje me programin mësimor.

Ndërkaq, edhe komponenti se ku mbështetet teksti mësimor është i pranishëm te autorët e lartpërmendur. Sipas tyre, teksti mësimor gjen mbështetje në planin dhe programin mësimor. Nga kjo del se përmbajtjet e teksteve mësimore duhet të përshtaten me kërkesat e planit dhe programit mësimor. Kurse, autori duhet ta ketë parasysh gjatë procesit krijues te tekstit mësimor planprogramin mësimor.

Theks të veçantë e, të pashmangshëm, autorët i kanë dhënë komponentës didaktike. Madje, pa këtë pjesë teksti mësimor mbetet vetëm një libër i shtypur dhe i zakonshëm.

Kurse, komponenti se çfarë funksioni ka teksti mësimor është më i rëndësishëm që del nga përkufizimet e lartpërmendura. Mirëpo, ky komponent duhet të jetë i përfshirë në çdo definicion më qartë dhe më bindshëm, sepse funksioni i tekstit mësimor përpos që është brenda mësimin, është edhe jashtë mësimin, pra në vetarsim.

Komponenti që parashtronë kërkesat psikologjike, bashkë me veçantinë e lëndës janë pak të theksueshme në përkufizimin e tekstit mësimor si definicion.



## V. STRUKTURA NË LIBRIN E LEXIMI LETRAR 6

Qasje hyrëse

Meqenëse teksti mësimor është burim themelor i diturisë për nxënësit, pashmangshëm kriteri didaktiko-shkencor na del më i rëndësishëm në hartimin e tyre. Nëse në historinë e zhvillimit të arsimit dikur ka qenë arsimitari si burim i vetëm i diturisë, tani tërthorazi, së bashku me tekstin mësimor, janë edhe burime të tjera të diturisë. Pra, në një mënyrë kemi më shumë arsimtarë, më shumë ekspertë e më shumë dritare ku nxënësve u mundësohet kërkimi i diturisë.

Kriteri didaktik në tekstet mësimore ka për qëllim kuptimin sa më të lehtë të përmbajtjeve mësimore nga nxënësit. Ky qëllim realizohet me anë të aparaturës didaktike. Cilësia e aparaturës didaktike në tekstin mësimor është parakusht për kuptimin dhe aftësimin e nxënësve që të kenë mendim kritik, të punojnë të pavarur, të debatojnë për gjëra të ndryshme, të kërkojnë dhe t'i praktikojnë njohuritë e dhëna në tekst. Kështu, sa më i përsosur cilësisht teksti me kriterin didaktik, aq më i kuptueshëm për nxënësit dhe, njëkohësisht, aq më pak cytje për mësim përmendsh.

*Libër leximi VI* është i miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë dhe përdoret në të gjitha shkollat shqipe. Autorët e këtij libri janë: Rita Petro dhe Xhevat Syla. Kurse, këtë libër e ka botuar Shtëpia Botuese *Albas*.

Libri i leximit në këtë klasë është i ndarë në katër rubrika (sipas autorëve të tekstit) dhe secila ka ndërlidhje me njëra-tjetrën. Rubrikat janë: *Miqtë tanë, përralla dhe histori të vërteta, udhëtime e kuriozitetet dhe faqja e vjershave*. Megjithatë, më poshtë ne do të paraqesim jo sipas rubrikave, po sipas llojeve të shkrimit. Bashkë me llojet e shkrimit brenda secilës njësi mësimore do të paraqesim edhe aparaturën didaktike në këtë tekst. Për ta bërë më të kompletuar këtë pjesë, ne do të paraqesim edhe një grafikon përmbledhës që përfshin në përqindje aparaturën didaktike në këtë tekst.

### 5.1. Poezia lirike

Në këtë pjesë përfshihen disa lloje të poezisë lirike. Si për shembull ajo atdhetare, e peizazhit dhe poezi të tjera me tematika të ndryshme. Ndër to ka poezi të letërsisë shqipe dhe të asaj

botërore. Nga letërsia shqipe kemi dymbëdhjetë poezi, kurse nga letërsia botërore kemi dy poezi. Pastaj këto poezi ndahen sipas tematikës që kanë.

**Poezia atdhetare:** Bagëti e Bujqësi (Naim Frashëri), Gjuha shqipe (Gjergj Fishta), Atdheu (Ilirian Zhupa) dhe Hymni i Flamurit (Fan Noli)

**Poezia e peizazhit:** Vjeshta (Asdreni)

**Poezi me tematika të ndryshme:** Detyrat e shtëpisë (Sabri Hamiti), Pylli qan për sorkadhen (Dritëro Agolli), Bota fëmijërore (Adem Gajtani), Detyrë klase (Zhak Prever), Katër këshilla vetes (Azem Shkreli), Me jetue (Ali Podrimja), Buzëdrinas (Agim Vinca), Dy shitëset e luleve (Vehbi Kikaj), Mirësi (Moris Karem).

## 5.2. Poezia atdhetare

Me këtë tematikë hartuesit kanë zgjedhur shkrimtarët që për nga mënyra e të shkruarit janë shumë më të afërt me periudhën romantike. Është fjala për Fishtën e Nolin, të cilët në shumicën e shkrimeve të tyre gjejmë më shumë nuanca romantike, sesa moderne. Megjithatë, sipas ndarjes shkollore, një është i periudhës romantike (Naimi), dy janë të modernes (Fishta e Noli) dhe njëri është bashkëkohor (Ilirian Zhupa).

Naim Frashëri, Bagëti e Bujqësi: Nga kjo poemë është shkëputur një pjesë. Anash faqes është edhe fjalori shpjegues. Në këtë fjalor shpjegohen katër fjalë: *çuklë-a*, *brinjëlë-a*, *gërxxh/e-ja dhe gas*. Te kjo njësi mësimore pos tjerave është edhe puna me tekstin. Puna me tekstin është e ndarë në katër fusha të të kuptuarit, si p.sh: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, studiojmë gjuhën e tekstit (në këtë pjesë shpjegohet edhe epiteti si figurë letrare) dhe pjesa tjetër është detyrë shtëpie (kërkohet mësimi përmendsh). Gjysma e faqes, ku është e paraqitur vjersha, është e mbuluar me peizazhin e bukur të një mjedisi natyror diku në Shqipëri. **Gjuha shqipe:** Kjo vjershë është njëra ndër vjershat më popullore ndër ne. Pothuajse të gjithë e dinë edhe përmendsh. Vjersha është origjinale siç është shkruar në gjuhë dialektore. Fjalori shpjegues nuk mungon as në këtë vjershë. Gjithsej janë dy fjalë e tri shprehje dialektore. *Gjam/ë-a*, *zgjetare*, *ju thaftë goja*, *len mbas dore*, *trima n'za*. Puna me tekstin është e ndarë në tri fusha, si: kuptojmë tekstin, studiojmë gjuhën e tekstit (këtu shpjegohet edhe krahasimi si figurë letrare) dhe në fund detyrë shtëpie (mësimi përmendsh dhe sjellja e vjershave tjera për gjuhën shqipe). **Hymni i flamurit:** Edhe kjo vjershë është paraqitur në këtë

tekst, e cila ka motive atdhetare. Në faqen anash vjershës nuk shpjegohen fjalë të panjohura, por ngjarje e personalitete të përmendura. Po në faqen që është paraqitur vjersha ka edhe një fotografi të heroit kombëtar Skënderbeut. Faqja tjetër punë me tekstin është e ndarë në ushtrime dhe detyra. Kuptojmë tekstin, studiojmë gjuhën e tekstit (ndër të tjera kërkohet edhe gjetja epiteteve për flamurin) dhe detyrë. Detyra është ftesë për krijim brenda pjesëve të zbrazëta nga teksti i paraqitur. **Atdheu:** Vjersha Atdheu i këndon atdheut ndryshe nga ato të mëhershmet. Në anën e majtë të faqes është shpjegimi i shkurtër për këtë vjershë dhe fjalori shpjegues i fjalëve që përdoren në kontekstin e vjershës. Çerdhe/e-ja, qëndres/ë-a dhe të rënët. Po në të njëjtën faqe është edhe një pikturë ku paraqitet shtëpia. Kurse, faqja tjetër punë me tekstin ka ushtrimet: ta kuptojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Ndërsa detyra është për ta mësuar vjershën përmendsh dhe bukur.

### 5.3. Poezia e peizazhit

Me këtë tematikë është përfshirë vjersha e Asdrenit e titulluar Vjeshta. Poetët e Rilindjes Kombëtare i kanë kënduar me shumë zell natyrës, prandaj edhe poezitë e tyre me këtë tematikë janë më përfaqësuese.

**Vjeshta:** Vjersha ka një muzikalitet të mrekullueshëm edhe për shkak të rimave që kanë vargjet. Në faqen ku është paraqitur vjersha tregohet edhe referenca nga ku është shkëputur kjo vjershë, si dhe fjalori shpjegues i fjalëve të panjohura në këtë vjershë. Fjalët shpjegohen edhe për shkak të kontekstit që përdoren brenda në vjershë. Për shembull: terret, hij/e-a dhe trashëgojmë. Faqja pasuese është punë me tekstin e ndarë në fushat si në vijim: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, studiojmë gjuhën e tekstit (shpjegohet edhe rima) dhe detyrë (kërkohet të bëhet një pikturë për stinën e vjeshtës dhe kombinimi i ngjyrave). Biografia e autorit është paraqitur në fund të librit.

### 5.4. Poezi me tematika të ndryshme

Në këtë pjesë përfshihen poezi me tematika të ndryshme. Më poshtë për secilën do të paraqesim shkurtimisht strukturën didaktike.

Sabri Hamiti, **Detyrat e shtëpisë:** Poshtë titullit të poezisë jepet edhe mesazhi i kësaj poezie. “Për të mësuar nuk është kurrë vonë”. Kurse, në anën e djathtë të faqes jepen fjalët e

panjohura dhe konteksti i shprehjeve që përdoren, si p.sh.: *lulojnë, tevona, peshojnë, baba i vonuar*. Faqja pasuese është punë me tekstin. Ndahet në tri fusha. Kuptojmë tekstin, ku ka 4 pyetje dhe vlerësojmë tekstin një pyetje me dy alternativa. Në fund kemi detyrën ku kërkohet të formohen fjalë të përbëra. Jepet një shembull dhe pastaj kërkohet plotësimi i të tjerave.

Dritëro Agolli, **Pylli qan për sorkadhen**: Kjo poezi në fillmfaqe ka referencën nga cili libër është marrë. Përpos vjershës kemi edhe një pikturë që lidhet me vjershën. Fjalorthi i fjalëve të panjohura është dhënë skaj faqes. Janë dy fjalë: çar-u dhe rënkoj. Faqja tjetër është punë me tekstin, e cila ndahet në tri fusha. Kuptojmë tekstin me 3 pyetje dhe studiojmë gjuhën e tekstit me tri pyetje. Në fund është detyra, ku kërkohet mësimi përmendsh dhe të recitohet bukur.

Adem Gajtani, **Bota fëmijërore**: Në këtë poezi në të njëjtën faqe kemi edhe ilustrime. Ndërkohë, fjalor për fjalët e panjohura nuk kemi. Faqja tjetër është puna me tekstin, e cila ndahet në tri fusha. Kuptojmë tekstin me 4 pyetje dhe studiojmë gjuhën me 3 pyetje. Përpos këtyre pyetjeve anash faqes kemi edhe shpjegimin e hiperbolës. Kurse, pjesa e tretë detyrë, i kërkon nxënësve të shkruajnë dëshirat e tyre në fletore. Vlen të theksohet se pas kësaj poezie, janë dy faqe tjera me ushtrime në lidhje me poezinë. Ky ushtrim ka edhe ilustrime shpjeguese, si dhe shpjegime tjera në lidhje me poezinë.

Zhak Prever, **Detyrë klase**: Në dy faqet e librit është paraqitur vjersha. Anash saj janë fjalët dhe shprehjet e panjohura. Si p.sh.: zogu bishtlirë, qyfyf, shemben. Ndërsa, në fund të faqes së dytë kemi një vizatim, ku është paraqitur klasa me nxënës dhe me mësimdhënësen. Dy faqe tjera janë punë me tekstin. Kuptojmë tekstin me 6 pyetje dhe studiojmë gjuhën me 3 pyetje. Kurse detyrë jepet mësimi përmendsh i gjysmës së vjershës dhe recitimi me intonacion.

Azem Shkreli, **Katër këshilla vetes**: Kjo poezi që në fillim të faqes ka një shpjegim të shkurtër. Pastaj jepet poezia këshilldhënëse. Fjalor shpjegues nuk ka. Sakaq, puna me tekstin është në faqen tjetër. 4 pyetje janë në pjesën kuptojmë tekstin, 4 janë në pjesën studiojmë gjuhën e tekstit. Kurse detyra është kërkesë krijuese, sipas Blumit, e nivelit më të lartë. Kërkohet të bëhet një krijim sipas poezisë me temë: *Këshillat që i jap më shumë vetvetes*”.

Ali Podrimja, **Me jetue**: Poezia e paraqitur në këtë tekst, përpos që ka shpjegim të shkurtër në fillim, pra kujt i kushtohet, ka edhe një prapasfond ilustrativ që ndërlidhet me tematikën. Fjalor shpjegues të fjalëve dhe të termave nuk ka. Faqja tjetër është puna me tekstin dhe sipas

pyetjeve të parashtruara kemi kuptojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Detyra është krijuese me temë: “Këshillat e prindit tim janë mjaft të vlefshme për mua”.

Agim Vincës, **Buzëdrinas**: Në këtë poezi paraqitet portreti i bashkëvendësit dhe autoportretit i autorit. Ky shpjegim vjen nga vetë autorët e tekstit në fillim të faqes. Edhe në këtë nuk ka poezi fjalor shpjegues të fjalëve e shprehjeve. Faqja tjetër është ushtrime përmes pyetjeve të ndara në nivelin kuptojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Gjithsej janë 8 pyetje. Detyrë është mësimi përmendsh dhe recitimi bukur, si dhe përshkrimi i cilësive për një bashkëvendës përkitazi me poezinë.

Vehbi Kikaj, **Dy shitëset e luleve**: Përpos që kemi shpjegimin njëparagrafësh të kësaj poezie, në të njëjtën faqe është edhe një pikturë, ku paraqiten lule të ndryshme. Puna me tekstin është në faqen tjetër. Me gjithsej 7 pyetje për ushtrime në dy nivele: Kuptojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Kurse, kemi një detyrë që kërkon mendim krijues.

**Mirësi**: Vjersha e shkruar nga poeti belg Moris Karem. Brenda një faqe jepet poezia, fjalori shpjegues i fjalëve, si: pemisht/e-ja, një pikturë që ndërlidhet nënkuptueshëm me vjershën, puna me tekstin e përbërë me 3 pyetje për ushtrime në nivelin kuptojmë tekstin dhe detyra që kërkon mësimin përmendsh të vjershës.

## 5.5. Poezia epike

Brenda kësaj pjese përfshihen lloje të poezisë epike ku rrëfohen ngjarje. Dy nga tri poezitë epike janë nga letërsia shqipe dhe njëra është nga letërsia botërore. Të letërsisë shqipe janë: *Ra si yll po s'u shua* (I. Kadare), Gjëegjëza (popullore). Kurse e letërsisë botërore është: *Bretkosa që do të trashet sa një ka* (La Fonten). Sipas tematikës këto poezi sjellin ngjarje nga qëndresa e popullit tonë, nga letërsia popullore dhe ngjarje këshillëdhënëse nga letërsia botërore.

Ngjarje nga qëndresa e popullit tonë:

Ismail Kadare, **Ra si yll po s'u shua**: Kjo poezi përpos që ka referencën se nga cila poemë është shkëputur, ka edhe peizazhin shqiptar me kala të paraqitur përreth faqes. Fjalor shpjegues të fjalëve dhe shprehjeve nuk ka. Ndërkaq, në faqen tjetër është puna me tekstin, e cila në pjesën e ushtrimeve ndahet në dy nivele dhe në fund jepet detyrë. Pjesa ushtrimeve ka gjithsej 10 pyetje. 5 pyetje janë në nivelin kuptojmë tekstin dhe 5 janë në nivelin studiojmë

gjuhën e totestit. Detyrë jepet mësimi përmendsh dhe recitimi i bukur i ngjarjes së paraqitur në këtë pjesë të librit.

Nga letërsia popullore shqipe

**Gjëegjëza:** Gjithsej janë 14 gjëegjëza të paraqitura në faqen e parë. Bashkë me këto është një vizatim ku paraqitet një djalë e një vajzë. Anash kemi fjalorin shpjegues të fjalëve dhe shprehjeve të panjohura, si: strumbullar, tekdo, tok, sërë-sërë, inxhi-a, mel-i. Faqja pasuese është puna me tekstin. Përpos 5 pyetjeve të parashtruara në ushtrimin kuptojmë tekstin, kemi edhe përgjigjet e sakta të gjëegjézave ta paraqitura jo sipas radhës. Te pjesa detyrë kërkohet mësimi përmendsh i sa më shumë gjëegjézave dhe tregimi i tyre kur të mblidhen me shokë e shoqe. Po ashtu, të theksuar me ngjyrë të veçantë, kemi edhe shpjegimin e gjëegjézave.

Ngjarje këshillëdhënëse nga letërsia botërore

**Bretkosa që do të trashet sa një ka:** Në fillim të faqes shkurtimisht jepen dy fjali për Ezopin. Pastaj përpos fabulës në vargje kemi edhe një pikturë të kaut dhe bretkosës. Anash kemi fjalorin shpjegues të fjalëve dhe shprehjeve. Ato janë: deve-ja, nakar-i, maraz-i, zili-a. Puna me tekstin është e ndarë në dy nivele të ushtrimeve. Kuptojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Gjithsej kemi 11 pyetje në të dy nivelet e ushtrimit. Ndër të tjera theksohen edhe figurat letrare, si alegoria e hiperbola. Ndërkohë, në detyrë përpos që kërkohet mësimi përmendsh i fabulës, jepen edhe udhëzime si duhet të recitohet.

## 5.6. Përmbajtje e përgjithshme

Në vazhdim do të paraqesim pjesë të shkëputura në prozë nga librat e autorëve të ndryshëm për fëmijë. Këto pjesë përfaqësojnë edhe letërsinë shqipe, edhe letërsinë botërore. Pjesët e shkëputura në prozë nga letërsia shqipe janë gjithsej tetë (8), ndërsa nga letërsia botërore janë gjithsej gjashtë (6). Të letërsisë shqipe janë: *Mandolina* (Naum Priftit), *Libri për princin e lumtur* (Ibrahim Kadriu), *Letër nga fshati* (Sterjo Spasse), *Djali dhe deti* (Nasi Lera), *Poeti i vogël* (Gjergj Zheji), *Ushtari i lumtur* (Teodor Laço), *Njerka* (Faik Ballanca), *Poezia e parë* (Ismail Kadare). Kurse të letërsisë botërore janë: *Mirënjohja* (Edomod de Amicis), *Një ditë vere në fermë* (Elisabet Enrajt), *Gabojnë prindërit* (Luigji Pandelo), *Fëmijët e sotëm* (Azis Nesin), *Dëshira për të lexuar* (Maksim Gorki), *Tomi shpëton Bekin* (Mark Tuen).

Nga letërsia shqipe:

**Mandolina:** Që në fillim të faqes jepet referenca nga ku është shkëputur pjesa dhe një shpjegim i shkurtër se për çfarë flitet në vazhdim. E gjithë kjo pjesë e shkëputur paraqitet në tri faqe të librit dhe anash secilës faqe ndodhet fjalori shpjegues i fjalëve dhe shprehjeve të panjohura. Si për shembull: **fronin, miresjellj/e-a, kinkalери-a, perç/e-ja, mafish/e-ja, pandispanjlë-ja, celuloid-i dhe pazarllëk-u.** Në fund të faqes së tretë është e paraqitur me anë të një fotografie mandolina. Puna me tekstin ndahet në tri nivele: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin dhe studiojmë tekstin. Brenda kësaj faqe të theksuara me ngjyra të ndryshme paraqiten edhe dy paragrafë, ku shpjegohet tema dhe ideja e veprës letrare. Detyrë nuk kemi.

**Ibrahim Kadriu, Libri për princin e lumtur:** I theksuar me ngjyrë të veçantë është shpjegimi me anë të një fjalie për këtë tregim. Pastaj në vazhdim paraqitet tregimi në tri faqe dhe anash secilës fjalori shpjegues. Fjalët e shprehjet e që kanë shpjegim janë: **libërth, mjeshtri dhe të zymtë.** Po ashtu, në fillim të faqes së tretë të këtij tregimi kemi një pikturë që ndërlidhet me përmbajtjen e tregimit. Ndërsa puna me tekstin ka gjithsej 12 pyetje për ushtrime të ndara në tri nivele. Kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Në fund jepet edhe një detyrë ku kërkohet përshkrimi i pjesës së përqaftimit baba-bir dhe ndarja në role e interpretimi në klasë.

**Letër nga fshati:** Referenca e shkëputjes së kësaj pjese jepet e veçantë në fillim. Faqja poshtë, bashkë me faqen tjetër përpos pjesës së shkëputur, ka edhe fjalorin shpjegues të fjalëve dhe shprehjeve. Gjithsej janë 6 fjalë: babagjysh-i, gadishull-i-, kallamasi, Kasomiku, zheg-u. Bashkëngjitur me këtë pjesë kemi edhe një vizatim të një peizazhi. Kurse puna me tekstin ka 13 pyetje për ushtrime. Këto pyetje janë të ndara në tri nivele. Kuptojmë tekstin 5 pyetje, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin 5 pyetje dhe studiojmë gjuhën e tekstit 3 pyetje.

**Nasi Lerës, Djali dhe deti:** Tregimi përpos që ka referencën, ka edhe një fjali që shpjegon se çfarë rrëfen autori. Ndërsa në vazhdim kemi tregimin e paraqitur në tri faqe. Pos tregimit kemi edhe një peizazh të valëve të deti në fund të tregimit. Fjalori shpjegues i fjalëve dhe

shprehjeve ka gjithsej 8 shpjegime, si: nuk u besoi veshëve, trung-u, panik-u, sku/ë-a, mposht-e, ritmikisht, pulëbardh/ë-a ankth-i. Faqja pasuese është puna me tekstin me gjithsej 11 pyetje për ushtrime. Këto pyetje janë të ndara në tri nivele. Kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Po ashtu, me hijezim të shkronjave shpjegohet edhe *simboli*.

**Gjergj Zheji, Poeti i vogël:** Ky tregim paraqitet në tri faqe. Anash janë fjalët dhe shprehjet e shpjeguara. Ndrojtj/e-a, komodin/ë-a, vuri buzën në gaz, heshti një hop, çunak-u. Në fund të tregimit kemi edhe një vizatim. Faqja tjetër është punë me tekstin e ndarë në tri nivele me gjithsej 9 pyetje (Kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit). Kurse, në detyrë kërkohet paraqitja e përshtypjeve në lidhje me marrëdhënien e djalit dhe mësuesit.

**Teodor Laços, Ushitari i lumtur:** Në fillim të kësaj njësie mësimore jepet referenca ku është shkëputur tregimi. Po ashtu, me dy fjali tregohet se për çfarë flet ky tregim. Tri faqet i kushtohen tregimit bashkë me fjalorin shpjegues të fjalëve dhe shprehjeve. Fjalët dhe shprehjet e shpjeguara janë: kaptoj, rrëpir/ë-a, kuqa-ja. Klith, rradh/e-ja, kruspull, vegim. Në faqen e katërt kemi punën me tekstin. Pyetjet për ushtrime janë të ndara në tri nivele: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Gjithsej janë 12 pyetje. Kurse detyrë i jepet leximi i bukur i kësaj pjese.

**Njerka:** Me theks të veçantë në fillim të faqes jepet një shpjegim i shkurtër se çfarë trajton ky tregim. Pastaj në vazhdim përpos faqes së parë kemi edhe dy faqe tjera, ku paraqitet tregimi. Fjalët dhe shprehjet e shpjeguara ndodhen anash faqes, si p.sh.: grykës/e-ja, i pabërë, strukej, isha ftohur me babanë, balluk/e-ja, tëmtha-t, fizionomi a, shtirem, vuri kujën. Po ashtu kemi një pikturë ku paraqitet familja. Pyetjet për ushtrimet janë në faqen tjetër. Ato janë gjithsej 12 pyetje të ndara në kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Kurse në fund kemi edhe një detyrë.

**Ismail Kadare, Poezia e parë:** Qysh në fillim të kësaj pjesë kemi referencën nga ku është marrë dhe një fjali shpjeguese për përmbajtjen e kësaj pjese. Në katër faqe është paraqitur kjo pjesë dhe anash secilës janë fjalët dhe shprehjet e shpjeguara, si: **marrok, i ndërkyrer, zhgënjim-i, rubrik/ë-a, grim/ë-a, i mpirë, mistrec-i, karagjoz-i, dendësuam, prock/ë-a, zink/ë-a, pullë-a, masak/ër-ra, gjysmëroman-i, dyshanjas-i, zorzopër, vetëtimthi.**



Vlen të theksohet se në këtë pjesë kemi tri vizatime të paraqitura në faqe të ndryshme. Faqja e fundit në këtë njësi mësimore është puna me tekstin e ndarë në kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Gjithsej janë 12 pyetje për ushtrime.

Nga letërsia botërore:

**Edmond de Amicis, Mirënjohja:** Paragrafi i veçantë është referencë se nga cili libër është shkëputur kjo pjesë. Përpos kësaj reference kemi edhe shpjegimin se çfarë tregohet në këtë tregim dhe formën e paraqitjes së kësaj pjesë si ditar. Më poshtë është paraqitur pjesa e shkëputur në tri faqe. Anash tyre është fjalori shpjegues i fjalëve dhe shprehjeve. Në këtë pjesë kemi më shumë fjalë e shprehje të shpjeguara, si p.sh.: **mirënjoh/e-a, humb durimin, i lëndohet shpirti, të shoh të vrerosur, bujar/e, më erdhi zili, është dalldisur për libra, e praruar, duke i shpluhurosur, kokëshkëmb, e çmon.** Në këtë pjesë po ashtu kemi edhe një pikturë të ndërlidhur me përmbajtjen mësimore. Ndërsa puna me tekstin është faqe me vete dhe ka gjithsej 7 pyetje për ushtrime. Pyetjet janë të ndara në dy nivele: kuptojmë tekstin dhe vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin.

**Elisabet Enrajt, Një ditë vere në fermë:** Kjo njësi mësimore në fillim ka referencën nga cili libër është shkëputur. Po ashtu tregohet shkurtimisht se çfarë paraqitet në këtë pjesë. Njësia mësimore është e paraqitur në katër faqe. Bashkë me këto janë edhe vizatime të kafshëve dhe fermës. Anash këtyre faqeve është fjalori shpjegues i fjalëve dhe shprehjeve. Si: **ngulte sytë, tërshër/ë-a, majuc-i, bullafiqe, kuti postare, gic-i, fermer-i, të përvëlohen, sa çel e mbyll sytë.** Puna me tekstin është e ndarë në tri nivele dhe ka gjithsej 9 pyetje me ushtrime. Këto nivele janë: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojmë gjuhën e tekstit. *(Biografia e autores nuk është e paraqitur në fund të librit).*

**Luigji Pandelo, Gabojnë prindërit:** E hijezuar në mënyrë të veçantë është shpjegimi njëparagrafësh i këtij tregimi. Pastaj në dy faqe jepet tregimi dhe anash secilës fjalori shpjegues. Gjithsej janë tri shpjegime të fjalëve dhe shprehjeve: **kremtim, arsyetimin e kanë në maje të gjuhës, kritikon.** Ndërkaq në fund të faqes ku mbaron tregimi kemi edhe fotografinë ku paraqiten fëmijët dhe prindërit. Faqja pasuese është puna me tekstin. Përpos tetë pyetjeve për ushtrime të ndara në kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojmë gjuhën e tekstit, kemi edhe **ftesë** për detyrë. Detyra u kërkon të shkruajnë shkurt për gjërat që i pëlqejnë e prindërit i ndalojnë.

**Azis Nesini, Fëmijët e sotëm:** Në krye të faqes është referenca nga cili libër është marrë tregimi. Gjithashtu, aty jepet një orientim se çfarë flitet në këtë tregim. Kurse 5 faqe të tjera janë të mbushura me tregimin, me fotografi të ndërlidhura me përmbajtjen mësimore dhe me fjalorin shpjegues të fjalëve dhe shprehjeve. Fjalët dhe shprehjet e shpjeguara janë: **i përciptë, posaçërisht, rekomandoj, fëshfëritj/e-a, pasthirm/ë-a, me një mijë bela, ia dha të qeshurit, ilaritet-i, gumëzhiu.** Puna me tekstin ka gjithsej 9 pyetje për ushtrime, të cilat ndahen në kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Po ashtu kemi edhe detyrë për nxënësit, ku kërkohet leximi bukur dhe shkrimi i një ngjarje për të qeshur.

**Maksim Gorki, Dëshira për të lexuar:** Kjo pjesë e ka sqarimin në fillim duke kujtuar kohën e fëmijërisë dhe dëshirën për të lexuar. Në katër faqe është paraqitur kjo pjesë. Anash ka fjalorin shpjegues me gjithsej 5 shpjegime, si: **andrallë-a, ahur-i, ashkël a, i mufatur, shandan-i.** Në fund të pjesës kemi një fotografi të një djaloshi me libër. Faqja tjetër është punë me tekstin. Kjo faqe është e ndarë në tri nivele të pyetjeve për ushtrime dhe një detyrë në fund. Katër pyetje janë në pjesën kuptojmë tekstin, katër vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin dhe 2 në studiojmë gjuhën e tekstit.

**Mark Tueni, Tomi shpëton Bekin:** Në krye të faqes jepet referenca nga ku është marrë kjo pjesë. Bashkë me këtë jepet shkurtimisht se çfarë trajtohet në vazhdim. Pjesa është e paraqitur në tri faqe dhe secila ka anash fjalorin shpjegues të fjalëve dhe shprehjeve. Për shembull: **ambici/e-a, vobektësi-a, gravur/ë-a, ilustrim-i, biblë-a, zhbiroj, adhurim-i, shkëlqimtar.** Në këtë pjesë kemi dy vizatime të ndërlidhura me përmbajtjen mësimore. Puna me tekstin ka gjithsej 14 pyetje për ushtrime, të cilat ndahen në: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Ndërkaq në fund kemi edhe detyrë, ku kërkohet përshkrimi i shkurtër i natyrës së Tom Sojerit.

## 5.7. Proza poetike

Nga proza poetike kemi dy njësi mësimore vetëm nga letërsia shqipe. Është *Bora* e Faik Konicës dhe *Këngë për vdekjen e Skënderbeut* nga autori arbëresh Jeronim de Rada.

**Bora:** Në krye të faqes tregohet se kjo pjesë është e shkruar nga Faik Konica. Kurse, zë gjysmën e faqes me një fotografi, ku paraqitet një peizazh i bukur me borë. Fjalor shpjegues

nuk kemi. Po në të njëjtën faqe ndodhet edhe puna me tekstin që ndahet në kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Gjithsej kemi njëmbëdhjetë pyetje për ushtrime. Me theks të veçantë në fund të faqes jepet edhe shpjegimi për prozën poetike.

**Jeronim de Rada, Këngë për vdekjen e Skënderbeut:** Edhe pse jo si njësitë e tjera mësimore, prapë edhe këtu jepet referenca ku është marrë kjo pjesë. Pjesa e shkëputur paraqitet në faqen e parë bashkë me një fotografi që lidhen me njësinë mësimore. Po ashtu vlen të theksohet se fjalori shpjegues jepet në fund të faqes e jo anash saj. Kemi gjithsej pesë shpjegime: orë hareje, viset, veri-u, u bë dhe, dielli u shua. Në këtë njësi mësimore puna me tekstin është në dy faqe me gjithsej njëmbëdhjetë pyetje dhe hapësirë më të madhe për ushtrime. Pyetjet janë të ndara në tri nivele: kuptojmë tekstin, vlerësojmë e interpretojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Në fund ka edhe një detyrë, ku jepet edhe shembulli.

## 5.8. Lloje të tjera të prozës dhe të dramës

Me këto lloje të shkrimit kemi trembëdhjetë njësi mësimore bashkë me aparaturën didaktike. Sipas llojeve kemi histori në formë tregimesh, përralla, legjenda, fabula, fjalë të urta, dhe lloje të tjera nga gjinia e dramatikës. Këto janë të ndara në letërsi shqipe dhe letërsi botërore. Madje, brenda këtyre kemi edhe nënndarje tjera, si: letërsi popullore dhe letërsi e shkruar.

Të letërsisë shqipe janë: *E bija e hënës* dhe *e diellit* (Mitrush Kuteli), *Rruga për në qytet* (Nazmi Rrahmani), *Plaku me violinë* (Ymer Elashani), *Gjahu i malësoreve* (Konstandin Kristoforidhi), *Liqeni i Prespës* (Legjendë), *Fjalë të urta* (Popullore), *Dy Teutat* (Qamil Batalli), *Shekspiri dhe unë* (Fan Noli) dhe *Po ne qenkemi vëllezër* (Odhise Grillo).

Të letërsisë botërore janë: *Luani dhe miu e Gomari në lëkurë të luani* (Ezopi), *Priami i lutet Akilit* (Homeri), *Vilhelm Teli* (Johan Fridrih Shiler) dhe *Humbja e luanëve* (Jozef Roni).

## 5.9. Struktura për përzgjedhjet letrare nga letërsia shqipe

**Mitrush Kuteli, E bija e hënës dhe e diellit:** Fjalja shpjeguese se kjo përrallë shqiptare e përshtatur është që në fillim të faqes. Poshtë menjëherë fillon përralla. Përralla paraqitet në katër faqe. Faqja e fundit ka edhe një vizatim të ndërlidhur me përmbajtjen e njësisë. Fjalori shpjegues është i paraqitur në secilën faqe të përrallës. Fjalët dhe shprehjet që kanë shpjegim

janë: **përgjërat/ë-a, kuçed/ër-a, shtizle-a grahm/ë-a, bubuti, ngazëllim-i, besëshkelur, bluante në mendje, furfurin, trashëgofsh të ritë tënd.** Puna me tekstin është në dy faqet pasuese. Pyetje për ushtrime kemi gjithsej 16 dhe janë të ndara në kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Po ashtu këtu keni edhe shpjegim të veçantë për përdorimin artistik të *sinonimit*. Në fund jepet një detyrë.

**Nazmi Rrahmani, Rruga për në qytet:** Kjo pjesë e shkëputur është në formë dialogu të djalit me babanë. Referencën nga ku është shkëputur e ka të paraqitur me theks të veçantë. Pjesa është e paraqitur në tri faqe dhe në njëren prej saj kemi një pikturë. Anash secilës faqe kemi fjalorin shpjegues me fjalë e shprehje: **me shikim të mjegulluar, shend e verë, i ka tekur, tollovi-a, terrur, orvatej, më shpejt se rëndom.** Një faqe e veçantë është punë me tekstin me gjithsej nëntë pyetje për ushtrime. Këto pyetje ndahen në tri nivele: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Në fund kemi edhe një detyrë.

**Plaku me violinë:** Tregimi i Ymer Elshanit, sipas shpjegimit të bërë në fillim të faqes, paraqet tërthorazi dy kahe të kundërta të jetës: bukurinë e jetës (violina, muzika) dhe tragjedinë (dhuna njerëzore). Tregimi paraqitet në tri faqe. Në fund ka një pikturë me pëllumba të bardhë që janë simbol i paqes. Fjalori shpjegues është në secilën faqe të tregimit. Fjalët dhe shprehjet që shpjegohen janë: **qytezë/ë-a, bëhem sy e veshë, gjeratore-e-ja, përdallimtare.** Puna me tekstin është e ndarë në tri nivele me gjithsej nëntë pyetje për ushtrime. Nivelet janë: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Ndërsa në fund kemi edhe një detyrë.

**Konstandin Kristoforidhi, Gjahu i Malësorëve:** Pjesa e shkëputur nga “Gjahu i malësorëve” ka shpjegimin njëparagrafësh në fillim. Kjo pjesë e shkëputur paraqitet në tri faqe në formë të bashkëbisedimit. Po ashtu kemi edhe një fotografi ku paraqitet imazhi i disa gjuetarëve. Fjalori shpjegues ka këto fjalë dhe shprehje: **në marrshin erë, s'i trembet syri, fort mirë, langojtë, përqesh, bën dredha, na e zbardh faqen, dergjej, u ngry, të zëmë fshatin me kohë.** Faqja pasuese është punë me tekstin. Kjo punë me tekstin ndahet në dy nivele me gjithsej katërbëdhjetë pyetje. Kuptojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Përmes një paragrafi të veçantë shpjegohet edhe *dialogu*. Kurse në fund kemi edhe një detyrë.

**Qamil Batalli, Dy Teuta:** Tregimi nuk ka ndonjë shpjegim apo referencë siç rëndom kanë pjesët të tjera në Leximin letrar VI. Ky tregim paraqitet në tri faqe dhe anash tyre ndodhet fjalori shpjegues. Kemi pesë fjalë që kanë shpjegimin: **përtrin, ofshani, rrëmbimshëm, u step, e kaploi**. Në faqen e ushtrimeve kemi 10 pyetje të ndara në tri nivele: Kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojme gjuhën e tekstit. Po ashtu, në fund kemi edhe një detyrë.

**Liqeni i Prespës:** Kjo legjendë popullore paraqitet në një faqe. Përpos legjendës për Liqenin e Prespës dhe një imazhi të liqenit, kemi edhe një shpjegim për Legjendën në përgjithësi. Fjalor shpjegues nuk ka. Edhe punë me tekstin nuk ka. Kemi vetëm dy detyra për mësimin e legjendës dhe sjelljen e legjendave të tjera në klasë.

**Fjalë të urta:** (Populli). Qysh në fillim të faqes jepen shpjegime se çfarë kuptojmë me Fjalë të urta. Në po të njëjtën faqe jepen Fjalë të urta sipas tematikës. Bashkë me to ka edhe tri piktura që janë në lidhje të drejtpërdrejtë me tematikat. Po ashtu, në fund të faqes kemi edhe një shpjegim sipas kontekstit të përdorur për fjalën: gunë. Dy faqe tjera janë punë me tekstin. Për secilën tematikë kemi nivelin kuptojmë dhe mësojmë. Gjithsej janë tri tematika. Me tematikë për atdheun kemi dy pyetje për ushtrime, me tematikën për miqësinë kemi katër pyetje për ushtrime dhe me tematikën për vlerën e njeriut kemi katër pyetje. Ndërsa për detyrë jepet nxjerrja e kuptimit për pesëmbëdhjetë fjalë të urta.

**Shekspiri dhe unë:** Kjo pjesë e llojit autobiografi ka referencën në fillim të faqes nga ku është nxjerrë. Po ashtu, edhe shpjegimin e shkurtër të pjesës në vazhdim. Pjesa është e paraqitur në tri faqe. Në fund të pjesës së paraqitur kemi një pikturë. Fjalori shpjegues ka fjalë dhe shprehje të shumta që i shpjegon, si: **prejardhj/e-a, mikroskopik, shëtitës-e, sufler, monolog-u, Otelle, truplë-a, për të mbajtur frymën gjallë, Ofelia, Hamleti, improvizoj, piruet/ë-a, kryevep/ër-a**. Puna me tekstin është në faqe të veçantë dhe ka gjithsej dhjetë pyetje për ushtrime. Pyetjet janë të nivelit: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojme gjuhën e tekstit. Me ngjyrë të theksuar shpjegohet Libri autobiografik.

**Odhise Grillo, Po ne qenkemi vëllezër:** Kjo pjesë e përshtatur nga letërsia e traditës, sipas shpjegimit në fillim të faqes, është shkruar sipas vjershës *Atdheu dhe dashuria e Çajupit*. Dy faqe janë të mbushura me tekstin e kësaj pjesë të paraqitur në formë **bashkëbisedimi**. Fjalori

shpjegues përbëhet prej këtyre fjalëve dhe shprehjeve: **gjym-i, bucel/a. Fillikat, lajle e lule, i (e) ngjeshur, gllënjë/ë-a, motora-ja, arnautk/ë-a, kërcure-ja, kordh/ë-a, nëne-ja, vetëm një hap, t'i shporrim**. Një faqe është punë me tekstin me gjithsej njëmbëdhjetë pyetje e ndarë në: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Faqja tjetër është e veçantë për detyrë. Bashkë me detyrën jepet një fragment nga Atdheu dhe dashuria, si dhe një fotografi që ndërlidhet me përmbajtjen e njësisë mësimore.

## 5.10. Struktura për përzgjedhjet letrare nga letërsia botërore

**Luani dhe miu dhe Gomari në lëkurë të luanit:** Në fillim paraqitet një paragraf që tregon se cilës periudhë i përket fabulisti Ezopi. Pastaj po në të njëjtën faqe kemi fabulat e lartpërmendura bashkë me dy vizatime që kanë ndërlidhje me përmbajtjet e tyre. Puna me tekstin ndahet në dy nivele: kuptojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Në të dy nivelet kemi më shumë shpjegime për fabulat dhe për figurën stilistike *alegorinë*. Gjithashtu, një paragraf i veçantë i kushtohet edhe shpjegimit të *fabulës*. Ndërsa në fund jepet një detyrë.

**Priami i lutet Akilit:** Pjesa e përshtatur për moshat përkatëse në fillim të faqes ka referencën dhe shpjegimin. E gjithë kjo pjesë është paraqitur në formë të dialogut. Gjithsej janë tri faqe ku paraqitet kjo pjesë e shkëputur nga letërsia klasike greke dhe bashkë me të një pikturë. Fjalori shpjegues i fjalëve dhe shprehjeve ka këto shpjegime: **sofra nuk ishte çuar, pinjoll-i, fill i vetëm, është e udhës, qivur-i, azgan, do ta bëjmë gjëmën**. Në dy faqe tjera është puna me tekstin. Gjithsej janë trembëdhjetë detyra të ndara në tri nivele: studiojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Po ashtu kemi një detyrë dhe një fotografi simbol që lidhet me njësinë mësimore.

**Johan Fridirih Shiler, Vilhem Teli:** Kjo pjesë e dramës në fillim ka referencën nga ku është shkëputur. Aty shpjegohet edhe për çfarë flitet në këtë dramë. Pastaj në katër faqe paraqitet drama. Gjithashtu kemi edhe një pikturë. Fjalët dhe shprehjet e shpjeguara janë: **kësul/ë-a, mori nishan, mà kënda, celni rrugën, tutesh**. Puna me tekstin ka gjithsej 14 pyetje për ushtrime. Të gjithë këto pyetje ndahen në tri nivele: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Te puna me tekstin ka edhe shpjegim për dramën si gjini letrare. Në fund kemi edhe një detyrë.

**Humbja e luanëve:** (Jozef Roni). Referenca nga ku është shkëputur kjo njësi mësimore dhe shpjegimi se për çfarë bëhet fjalë është në fillim të faqes. Në tri faqe është kjo pjesë dhe bashkëngjitur njëra nga faqet ka një vizatim të luanit. Fjalori shpjegues i fjalëve dhe shprehjeve përfshin: **i zhdërvjellët, i ngjirur, palm/ë-a, nuhat, cektësi/ë-a, fillikat, usht/ë-a, kacuk/e-ja, mëdyshj/e-a.** Puna me tekstin ndahet në tri nivele dhe ka gjithsej njëmbëdhjetë pyetje për ushtrime. Nivelet janë: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Po ashtu në fund kemi një detyrë dhe një vizatim që ndërlidhet me lashtësinë që shpjegon njësi mësimore. (Biografia e shkrimtarit në fund të librit nuk është paraqitur fare).

### **5.11. Shkrimet joletrare dhe struktura didaktike**

Theks të veçantë në këtë libër kanë edhe shkrimet joletrare. Këto janë të përfaqësuara me gjashtë njësi mësimore. Përmes njësive mësimore dhe pjesës tjetër të aparaturës didaktike shpjegohet: *shkrimi shkencor, reportazhi, libri biografik, udhëpërshkrimi, shkrimi fantastiko shkencor dhe shkrimi didaktik.* Pjesët e shkëputura janë kryesisht të autorëve të huaj. Nga gjithsej gjashtë njësi mësimore: katër janë të autorëve të huaj, një është nga Enciklopedia për fëmijë dhe një është me autor shqiptar. Në fund të librit përpos biografive të shkrimtarëve, kemi edhe udhëzime për përdorimin e tekstit. Këto udhëzime jepen në dy faqe në fund të librit.

Të autorëve të huaj:

**Stefan Cvajg, Ngushtica e Megelanit:** Kjo pjesë në fillim të faqes ka referencën nga ku është shkëputur dhe shpjegimin se çfarë flitet në vazhdim. Janë dy faqe ku paraqitet kjo pjesë. Anash secilës faqe është edhe fjalori shpjegues me fjalë dhe shprehje, si p.sh.: **krahët e lashta, flakëruese, kozmografi-t, gërshetim-i, fjarade-t, cektina-t, e shprishur.** Puna me tekstin është në dy faqe e ndarë në tri nivele me gjithsej dymbëdhjetë pyetje për ushtrime. Nivelet janë: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Bashkë me punën me tekstin kemi edhe një fotografi të Globit dhe shpjegimin e veçantë për *Librin biografik.*

**Marko Polos, Njëpër rrugët e Azisë:** Paragrafi ku paraqitet referenca nga ku është marrë kjo pjesë dhe shpjegimi i shkurtër është në fillim të faqes. Pastaj më poshtë jepet pjesa në tri faqe. Po ashtu kemi edhe një fotografi që ndërlidhet me përmbajtjen e njësive mësimore. Fjalori

shpjegues i shpjegon këto fjalë dhe shprehje: **haset, shkretëtirë-a, bëzante-i, gjedhi-i, llum-i, lajmëtarë-t, qerr/e-ja, rrëshqitës/e-ja**. Faqja në vijim është punë me tekstin.

Kjo faqe ka 10 pyetje për ushtrime dhe ndahet në nivelet: kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, si dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Po ashtu, me theks të veçantë, shpjegohet edhe *udhëpërshkrimi*. Në fund kemi një detyrë.

**Zhyl Vernit, Nëpër thellësitë e detit:** Në fillim të faqes kemi paragrafin që tregon referencën se nga cili libër është shkëputur kjo pjesë. Pjesa paraqitet në dy faqe bashkë me një fotografi. Fjalori shpjegues ka dy shpjegime: **Nautilitis, milj/e-a**. Puna me tekstin ka pesë pyetje për ushtrime të ndara në dy nivele: kuptojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Shpjegim të veçantë ka shkrimi *Fantastiko shkencor*. Kemi edhe një detyrë në fund të faqes së punës me tekstin.

**Këshilla për Domenikun:** (Sokrati). Këshillat e paraqitura në këtë pjesë që në fillim tregohen nga kush janë shkruar dhe cilës periudhë i përket autori i këshillave. Këshillat paraqiten në dy faqe bashkë me një fotografi që ndërlidhet me kontekstin kur janë treguar këto këshilla. Fjalët dhe shprehjet që shpjegohen janë: **lakmoj, pikërisht, lavdi-a, shpifj/e-a, përtoj, i njerëzishëm, heshtj/e-a**. Faqja tjetër është punë me tekstin. Kjo punë ndahet në tri nivele: Kuptojmë tekstin, vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, studiojmë gjuhën e tekstit. Për secilin nivel është nga një pyetje për ushtrime. Vlen të theksohet se në mënyrë të veçantë kemi edhe shpjegimin për *Tekstin didaktik*. Po ashtu, në fund, kemi edhe një detyrë që kërkon mësimin përmendsh të ndonjë këshille të karakterit të tillë.

Të autorit shqiptar:

**Ramiz Kelmendi, Në veri:** Pjesa në formë reportazhi paraqitet në dy faqe të librit. Gjithashtu, te kjo njësi mësimore kemi edhe një fotografi që nënkupton udhëtim. Fjalori shpjegues përbehet prej këtyre fjalëve: **konfiguracion-i, vakuum-i, djerrakohës, kafiteri/ja**. Në krye të faqes punë me tekstin kemi shpjegimin për Reportazhin. Pastaj janë pesë pyetje për ushtrime të ndara në dy nivele: kuptojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Kurse në fund kemi një detyrë.

Nga Enciklopedia për fëmijë:

**Peshqit bien nga qielli:** Pjesa që në fillim të faqes ka referencën nga ku është marrë, paraqitet në dy faqe. Së bashku kemi edhe një fotografi që ndërlidhet me përmbajtjen mësimore. Fjalori



shpjegues i fjalëve përfshin këto fjalë: **shtrungat/ë-a, i mahnitur, fotoreporter-i, ihtialog-u, legjendë-a, uragan-i**. Puna me tekstin ka gjithsej tetë pyetje për ushtrime. Pyetjet ndahen në dy nivele: kuptojmë tekstin dhe studiojmë gjuhën e tekstit. Ndërsa një detyrë jepet në fund. Brenda pyetjeve të ushtrimeve kemi edhe shpjegimin për shkrimin shkencor.

## 5.12. Qasja e veçantë për elementet letrare edhe joletrare

Shpjegimi i elementeve të tjera letrare e joletrare bëhet brenda njësive mësimore të lartpërmendura. Gjegjesisht, bëhet brenda punës me tekstin, ku në mënyrë të veçantë shpjegohen elementet të shumta letrare dhe joletrare, duke i ndërlidhur me përmbajtjen mësimore. Më poshtë do të paraqesim secilin element letrar e joletrar se në cilën njësi mësimore shpjegohet:

*Tema dhe ideja*: Njësia mësimore- Mandolina; *Ditari*: Njësia mësimore- Mirënjohja; *Personazhet*: Njësia mësimore- Një ditë vere në fermë; *Letra*: Njësia mësimore- Letër nga fshati; *Simboli*: Njësia mësimore- Djali dhe deti; *Humori*: Njësia mësimore- Fëmijët e sotëm; *Epiteti*: Njësia mësimore- Bagëti e Bujqësi; *Krahasimi*: Njësia mësimore- Gjuha shqipe; *Rima*: Njësia mësimore- Vjeshta; *Hiperbola*: Njësia mësimore- Bota fëmijërore; *Legjenda*: Njësia mësimore Liqeni i Prespës; *Sinonimet*: Njësia mësimore- E bija e hënës dhe diellit; *Alegoria*: Njësia mësimore- Gomari në lëkurë të luanit; *Dialogu*: Njësia mësimore- Gjahu i malësorëve; *Proza poetike*: Njësia mësimore- Bora; *Drama*: Njësia mësimore- Vilhem Teli; *Autobiografia*: Njësia mësimore- Shekspiri dhe unë; *Shkrimi shkencor*: Njësia mësimore- Peshqit bien nga qielli; *Reportazhi*: Njësia mësimore- Në veri; *Libri biografik*: Njësia mësimore- Ngushtica e Magalanit; *Udhëpërshkrimi*: Njësia mësimore- Nëpër rrugët e Azisë; *Shkrimi fantastiko-shkencor*: Njësia mësimore- Nëpër thellësitë e detit; *Shkrimi didaktik*: Njësia mësimore- Këshilla për Domenikun.

## VI. STRUKTURA NË LIBRIN LEXIMI LETRAR 7

Qasje hyrëse

Nga vështrimi përshkrues do të paraqesim në detaje strukturën didaktike të Leximit letrar VII. Përpos paraqitjes përshkruese do të bashkëngjisim grafikonin përmbledhës dhe, me anë të cilit, do të tregojmë në përqindje për secilën pjesë të aparaturës didaktike në këtë libër.

*Libër leximi VII* është i miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë dhe përdoret në të gjitha shkollat shqipe. Autorët e këtij libri janë: Mazllom Kumnova dhe Munish Hyseni. Botues i këtij libri është Shtëpia Botuese Libri Shkollor.

Libri i leximit në këtë klasë është i ndarë në pesë pjesë me tematika të ndryshme. Secila pjesë ka lloje të ndryshme të shkrimit. Pjesa e parë nuk ka ndonjë emërtim, por është e gjitha me autorë shqiptarë dhe tematika kryesisht është me motive patriotike. Kjo pjesë fillon menjëherë me poezinë Gjuhës shqipe të autorit Mitrush Kuteli. Katër pjesë të tjera janë: *Përjetësia*, *Dhuratë njerëzimit*, *Kush jam unë* dhe *Bota e fshehtë*. Te secila pjesë, përjashtoj pjesën e parë, kemi pjesë letrare nga autorë shqiptarë dhe autorë botërorë. Mirëpo, vlen të theksohet se poezi nga autorë të huaj nuk kemi të përfaqësuara në këtë libër.

Megjithatë, vështrimi përshkrues i strukturës didaktike do të bëhet sipas llojeve të shkrimit në këtë tekst. Bashkë me këtë përshkrim, ne do të paraqesim edhe një grafikon nëmbledhës që përfshin në përqindje aparaturën didaktike në këtë tekst.

### 6.1. Poezia lirike

Fjala e bukur brenda poezive më përfaqësuese të letërsisë shqipe është burim fisnikërimi filloristët. Për t'i sjellë kënaqësi në lexim dhe për t'i sjellë informacione cilësore filloristëve. Tekstet letrare duhet të kenë përmbajtje cilësore me kritere shkencore, psikologjike, didaktike e etike. Pa këto kritere, në tekstet letrare, nxënësit e kanë të vështirë t'i përjetojnë të mirat e leximit letrar, t'i zgjerojnë horizontet e tyre botëkuptimor, t'i përvetësojnë aftësitë hulumtuese e krijuese dhe ta thellojnë mendimin kritik. Andaj, përzgjedhja e poezive me tematika të ndryshme dhe renditja e tyre brenda librit, si dhe respektimi i kritereve e, veçanërisht, atij didaktik e estetik, ka rëndësi të veçantë në tekstin letrar që përdoret në shkolla.

Në Leximin letrar VII poezia lirike me tematika të ndryshme përfaqësohet vetëm prej autorëve shqiptarë. Poezi të huaja nuk kemi. Siç rëndom ndodh edhe në tekstet e leximeve të klasave

tjera, tematika atdhetare zë një vend të rëndësishëm. Përpos tematikës atdhetare, ka edhe poezi me tematike përshkruese, të përshpirtshme, të dashurisë e meditative. Brenda këtyre poezive shpjegohen edhe lloje të ndryshme të poezisë lirike, si: himni, oda, ditirambi dhe elegjia.

Në këtë tekst shkollor janë të përfshira gjithsej njëmbëdhjetë poezi. Të gjitha janë të letërsisë shqipe. Poezitë e autorëve shqiptarë të përfaqësuar në këtë tekst janë: *Gjuhës shqipe (Mitrush Kuteli)*, *Hymni i Flamurit (Fan S. Noli)*, *Skënderbeu (Jeronim de Radà)*, *Baladë çame (Bilal Xhaferi)*, *Nusja nga Kosova (Dritëro Agolli)*, *Ti fluturon me dallëndyshe (Yllka Domi)*, *Vaji për Prishtinën (Sabri Hamiti)*, *Te varri i dëshmorit të panjohur (Eqrem Basha)*, *Nëna (Frederik Reshpja)*, *Zonja Elena Gjike (Zef Serembe) dhe Vrimë e parë e fyellit tim (Ali Podrimja)*. Poezitë e përfaqësuar, siç shihet nga kjo, janë të rilindësve dhe të shkrimtarëve të sotëm të letërsisë shqipe.

*Poezi atdhetare:* Gjuhës shqipe, Hymni i Flamurit, Skënderbeu, Baladë Çame, Zonja Elena Gjike (Odë)

*Poezi me tematika të ndryshme:* Nusja nga Kosova, Ti fluturon dallëndyshe, Vaji për Prishtinën, Te varri i dëshmorit të panjohur, Nëna dhe Vrimë e parë e fyellit tim.

### **Poezia atdhetare dhe struktura**

**Mitrush Kuteli, Gjuhës shqipe:** Në faqen e parë bashkë me poezinë kemi edhe një ilustrim. Fjalori shpjegues, puna e pavarur dhe bisedojmë për tekstin është në faqe të vecantë. Te fjalori shpjegues kemi këto fjalë: *tempull-i, shtërpën-j, shtëng, vrungullon, uturin, hoje, hobe, mbrujtur*. Puna e pavarur ka gjithsej pesë ushtrime dhe, po ashtu, bisedojmë për tekstin ka pesë pyetje për ushtrime. Një faqe e posaçme është për biografinë e autorit bashkë me fotografinë e tij dhe shpjegime për gjuhën shqipe.

**Fan S. Noli, Hymni i Flamurit:** Në krye të faqes kemi një mendim të Sabri Hamitit për këtë poezi. Pastaj paraqitet poezia bashkë me ilustrimin. Faqja tjetër fillon me shpjegimet për ngjarjet dhe personalitetet e përmendura në vjershë. Pastaj kemi bisedojmë për poezinë, e cila përbëhet prej tetë pyetjeve për ushtrime. Punë e pavarur, biografia e autorit me fotografi dhe mësojmë më shumë është në faqe të veçantë. Të mësojmë më shumë shpjegohet *simboli dhe himni*.

**Jeronim de Rada, Skënderbeu:** Referenca në fillim të faqes tregon se nga ku janë shkëputur këto vargje. Po ashtu një fjali tregon kushtimin e këtyre vargjeve. Vargjet e poezisë jepen

bashkë me një pikturë të Skënderbeut. Faqja pasuese është bisedojmë për poezinë me katër pyetje për ushtrime dhe punë e pavarur. Biografia e autorit jepet bashkë me fotografinë e tij. Kurse fjalori shpjegues është në fund me këto fjalë: *këmbanë-a, altar-i, vatër-ra, medet, çadër-dra*.

**Bilal Xhaferi, Baladë çame:** Te faqja e parë bashkë me poezinë kemi edhe pjesën bisedojmë për tekstin me gjithsej katër pyetje për ushtrime. Po ashtu poshtë faqes kemi edhe një ilustrim. Faqja pasuese përbëhet prej biografisë së shkrimtarit, pjesës punë e pavarur, mësojmë më shumë dhe në fund fjalorit shpjegues. Fjalët që shpjegohen janë: *Baladë-a, kreshtlë-a, muhaxhir-i*.

**Zef Serembe, Zonjës Elena Gjika:** Në fillim të faqes jepet një biografi e shkurtër për Elena Gjickën. Pastaj, paraqitet oda bashkë me një portret të Elena Gjickës. Te faqja tjetër është pjesa mësojmë më shumë, ku shpjegohet oda dhe kush e ka kultivuar më shumë këtë lloj të poezisë lirike. Po në të njëjtën faqe kemi: bisedojmë për tekstin me gjithsej shtatë pyetje për ushtrime, punë e pavarur dhe biografinë e Zef Serembes.

## 6.2. Poezi me tematika të ndryshme

**Dritëro Agolli, Nusja nga Kosova:** Poezia paraqitet bashkë me një fotografi ku paraqitet një grua me veshje tradicionale. Faqja pasuese është bisedojmë për tekstin me gjithsej shtatë pyetje për ushtrime. Anash është biografia e autorit bashkë me fotografinë e tij.

**Yllka Domi, Ti fluturo dallëndyshe:** Në krye të faqes kemi disa të dhëna për Yllka Domin. Po ashtu edhe një mendim të studiuesit Agim Byci. Në të njëjtën faqe dhe në faqen tjetër paraqitet poezia. Ilustrimi jepet në faqen e parë ku ndodhet poezia. Faqja ku është edhe strofa e fundit e poezisë ka edhe një ilustrim tjetër. Anash kemi pjesën bisedojmë për tekstin me gjithsej pesë pyetje për ushtrime. Biografia e shkurtër bashkë me foton jepet në fund të faqes së dytë.

**Sabri Hamiti, Vaji për Prishtinën:** Poezia është e paraqitur në dy faqe. Në faqen e parë bashkë me poezinë është edhe një fotografi e një pjesë të Prishtinës. Faqja tjetër përpos vargjeve të fundit të poezisë përbëhet edhe prej pjesës bisedojmë për tekstin me shtatë pyetje për ushtrime, punë e pavarur dhe anash me biografinë e autorit bashkë me fotografinë e tij. Kurse, fjalori shpjegues me tri fjalë jepet në fund, si: *rebeluar, zhagiten, humnerë*.

**Eqrem Basha, Te varri i dëshmorit të panjohur:** Faqja e parë është me poezinë e paraqitur dhe me një fotografi të një varrit të dëshmorit të panjohur. Kurse në faqen pasuese kemi bisedojmë për tekstin me shtatë pyetje për ushtrime, punë e pavarur dhe me biografinë e autorit bashkë me fotografinë.

**Fredrik Reshpja, Nëna:** Faqja hapet me një portret të nënës, pastaj paraqitet poezia. Faqja tjetër është e ndarë në punë të pavarur, përkujtojmë, shpjegimi për portretin, bisedojmë për poezinë me gjithsej shtatë pyetje për ushtrime, si dhe biografia e shkrimtarit.

**Ali Podrimja, Vrima e parë e fyellit tim:** Në krye të faqes kemi një paragraf që ndërlidhet me poezinë. Pastaj jepet poezia po në të njëjtën faqe. Kurse në faqen tjetër kemi pjesën mësojmë më shumë, ku shpjegohet *metafora*, *aliteracioni* dhe *distiku*, kemi pjesën tjetër bisedojmë për tekstin me katër pyetje për ushtrime dhe gjysma tjetër e faqes është me një ilustrim. Në faqen e tretë të kësaj njësie mësimore, kemi biografinë e autorit dhe punë e pavarur, ku jepen ushtrime në lidhje me fjalë në kontekstin e poezisë.

### 6.3. Poezia epike

Meqenëse poezia epike si zhanër është tejet e lashtë dhe, njëkohësisht, gjithnjë ka pasur rëndësinë e vet nëpër periudha historiko-letrare, përfshirja në tekstin e Leximit letrar VII nuk mund se si të mungojë. Vlerat historiko-letrare, estetike e didaktike të këtyre krijimeve, veçanërisht të përzgjedhura e të përshtatura për moshat përkatëse, janë domosdoshmëri në realizimin e funksioneve didaktike që dalin nga kriteret për hartimin e një teksti letrar.

Në Leximin letrar VII kemi të përfshirë një poezi epike. Poezia është e autorit Gjergj Fishta e titulluar Lidhja e Prizrenit dhe e shkëputur nga Lahuta e Malcisë.

**Gjergj Fishta, Lidhja e Prizrenit:** Këto vargje të shkëputura nga Lahuta e Malcisë paraqiten në dy faqe. Bashkë me këto anash kemi edhe pjesën bisedojmë për tekstin me gjithsej pesë pyetje. Po ashtu, kemi fotografinë e objektit të Lidhjes së Prizrenit dhe poshtë faqes së dytë fjalorin shpjegues me këto fjalë: *kren*, *capua-oi-njtë*, *me hi*, *dan*, *zabel*, *erz-i*, *logu*, *kollçikë-t*. Dy faqet tjera janë: Punë e pavarur me ushtrime për vargjet dhe figurën e Abdyl Frashërit dhe faqja e fundit është mësojmë më shumë, ku flitet shkurtimisht për Lahutën e Malcisë. Gjithashtu kemi një mendim të Rexhep Qosjes për Fishtën, një fotografi të katër autorëve: Fishta, Asdreni, Poradeci dhe Koliqi, si dhe biografinë e Gjergj Fishtës me fotografi.

## 6.4. Krijimet në prozë e dramë

Përzgjedhjet e krijimeve në prozë, me situata e konflikte të ndryshme, duke paraqitur momente mesazhdhënëse jetësore, para së gjithash, janë në funksion të edukimit estetik, të nënietimit të kënaqësisë estetike, të edukimit gjuhësor, etnik, etik e psikologjik. Por, me gjithë këto qëllime fisnike, shpeshherë në tekstet shkollore të letërsisë paraqitja e krijimeve në prozë as sipas kriterit historiko-letrar, as sipas kriterit tematik nuk është në përputhshmëri me kriteret e hartimit të një teksti shkollor. Përpos kësaj, e që është tepër me rëndësi, kriteri didaktik duhet të respektohet, sepse, mosrespektimi i kriterit didaktik në mënyrë të përpiktë, afërmendsh sjell paqartësi e pamundësi për mësimdhënie e mësimnxënie efektive.

Në Leximin letrar VII krijimet në prozë përfaqësohen prej autorëve shqiptarë dhe prej autorëve të huaj. Tematikat e këtyre krijimeve në prozë janë të ndryshme. Këto tematika do t'i paraqesim përkitazi me përshkrimin e strukturës didaktike të këtyre krijimeve në prozë. Po ashtu, llojet e shkrimit në prozë janë të ndryshme, si: tregim, novelë, mite e fragmente të shkëputura nga romani.

Te ky libër përfshihen gjithsej tetëmbëdhjetë njësi mësimore. Të gjuhës shqipe janë dhjetë njësi mësimore të paraqitura në prozë. Ato janë: *Shënime nga kapitaneria e portit* (Ismail Kadare), *Kënga e fundit e Marko Boçarit* (Faik Ballanca), *Qyteti i rrethuar* (Jusuf Buxhovi), *Vdekja e Akanit* (Arif Demolli), *Gjergj Elez Alia (letërsi popullore)*, *Stuhia e dëborës* (Roland Gjoza), *Malli i atdheut* (Faik Konica), *Klithma* (Anton Pashku), *Ay mal* (Midhat Frashëri) dhe *Planeti i kaltër* (Brunilda Zllami). Ndërsa të letërsisë botërore përfshihen tetë njësi mësimore dhe të cilat janë: *Prometeu (mit)*, *Bota e sofisë* (Jostein Gaarder), *Klara në mal* (Johana Shpiri), *Kolombreja* (Dino Buxati), *Kaju Herman dhe Horst Piku*, *Ne fëmijët nga stacioni hekurudhor ZOO*, *Kapiteni Sandi* (Zhyl Vern), *Xhamat që zhduken* (J.K. Roëling) dhe *Elektronku* (E. Vellistov).

## 6.5. Përzgjedhjet në prozë nga letërsia shqipe

**Ismail Kadare, Shënime nga kapitaneria e portit:** Pjesët e paraqitura në fillim të faqes kanë një pikturë më të madhe se rëndom, pastaj është një paragraf shpjgues që ndërlidhet me njësinë. Në dy faqe paraqiten pjesët letrare në formë të ditarit. Faqja dytë ka edhe biografinë e autorit bashkë me fotografi dhe pjesën bisedojmë për tekstin me gjithsej dhjetë pyetje për

ushtrime. Faqja e tretë e ka nivelin punë e pavarur me një pyetje, një pikturë të vogël dhe fjalorin shpjegues në fund e këto fjalë: *kapitaneri-a, port-i, refugjat-i, mol-i, kanxhë-a, sepet, aleat-i, martir-i, ajme, parmendë-a, kthjelltësinë që të lëbyrtë sytë dhe milja*.

**Faik Ballanca, Kënga e fundit e Marko Boçarit:** Ky fragment i shkëputur nga novela me të njëjtin titull, është i paraqitur në një faqe. Faqja tjetër ka një pikturë, nivelin mësojmë më shumë, nivelin bisedojmë për tekstin me gjashtë pyetje për ushtrime, biografinë e autorit, si dhe fjalorin shpjegues të fjalëve dhe shprehjeve, si: *suli, meteor-i, ne jemi gladiatorë, arenë-a, eladë-a, një bulë uji, kriza dhe të Konstandinit um'ë*.

**Jusuf Buxhovi, Qyteti i rrethuar:** Ky fragment i shkëputur nga romani *Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit* paraqitet në katër faqe të tekstit. Po ashtu kemi një pikturë të madhe që shtrihet në të dy faqet e para. Në faqen e katërt kemi anash edhe nivelin bisedojmë për tekstin me gjithsej tetë pyetje. Faqja e fundit është me nivelin punë e pavarur, një ilustrim, biografinë bashkë me foton e autorit dhe fjalorin shpjegues të këtyre fjalëve: *kajmekam-i, murtajë-a, mordja, fermani-i, tellall-i dhe perfeksionon*.

**Arif Demolli, Vdekja e Akanit:** Fragmenti i shkëputur nga romani me të njëjtin emër është i pranishëm në tri faqe të librit. Në faqen e dytë bashkë me fragmentin kemi edhe një fotografi. Kurse niveli bisedojmë për tekstin është në faqen e tretë të kësaj njësie me gjithsej tetë pyetje për ushtrime. Faqja e fundit ka nivelin mësojmë më shumë ku shpjegohet veçmas shumëpikëshi, niveli punë e pavarur, biografia e autorit dhe fjalori shpjegues me këto fjalë e shprehje: *tërbimi, milli, ndëshkim, mëkatar-i, turma e tërbuar, mekur, ekzaltim, xhindosur*.

**Mitrush Kuteli (rikallëzime popullore), Gjergj Elez Alia:** Ky tregimi është shkëputur nga libri “Tregime të moçme shqiptare”. Në krye të faqes kemi një shpjegim për këngën popullore epike legjendare me të njëjtin titull. Ky tregim me Stive popullore paraqitet në pesë faqe të tekstit. Në dy prej tyre kemi edhe ilustrime. Kemi edhe fjalor shpjegues me këto fjalë: *dergjet, haraq-i, prehje-a, nalban-i, erë krem, i kapitur*. Faqja e fundit ka nivelin mësojmë më shumë ku chniegohet Hiperbola e letërsia gojore. Pastaj kemi nivelin bisedojmë për tekstin me oüithsej dhjetë pyetje për ushtrime dhe në fund kemi nivelin punë e pavarur.

**Roland Gjoza, Stuhia e dëborës:** Ky tregim me personazh Betovenin në fillim të faqes ka një paragraf që fton për një çast meditimi. Menjëherë në vijim kemi tekstin që paraqitet në tri faqe. Po në faqen e parë kemi edhe gjashtë pyetje për ushtrime të ndara në bisedojmë për

tekstin. Fjalori shpjegues jepet anash faqes dytë me këto fjalë e shprehje: *marshi funebër, marshall-i, shkrotëtimat e kuajve, pendë-a, kortezh-i, giparis-i, rekuem-i, partiturë-a, labirint-i, fastër-i, në sallën e filharmonisë, trumbetat dhe daullet*. Faqja e fundit përpos fotografisë ka edhe nivelin punë e pavarur dhe biografinë e autorit.

**Brunilda Zllami, Planeti i kaltër:** Fragmenti i paraqitur në tri faqet e këtij teksti është shkëputur nga romani *Dija*. Ky fragment fillon me një paragraf shpjegues. Gjithashtu në dy faqe kemi edhe ilustrime. Faqja e tretë ka edhe pjesën punë e pavarur, provo edhe këtë, ku shpjegohet romani fantastiko-shkencor dhe biografinë e autores. Faqja e fundit është bisedojmë për tekstin me gjithsej dymbëdhjetë pyetje për ushtrime dhe fjalorin shpjegues me këto fjalë e shprehje: *vorbull-a, perfeksion, qenie inteligjente, devijim, pigment, melaminë*.

**Midhat Frashëri, Ay mal:** Tregimi i paraqitur në formë të dialogut është paraqitur në dy faqe të librit. Bashkë me të është niveli bisedojmë për tekstin me pesë pyetje për ushtrime, ilustrimi dhe fjalori shpjegues me këto fjalë dhe shprehje: *fortesë-a, Suli, Filati, Janina, vendi t'ënë, kaq'gjerra, të vrejshime, fushave pëllore, dhen*. Në faqen e fundit kemi punë e pavarur me një kërkesë për ushtrime dhe biografinë e autorit bashkë me fotografinë.

## 6.6. Krijimet në prozë poetike

**Faik Konica, Malli i atdheut:** Faqja ku ndodhet ky krijim ka në fillim një paragraf që ndërliidhet me përmbajtjen. Pastaj përpos krijimit të paraqitur, kemi edhe fotografi e ilustrime. Faqja pasuese është me biografinë e autorit bashkë me fotografinë, nivelin hisedojmë për tekstin me pesë pyetje për ushtrime, si dhe fjalorin shpjegues me këto fiale të *ra, dendur, shëntmë*. Faqja e fundit bashkë me ilustrime ka edhe nivelin mësojmë më shumë ku shpjegohet fjala *tekst* dhe punë e pavarur me disa kërkesa për ushtrime. Anton Pashku, Klithma: Faqja e parë hapet me një paragraf rreth veprimtarisë së Anton Pashkut. Pastaj paraqitet tregimi i shkurtër bashkë me ilustrime. Faqja tjetër ka nivelin bisedojmë për tekstin me tetë pyetje, punë e pavarur, biografinë e autorit bashkë me fotografinë dhe fjalorin shpjegues me këto fjalë: *rrigë, syprinën, rimon, bulk*.



## 6.7. Përzgjedhjet në prozë nga letërsia botërore

**Prometeu:** Mit nga mitologjia greke. Paragrafi hyrës shpjegon për kohët e lashta kur kanë rrefyer njerëzit për zotat dhe krijesat hyjnore. Miti paraqitet në dy faqe. Në faqen e dytë kemi nivelin bisedojmë për tekstin me tetë pyetje për ushtrime, nivelin punë e pavarur me tri ushtrime dhe nivelin mësojmë më shumë ku shpjegohet *miti dhe mitologjia* në veçanti. Fjalori shpjegues jepet në fund të faqes me këto fjalë: *guvë-a, çukit, martir-i, gojëdhënë-a, Zeusi, Titani Japet, Herakliu.*

**Jostien Gaarder, Bota e Sofisë:** Fragmenti i shkëputur nga romani Bota e Sofisë në fillim ka një paragraf me disa pyetje. Pastaj paraqitet fragmenti në tri faqe. Niveli bisedojmë për tekstin ka nëntë pyetje për ushtrime. Punë e pavarur jepet në faqen e Gundit në lidhje me filozofin. Po ashtu mësojmë më shumë ku shpjegohet filozofia, hinorafia e autorit bashkë me fotografi, si dhe fjalori shpjegues me këto fjalë: *hobi, strice, kurs-i, iluzion-i, truk-u, enigmatike, kulltuk-u, i adaptuar.*

**Johana Shpiri, Klara në mal:** Në fillim të këtij fragmenti kemi tri pyetje në formë fase për mendim krijues. Fragmenti i shkëputur nga romani “Hajdi” paraqitet në tri faqe të librit bashkë me një ilustrim. Faqja e fundit ka nivelin mësojmë më shumë që rekomandon leximin e romanit, nivelin punë e pavarur, bisedojmë për tekstin me dhjetë pyetje për ushtrime dhe në fund fjalori shpjegues me këto fjalë: *parfumuan, soditnin, sugjerim-i, i ngazëllyer, papafingo.*

**Dino Buxati, Kolombreja:** Fillimi i faqes së parë është me një paragraf shpjegues për Kolombrenë. Tregimi paraqitet në pesë faqe. Në një faqe të veçantë është një ilustrim i këtij lloji të peshkut. Niveli bisedojmë për tekstin ka nëntë pyetje për ushtrime. Kemi të paraqitur biografinë e autorit. Fjalori shpjegues me fjalë dhe shprehje paraqitet anash dy faqeve të fundit në këtë njësi mësimore, si: *vel-i, kuvertë a, pupë-a, vazhdë-a, tejqyrë-a, kapedan-i, misterioz-e, viktimë-a, bizon-i, stere-ja, përbindësh-i, mirazh i zyrtë, bunancë-a, ortak-u, fuzhnjë-a, kosore-ja, bash-i, perlë-a.* Niveli punë e pavarur jepet në fund të njësisë mësimore.

**Kaju Herman dhe Horst Piku, Ne fëmijët nga stacioni hekurudhor 200:** Ky fragment i shkëputur nga romani biografik me titull të trilluar *Kristiana F.* Një paragraf në fillim është për autorët e romanit dhe idenë se si kishte filluar ky roman. Fragmenti paraqitet në katër faqe të librit. Në faqen e dytë kemi edhe një fotografi që ndërlidhet me njësinë mësimore. Niveli bisedojmë për tekstin ka dymbëdhjetë pyetje për ushtrime. Punë e pavarur ka disa ushtrime.

Fjalori shpjegues jepet në fund të njësisë mësimore me këto fjalë: *Stacioni hekurudhor Zoo, frajer, detektiv-i, blu jenseve, turkey, narkoman-i, narkotikë, dorgë-a, fiks.*

**Zhyl Vern, Kapiten Sandi:** Fragmenti i shkëputur nga romani *Kapiteni 15 vjeçar* paraqitet në tri faqe të librit brenda të cilave njëra është e tëra me një foto. Po ashtu, edhe ky fragment në fillim ka një paragraf shpjegues. Në njërën faqe anash kemi bisedojmë për tekstin me dhjetë pyetje. Faqja e fundit ka punë të pavarur, mësojmë më shumë, biografinë e autorit bashkë me fotografinë dhe në fund fjalorin shpjegues me këto fjalë: *lebeti, Nostrom-i, balenierë-a, sekstant-i.* ,

**J. K. Roëling, Xhamat që zhduken:** Fragmenti i shkëputur nga “Harri Poteri dhe dhomat e të fshehtave” në fillim ka një fotografi të personazhit të Herri Poterit. Pastaj fragmentin. Anash faqes së tretë kemi nivelin bisedojmë për tekstin në tri faqe kemi fragmentin. Anash faqes së tretë kemi nive me tetë pyetje për ushtrime. Faqja e fundit është punë e pavarur, mësojmë më shumë rreth veprave të autores, biografinë bashkë me fotografi dhe në fund fjalorin shpjegues me këto fjalë: *magji-a, magjistari-i, monotone, misterioze, naze, kobra, boa.*

**Majn Rid, Lëndina e miqësisë:** Ky tekst (i shkëputur) me karakter edhe edukativ paraqitet në tri faqe të librit. Mbi të është një paragraf me disa pyetje. Niveli bisedojmë për tekstin ka gjithsej njëmbëdhjetë pyetje për ushtrime. Po ashtu kemi nivelin punë e pavarur, biografinë e autorit me fotografi, si dhe fjalorin shpjegues me këto fjalë: *kastë-a, kurdisur, marifet, ogurzezë, aluzion, remtarë.*

**E. Vellistov, Elektroniku:** Fragmenti është shkëputur nga romani *Elektoniku*. Ky fragment përpos që në fillim ka një paragraf në formë prologu, ai po ashtu paraqitet në tri faqe të këtij teksti shkollor. Një faqe e veçantë është me ilustrime. Kurse faqja e fundit ka punë e pavarur, mësojmë më shumë, bisedojmë për tekstin më shtatë pyetje dhe fjalorin shpjegues me këto fjalë: *elektroniku, teoremë-a, pitagora, Euklidi, dekompozimi.*

## 6.8. Krijimet në dramë

Teksti i dramës, edhe pse në forma të ndryshme, ka një ngjarje që zhvillohet njëjtë sikur në përralla, tregime apo romane. Megjithatë, për dallim nga këto, teksti i dramës në harmoni me kërkesat e natyrës dramatike përpos dialogut, kërkon vënien në skenë dhe lojën në teatër. Të

kësaj gjinie kemi të përfshirë vetëm një njësi mësimore nga autori ynë Teki Dervishi. Pjesa e titulluar Lëngata e poetit është shkëputur nga drama *Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit*.

**Teki Dërvishi, Lëngata e poetit:** Në fillim të faqes kemi një paragraf që tregon edhe nga ku është shkëputur kjo pjesë. Pastaj, në katër faqe paraqitet pjesa e shkëputur nga drama. Brenda këtyre faqeve kemi portretin e një poeti, nivelin bisedojmë për tekstin me gjashtë pyetje për ushtrime, punë e pavarur, mësojmë më shumë ku mësohet veçanërisht për *dramën dhe didaskalinë*, biografinë e autorit dhe fjalorin shpjegues me këto fjalë: *jeniçer-i, kordhë-a, lëngatë-a, hafije, dert, pështjellak-u, e ndollis. datë, Loreto, Padova*.

## 6.9. Tekstet joletrare

Hapësirë të vecantë në këtë tekst kanë edhe shkrimet joletrare. Me anë të këtyre shkrimeve shpjegohen pjesë të rëndësishme që kanë për qëllim informacionin, saktësinë, kthjelltësinë dhe nevojën për komunikim të drejtpërdrejtë. Ngandonjëherë mund të vërejmë të gjuhës së tekstit letrar edhe në tekstin joletrar, por megjithatë, funksioni i gjuhës te njëri apo te tjetri është i ndryshëm dhe kësaj forca komunikuese e ndikuese është e ndryshme në tërësinë e këtyre shkrimeve.

Përmes njërive mësimore dhe pjesës tjetër të aparaturës didaktike shpjegohet: *teksti biografik, teksti përshkrues, letra publike, ditari, udhëpërshkrimi dhe shkrimi fantastiko shkencor*. Pjesët e shkëputura janë të gjitha të autorëve të huaj. Gjithsej janë gjashtë njësi mësimore: *Gjeniu i vogël* (Stefan Cvajg), *Lamtumira me Aleksandër Moisiun* (Stefan Cvajg), *Letra e kryeparit* (për Uashington), *Kjo lule e vogël* (Viktor Hygo), *Letra është më e durueshme se njerëzit* (Anna Frank) dhe *Kontinenti* (Tur Hejardal).

**Stefan Cvajg, Gjeniu i vogël:** Ky tekst me personazh Moxartin dhe i përshtatur për moshat përkatëse është paraqitur në tri faqe. Brenda këtyre faqeve kemi edhe ilustrime. Po ashtu, në fillim të këtij teksti kemi një paragraf që kërkon ushtrime. Bisedojmë për tekstin ka gjashtë pyetje për ushtrime. Niveli mësojmë më shumë kërkon të dinë më shumë për Mocartin. Kurse, gjithashtu, kemi nivelin provo edhe këtë, punë e pavarur, biografinë e autorit bashkë me fotografi dhe fjalorin me këto fjalë: *kryedykë, dukë-a, tastierë-a, indiferent, bujë*.

**Stefan Cvajg, Lamtumira me Aleksandër Moisiun:** Ky tekst informues është i paraqitur në katër faqe. Mbi këtë tekst kemi një paragraf në formë të pyetjeve për ushtrime. Kurse, në secilën faqe kemi fotografi të që paraqesin disa personazhe që ka interpretuar Aleksandër Moisu. Gjithashtu kemi edhe mendime të personaliteteve të njohura për A. Moisiun. Niveli bisedojmë për tekstin ka gjithsej gjashtë pyetje për ushtrime. Faqja e fundit ka biografinë e shkurtër të A. Moisuin bashkë me fotografinë, si dhe nivelin punë e pavarur, mësojmë më shumë, dhe fjalorin shpjegues me këto fjalë: *Fausti, Edipi, Mafistofeli, kanconetë-a, gladiator-i, delikatesë, gëlonte, pretëritëse.*

(Letër për Georg Uashingtonin), **Letër e kryeparit:** Pjesa e shkëptur nga letra paraqitet në dy faqe. Paragrafi në fillim shpjegon detaje në lidhje me këtë letër. Tlustrime kemi në dy faqe ku paraqitet letra. Niveli bisedojmë për tekstin ka gjashtë pyetje për ushtrime, pastaj është niveli bisedoni së bashku, mësojmë më shumë, punë e pavarur dhe fjalori shpjegues më këto fjalë: *kreyapri, Setlle, rezervat-i, Poni, kanu.*

**Viktor Hygo, Kjo lule e vogël:** Në fillim kemi një pyetje për ushtrime në lidhje me letrën familjare. Pastaj, paraqitet letra në faqen e parë bashkë me fjalorin shpjegues. Fjalë që shpjegohen janë: *e brishtë, rrëpirë, Tolosa.* Faqja e dytë ka nivelin mësojmë më shumë që shpjegohet letra, punë e pavarur bisedojmë për tekstin me gjashtë pyetje për ushtrime dhe një ilustrim.

**Anna Frank, Letra është më e durueshme se njerëzit:** Kjo pjesë është shkëputur nga ditari i Anna Frankut. Teksti është në formtë të ditarit dhe paraqitet në një faqe bashkë me nivelin bisedojmë për tekstin me gjithsej shtatë pyetje për ushtrime. Faqja e fundit është mësojmë më shumë, punë e pavarur, pjesa ku shpjegohet ditari dhe biografia e autores bashkë me fotografinë.

**Tur Hejrdal, Kontinenti:** Teksti në formë të udhëpërshkrimit paraqitet në faqen e parë bashkë me një detyrë ku kërkohet të krijohet një ngjarje me fjalët e kontinent, pyll, tropikal, gjirafë, majmun, Saharë. Dy faqet tjera janë me fotografi, me nivelin bisedojmë për tekstin me gjithsej nëntë pyetje për ushtrime, punë e pavarur, mësojmë më shumë. biografinë e autorit bashkë me fotografinë dhe fjalorin shpjegues me këto fjalë: *tropikal/e, tamtamet, sofate, llaku, babmujë-a, mol-i, hipopotam-i, savanë.*

## 6.10. Qasja e veçantë për elementet letrare edhe joletrare

Qasje të veçantë didaktike brenda tekstit kemi edhe për elementet letrare dhe joletrare, shpjegimet për këto elemente janë në faqet ku paraqiten ushtrimet përmes nivelit mësojmë më shumë. Këto elemente letrare e joletrare do t'i paraqesim më poshtë. Secilit element do t'ia bashkëngjisim edhe njësinë mësimore në të cilën shpjegohet si në vijim:

*Teksti*: njësinë mësimore- Malli i atdheut; *Simboli e Himni*: njësinë mësimore- Hymni i Flamurit; *Drama e Didaskalitë*: njësinë mësimore- Lëngata e poetit; *Gojëdhënat e Miti*: njësinë mësimore- Prometeu; *Hiperbola e Letërsia gojore*: njësinë mësimore- Gjergj Elez Alia; *Portreti*: njësinë mësimore- Nëna; *Teatri, dialogu, monologu*: njësinë mësimore- Lamtumira me Aleksandër Moisiun; *Metafora, aliteracioni, distiku*: njësinë mësimore:- Vrima e parë e fyellit tim; *Letra publike*: njësinë mësimore- Letër e kryeparit; *Letra*: njësinë mësimore- Kjo lule e vogël; *Ditari*: njësinë mësimore- Letra është më e durueshme se njerëzit; *Filozofia*- njësinë mësimore- Bota e Sofisë; *Udhëpërshkrimi*: njësinë mësimore- Kontinenti dhe *Shkrimi fantastiko-shkencor*: Planeti i kaltër.

## VII. ANALIZA E TË DHËNAVE

### 7. 1. Formulimi i problemit dhe qëllimet e hulumtimit

Në këtë kapitull, do të paraqesim objektin e studimit, qëllimin, hipotezat mbi të cilat mbështetet ky punim. Të dhënat do t'i analizojmë duke nxjerrë përfundime dhe rekomandime. Të dhënat do të analizohen që të trajtohen përgjigjet e mësimdhënësve lidhur me temën.

### 7. 2. Pyetjet e hulumtimit

Duke iu referuar analizës dhe të dhënave të cilat do të dalin nga ky hulumtim, synohet të përfitohen përgjigjet e këtyre pyetjeve:

- ❖ Cila është kultura e të shprehurit tek nxënësit e shkollave tona?
- ❖ Sa i njohin nxënësit autorët e letërsisë së sotme shqipe?
- ❖ Çfarë ndikimi kanë arsimtarët në formësimin e kulturës së të lexuarit dhe të shprehurit tek nxënësit?
- ❖ Sa ndikojnë prindërit në formësimin e kulturës së të lexuarit dhe të shprehurit tek nxënësit?
- ❖ Cilët janë autorët që i preferojnë më shumë nxënësit tuaj?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve do të merren nga analiza të shumta gjatë hulumtimit që do të bëhen në mënyra të ndryshme.

### 7. 3. Hipoteza

Letërsia për fëmijë nuk është e përfaqësuar mjaftueshëm në librat shkollorë të klasave 6 – 9. Shpesh hasim në përmbajtje të papërshtatshme për moshën e nxënësve. Lektyrat shkollore obligative mund të ndryshohen. Letërsia për fëmijë ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin edukativ të nxënësve, pikërisht për këtë duhet që në planprogramet shkollore të përfshihen edhe autorë tjerë dhe të suksesshëm të letërsisë së sotme.

## VIII. METODOLOGJIA E PËRDORUR

Për të studiuar/hulumtuar temën që kam përzgjedhur në mënyrë sa më të gjithëanshme dhe me në detaje, kam përdorur dy qasje hulumtuese:

1. Qasjen sasiore (kuantitative) hulumtuese dhe 2. Qasjen cilësore (kualitative) hulumtuese

Qasjen sasiore (kuantitative) e kam përdorur për të hulumtuar, analizuar dhe prezantuar të dhënat në aspektin e të gjeturave statistikore, materialeve dhe literaturës se ndryshme në lidhje me temën time që ka kontribuar në verifikimin dhe konfirmimin e tezës kryesore të temës sime. Ndërsa qasjen cilësore (kualitative) e kam përdorur për të marrë opinionet nëpërmjet intervistave, fokus grupeve më aktoret që janë të lidhur direkt me temën time, si me mësimdhënësit, nxënësit, shkrimtarë, studiues të fushës së letërsisë dhe njohës të tjerë.

**Metoda e analizës teorike** - është njëra nga metodat të përgjithshme, e cila zbatohet në të gjitha format e hulumtimit, prandaj gjënë zbatim edhe në temën time. Përmes kësaj metode kam studiuar, analizuar materialet, punimet shkencore profesionale dhe mendime të ndryshme që ndërlidhen me interesin e temës dhe ndihmojnë në realizimin e tezave të saj.

**Metoda e vëzhgimit apo observimit** - është njëra nga metodat më të ndërlikuara, ku në shprehje vije aftësia e studiuesit për të vëzhguar. Nuk e di sa kam arritur të përdor drejt dhe duhur këtë metodë, por përmes kësaj metode jam përpjekur të shoh atë që “nuk kam mundur” ta marrë nga literatura dhe teknikat tjera të hulumtimit. Metoda e vëzhgimit më ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë në të kuptuarit të dyanshëm të thelbit të temës sime, pasi që unë për me shumë se njëzetë vite ushtroj profesionin e mësimdhënëses.

### 8.1. Realizimi i pyetësorit

Hulumtimi ynë është realizuar në tri shkolla fillore në Suharekë: SHFMU “7 Marsi”, mësimdhënësi: Afërdita Zenelaj; SHFMU “Shkëndija” mësimdhënësi: Elfie Berisha; dhe, SHFMU “Destan Bajraktari” mësimdhënësi: Hava Berisha.

## IX. REZULTATET E STUDIMIT

Pyetësi i përgatitur për mësimdhënës përmban 5 pyetje.

Në pyetjen e parë: **Cila është kultura e të shprehurit tek nxënësit e shkollave tona?** 2 mësimdhënës apo 66.66% kanë zgjedhur si përgjigje opsionin *b* (*nuk janë shumë të përfaqësuar*), ndërsa 1 (33.33%) ka zgjedhur opsionin *c* (*deri diku*).

Në pyetjen 2: **Sa i njohin nxënësit autorët e letërsisë së sotme shqipe?** Janë përgjigjur të 3 mësimdhënëset ose 100% për opsionin *c* (*deri diku*).

Në pyetjen 3: **Çfarë ndikimi kanë arsimtarët në formësimin e kulturës së të lexuarit dhe të shprehurit tek nxënësit?** Janë përgjigjur të 3 mësimdhënëset (100%) se është mjaftueshëm i merituar vendi i tyre (autorëve) në planprograme.

Në pyetjen 4: **Sa ndikojnë prindërit në formësimin e kulturës së të lexuarit dhe të shprehurit tek nxënësit?** Përgjigja nga të 3 mësimdhënëset: Prindërit kanë rol kyç në kultivimin e dëshirës për të lexuar tek fëmijët.

Përgjigja nga 3 mësimdhënëset në pyetjen 5: **Cilët janë autorët që i preferojnë më shumë nxënësit tuaj?** ishte që autorët që preferohen më shumë nga nxënësit janë: autorët e krijimeve me tema sociale.



## X. PËRMBLEDHJE

Teksti shkollor i letërsisë është burim themelor për përvetësimin e njohurive. Ai zhvillon tek nxënësit, interesat mësimore për letërsinë, aftësinë e punës së pavarur e krijuese. Shkolla e sotme, mësimi i letërsisë, kërkojnë aso tekstesh shkollore, të cilat, me përmbajtjen e tyre, me mënyrën e trajtimit të problemeve, udhëzojnë dhe i ndihmojnë subjektet kryesor në mësim nxënësit, që t'i qaset kreativisht veprës letrare, letërsisë. Letërsia si lëndë mësimore përfshihet me program në të gjitha kategoritë e shkollave në mënyrë të vijueshme:

- Këndimi në klasat I-IV të ciklit të ulët;
- Lexim letrar në klasat V-VII të ciklit të lartë të shkollës fillore dhe
- Histori e letërsisë në klasat I-IV të shkollës së mesme.

Shumë studime që i janë kushtuar rrjedhave zhvillimore të reformave shkollore në botë dhe tek ne dëshmojnë se në procesin mësimor asgjë nuk mund ta zëvendësojë tekstin shkollor. Teksti shkollor i letërsisë është një nga përbërësit e rëndësishëm që ndikojnë dukshëm në formimin e tërësishëm të personalitetit të nxënësit. Sistemi i njohurive shkencore që përmbanë teksti shkollor, përshtatja e tij, karakteristikave të moshës, ndikon në zhvillimin e të menduarit të nxënësve, në pajisjen e tyre me aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur me librin, në formimin e tyre në drejtim të lëndës që përfaqëson tekstin. Teksti shkollor i letërsisë gjatë këtij gjysmëshekulli është ndertuar në lidhje me specifikën e shkollës, shtrirjen, kohën dhe klasën së cilës i është dedikuar tekstin, kërkesa këto që përcaktohen me programin mësimor.<sup>1</sup>

Ky konstatim vlen për tekstet e shkollës fillore e jo edhe për ato të shkollave të mesme, sepse për një kohë të gjatë në praktikën shkollore i njejtë tekst i letërsisë i dedikohej tipave të ndryshëm të shkollave të mesme. Përmbajtja, vëllimi, mënyra e mbarështrimit të lëndës koncentrike apo lineare, synimet etj, përcaktohen dhe trajtohen në programin mësimor, duke pasur parasysh veçoritë e moshës, qëllimin etj (Rexhepi, N, 2002).

Qëllimi dhe detyrat që pikësynon tekstin janë të llojllojshme, si:

- Zhvillimi i aftësive për ta përjetuar të bukurën;
- Zhvillimi i vlerave estetike, etike, gjuhësore-stilistike;
- Zhvillimi i kulturës së leximit;
- Zhvillimi i kulturës së të shprehurit;

- Zhvillimi i aktiviteteve mendore dhe i aftësive të punës;
- Aftësimi për punë të pavarur etj.

Teksti shkollor i letërsisë, krahas faktorëve të tjerë, në procesin e mësimin të letërsisë, përmban mundësi specifike që t'i japë nxënësve të shkollës fillore e të mesme dije letrare e teorike të një niveli të pëlqyeshëm. Pikësynimi i përpiluesit të tekstit të letërsisë është që nxënësi të pajiset me kulturë të domosdoshme letrare që të hyjë në jetë si qytetar i formuar nga ana letrare artistike. Letërsia si një nga llojet e artit, ka një forcë të madhe emocionale, që po ta drejtojmë si duhet bëhet një mjet i fuqishëm për edukimin estetik të nxënësve. Kjo mund të realizohet duke përfshirë në tekstet shkollore krijime me vlera të qëndrueshme artistike. Tekstet e zgjedhura letrare të përfshira në librat e leximit, ushtrojnë ndikim në zhvillimin e sensibilitetit, i aftësojnë nxënësit në artin e leximit dhe për ta përjetuar veprën artistike. Teksti i letërsisë duhet të ndërtohet në atë mënyrë që të edukojë tek nxënësit kuptimin e drejtë të së bukurës, i cili duhet t'i shpjerë në përpunimin e shijevë, në përcaktimin e kritikave të vlerësimit artistik të veprave letrare (Rexhepi, N, 2002).

Sipas pikëpamjeve didaktike mbi mësimin e letërsisë, duke u nisur nga dy mundësitë e njohjes së botës: racionale dhe estetike, punën kryesore e shohin në sistemimin dhe përcaktimin e raportit midis tyre. Sipas një rregulli teksti duhet t'u ofrojë të vegjëlve anën estetike emocionale, ndërsa në rastin e dytë, mbi bazën logjike. Teorikisht për ne ka qenë gjithnjë e qartë se mësimi i letërsisë duhet të jetë një proces që zgjatë gjatë gjithë kohës së shkollimit fillor e të mesëm, që do të duhej t'u ndihmonte nxënësve ta kuptojnë dhe të dinë ta interpretojnë letërsinë. Por, në fakt, në tekstet shkollore të letërsisë kjo nuk është realizuar plotësisht, sepse tekstet përfshiheshin në proceset shoqërore dhe nuk mund të mbetnin jashtë atij interesi, jashtë nevojave dhe perspektivave zhvillimore, sepse shkolla si institucion edukativo-arsimor, bashkë me tekstin shkollor, bëhen faktorë të rëndësishëm në jetën shoqërore.

Në tekstet shkollore të letërsisë autorët kanë pasur parasysh kategorinë e shkollës e të moshës së nxënësve. Kështu, në tekstet e shkollës fillore ka mbizotëruar materiali konkret, faktet, ngjarjet dhe fenomenet si dhe sqarimi dhe interpretimi elementar, në përputhje me aftësinë psiko-fizike të nxënësve (Rexhepi, N, 2002).

Në to nuk ka konkluzione të veçanta, as edhe ballafaqime të kundërta mendimesh, pasi që zhvillimi dhe formimi i përgjithshëm i tyre nuk e lejon këtë. Ndërsa, në tekstet shkollore të mesme janë bërë përpjekje për të ngritur nivelin teorik dhe shkencor të përzgjedhjes, të sistemit dhe të interpretimit të lëndës. Po edhe këtu duhen bërë ndryshime në përmbajtjen, në strukturën e në metodat që përdoren në tekst për shtjellimin e lëndës së letërsisë.

Nga rezultatet e këtij hulumtimi të realizuar në disa shkolla të ndryshme nëpër Kosovë, del se gjendja e teksteve të Leximit letrar VI dhe VII në aspektin didaktik nuk është e nivelit të kënaqshëm. Edhe nga anketa me mësimdhënës, edhe nga anketa me nxënës, në një rëndësi anë, kemi mendime tejet pozitive për këto tekste dhe, në anën tjetër, kemi mendime tejet negative për këto tekste. Gjithsesi, vlerësimet mesatare zënë vendin kryesor në këto anketa, gjë që para se të theksojmë domosdonë e ndryshimit të këtyre teksteve, duhet ta theksojmë fuqishëm rishikimin e këtyre teksteve me kriteret e larta shkencore, pedagogjike, didaktike e psikologjike.

Në bazë të këtyre rezultateve, para nesh, dalin disa shqetësime serioze në lidhje me këto tekste. Këto shqetësime janë thelbësore për mbarrëvajtjen cilësore të procesit arsimor, sepse tekstet në fjalë përdoren në të gjitha shkollat e Kosovës. Në rast se një pjesë e madhe e eksponentëve, edhe pas rishikimeve të bëra nga MASHT-i, shprehen se në tekste ka numër të konsiderueshëm të gabimeve drejtshkrimore, paqartësi në përzgjedhjen e ilustrimeve, pakuptueshmëri në shtrimin e pyetjeve për ushtrime, si dhe mungesë të madhe në cilësinë e përmbajtjeve, atëherë shqetësimet duhet patjetër të përkthehen edhe në veprime konkrete, ku shmangia e këtyre problemeve të bëhet me prioritet të madh nga kushdo që ka përgjegjësi.

Shikuar edhe nga ky hulumtim, pikat takuese dhe pikat dalluese, dalin natyrshëm në përputhshmëri edhe me punën e bërë në kapitullin pararendës. Pikëtakimet e, veçmas, pikëdallimet duhet të shërbejnë në të ardhmen, jo për thellimin e mospërputhshmërisë, por për qëllimin e përputhshmërisë në dobi të përvetësimit të aspekteve pozitive nga cilido tekst shkruar në mënyrën e vet.

Nga qasja krahasimtare del se tekstet e leximit letrar, të hartuesve e botuesve të ndryshëm, përpos pikëtakimeve, kanë edhe pikë dallime të theksueshme. Në fakt, pikëtakimet janë të kuptueshme, sepse të gjitha tekstet shkollore, pra edhe të leximit letrar, i nënshtrohen një

procedure të njëjtë të miratimit nga ana e MASHT. Mirëpo, pikë dallimet e, veçanërisht, pjesët që mungojnë te njëri apo tjetrit tekst janë të pashpjegueshme.

Për ta sqaruar më qartë psenë e pashpjegueshmërisë është mungesa në tërësi e disa pjesëve të aparaturës didaktike te njëri tekst, e jo mënyra e qasjes së këtyre pjesëve të secili tekst. Pra, në rast se te njëri tekst kemi detyra, te tjetri tekst nuk kemi pothuajse fare. Po ashtu, në rast se te teksti i Leximit letrar VI e kemi punën me tekstin të ndarë në nivele e të sqaruar qartësisht, te Leximi letrar VII nuk e kemi këtë gjë. Sikundër që kemi pjesë krejtësisht të ndryshme, si p.sh.: respektimi i parimeve didaktike në mënyrën e përzgjedhjes së njësive mësimore apo në përzgjedhjen e ilustrimeve. Gjithashtu, struktura didaktike në këto tekste dallon kryekëput edhe në pjesën që shpjegon mbi cilat kritere është hartuar teksti apo udhëzime për përdorimin e tekstit.

Sidoqoftë, dallimet e gjetura në këto tekste, veçmas ato të pjesës përmbajtjesore e didaktike, duhet të orientohen drejt frymës bashkëpunuese të hartuesve dhe të botuesve. Praktikrat e mira duhet të pranohen nga të gjithë. Në këtë drejtim rol vendimtar kanë edhe ekspertët e angazhuar nga MASHT-i, të cilët assesi nuk duhet të lejojnë dallime të theksueshmë në gjërat thelbësore mbi kriteret e hartimit të teksteve shkolllore. Në rast se këto kritere nuk plotësohen, lejimi për përdorim nuk duhet të jepet.

## XI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky punim përfshin vetëm varfshin vetëm kategori të veçanta studimi, siç janë: *I- përfaqësimi i letërsisë së traditës në librat shkollor, II- poezia për fëmijë në librat e ciklit të ulët, III-proca tregimtare dhe përralla, IV- shtresimet pedagogjike dhe vlera estetike*, duke provuar që në bazë të kapitujve në urë të përfshihen çështjet esenciale të këtyre teksteve të leximit për ciklin e ulët. Letërsia nga fëmijë, shikuar nëpër fazat e zhvillimit të saj, ka veçoritë tematike e posaçërisht shqipe për fëmijë, shikuar nëpër faza ideore përballë kohëve nëpër të cilat ka kaluar.

Tekstet e letërsisë shqipe për ciklin e ulët të shkollës fillore janë hartuar dhe mbështetur në planin dhe programin mësimor për këtë lëndë, të miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës.

Nga lëmi i letërsisë janë përfshirë krijime të zgjedhura të autorëve tanë dhe të huaj si dhe nga krijimtaria gojore, të cilat kryesisht janë në funksion të të mësuarit të nocioneve të planifikuara teorike, letrare e gjuhësore.

Ndarja e njësive në disa cikleve të veçanta është shumë e lirë; pra nuk nënkupton ndonjë ndarje sipas zhanreve apo tematikës së përmbajtjeve mësimore. Secili cikël përfshin disa nga njohuritë e nevojshme të parapara me program dhe realizimin e objektivave të caktuara. Në planifikim e tyre është pasur kujdes edhe për dinamikën e mundshme të realizimit të programit në punën praktike pedagogjike. Si i tillë ky tekst do t'u shërbejë si nxënësve ashtu edhe mësuesve. Nxënësve përveç se do t'u ofrojë njohuri themelore për mësimet e parapara, me detyra të dhëna për punë individuale dhe në grupe dhe me aparaturë pedagogjike që i shoqëron njësitë mësimore, ata do të nxiten për punë krijuese dhe për depërtime të tjera në lëmin e mësimin dhe të shfrytëzimit të një literaturë edhe më të gjerë, të preferueshme për shkallën e përgatitjes së tyre.

Duke pasur parasysh që kjo temë nuk është trajtuar aq sa duket, jam munduar që gjatë punimit tim, sa do pak të kontribuoj në përgatitjen sa më të mirë të fëmijëve tanë, duke i vlerësuar të gjitha krijimet letrare që gjenden në tekstet e leximit letrar të ciklit të ulët të shkollës fillore.

Në këto tekste shkollore përfshirja e gjinive, llojeve dhe zhanreve letrare si lloje të zhvilluara është në nivel të kënaqshëm dhe në përputhshmëri me moshat përkatëse. Po ashtu, edhe tekstet joletrare janë mjaftueshëm të pranishme, ani pse pjesërisht shpjegimet, referencat e ilustrimet nuk përkrijnë me përmbajtjet e tyre.

Ndërkaq, opinionet e respondentëve veç çka e vulosin të gjithë punën paraprake në këtë punim. Simetrinë logjike dhe faktike të këtij punimi e përforcojnë shumë edhe përgjigjet e studentëve. Ata, pra mësimdhënësit dhe nxënësit, përmes përgjigjeve të tyre në pyetjet e shtruara nga ne, përpos që kanë nxjerrë si çështje imediate rishikimin e këtyre teksteve, kanë nxjerrë në mënyrë të natyrshme edhe pikëdallimet e theksueshme. E veçantë në këto përgjigje del edhe kërkesa për domosdoshmërinë e përfshirjes më të madhe të mësimdhënësve në hartimin e teksteve shkollore. Kurse, kërkesat e mësimdhënësve, po edhe të nxënësve për ndryshime përpos që janë tejet interesante, janë në shumicën e rasteve edhe të domosdoshme.

Në fund, vetë pasqyra reale e paraqitur në detaje brenda këtyre dy teksteve shkollore, si dhe krahasimi e opinionet e respondentëve, duke u bazuar edhe në mendimet bashkëkohore të studiuesve, nxjerrin boshllëqe që pa pikë problemi mund të mbushen me elemente cilësore. Sikundër që, pashmangshëm dalin edhe pikëtakimet në mes këtyre dy tekste, e që për ne është krejtësisht normale, sidomos në pjesën e aparaturës didaktike, e cila duhet t'i përmbahet kritereve të njëjta që parashtron Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Nga mendimet e studiuesve të shumtë, nga gjetjet në tekste, nga krahasimi i këtyre gjetjeve dhe nga opinionet e respondentëve, dalin elemente të rëndësishme pikëtakuese e pikëdalluese që kontribuojnë drejtpërdrejt në pasurimin e tekstit mësimor. Saktësisht, këto mendime, gjetje, krahasime e opinione për tekstet letrare duhet të bëhen si udhërrëfyese për tekstet në të ardhmen.

Mendimet e studiuesve për tekstin mësimor, rëndësinë e aparaturës didaktike dhe rolin e tersise në shkolla, janë mendime dritëdhënëse që para çdo hartuesi duhet të bëhen abc-ja e përpilimit të një teksti. Kur ke kuptuar rëndësinë e aparaturës didaktike në tekstin mësimor, si dhe kur ke kuptuar rolin e letërsisë në shkolla, pa dyshim që, ke kuptuar teknikën përmbajtjesore për hartimin e një teksti shkollor. Një udhërrëfyese të qartë e nxjerrim nga kapitulli i parë, ku vështrimi teorik mbi lëndën kryesore të këtij punimi, nënkupton lëndën kryesore për hartimin e një teksti të mirëfilltë shkollor.

Gjetjet në tekstet e Leximit letrar VI dhe VII janë bërë përmes metodës përshkruese, ku mendësia e aparaturës didaktike është përshkruar në detaje. Nga këto gjetje del se përpos cilësive mund t'i hasim brenda këtyre dy teksteve, kemi edhe zbrazëtira që patjetër duhet të përmbushen. Këto zbrazëtira i gjejmë që nga mënyra e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore e sier të shtrimi i pyetjeve për ushtrime. Zbrazëtirat e gjetura brenda këtyre teksteve marrin kuptim më thelbësor kur krahasohen në mes vete. Nga krahasimi i këtyre gjetjeve dalin pikëtakime e mitadallime. Ajo që vlen të theksohet, e që i japin specifikë punimit, janë pikëdallimet e gjetura përmes metodës krahasimtare. Këto dallime janë të theksueshme jo vetëm për shkak të autorëve e botuesve të ndryshëm, por edhe për shkak të respektimi apo mosrespektimit të standardeve bashkëkohore për hartimin e një teksti. Në rast se te njëri tekst kemi një pjesë të rëndësishme të aparaturës didaktike, te tjetri tekst nuk kemi pothuajse fare. Sidokudo, gjetja e dallimeve në këto tekste nuk është bërë për ta kritikuar njërin apo tjetrin tekst, por është bërë që me anë të këtyre gjetjeve të ndihmojmë drejt orientimit bashkëpunues të tekstshkruesve dhe respektimin e standardeve bashkëkohore për hartimin e një teksti.

Edukimi estetik në shkollë dhe mësimi i letërsisë (në shkolla dhe jashtë saj), kërkon harmonizimin e tyre, me kërkesat që shtron moshë, koha dhe jeta sot. Në këtë kohë ndryshimesh të mënyrës së jetesës, në mes të modernizimit të pakontrolluar të çdo aspekti jetësor, edukimi estetik, ndoshta do të ishte forma më efektive, që do të ndikonte në formimin më të drejtë e më të gjithanshëm, të njeriut tonë të ri. Pra, shtohet nevoja për angazhimin e të gjitha llojeve të pedagogjisë e edhe të asaj letrare, për t'iu përshtatur vetëdijes, ndërgjegjes dhe zhvillimit të botëkuptimit tonë, shpirtëror e kulturor. (Kadare në një intervistë thotë: “Shqiptarët sot kanë nevojë më shumë se kurrë për një rilindje morale, sepse edukata shpirtërore, kulturore, personale, është baza nga e cila zhvillohet gjithçka tutje”). Lidhur me këtë dimension edukimi, nga analizat empirike në shkollë, arrijmë te konstatimet që, edukimi estetik e letërsia si art i veçantë edukativo-pedagogjik, me gjithë vlerën e pazëvendësueshme që ka për fisnikërimin shpirtëror, emocional e jetësor në përgjithësi, nuk trajtohet në mënyrë të mirëfilltë, që nga familja, mësuesi, institucionet shkollore, politika arsimore dhe shoqëria. Ky fakt, mund të shkaktojë mungesën e lexuesve fëmijë, demotivimin e krijuesve të letërsisë për fëmijë dhe neglizhencën e kritikës letrare ndaj kësaj letërsie. Mos leximi i letërsisë, shkakton

mangësi të pakompensueshme, në formimin e personalitetit më të plotë të fëmijës-nxënësit dhe në perspektivën më fisnikëruese të shoqërisë.

Në librat letrarë, fëmija ka të pasqyruar në mënyrë të thjeshtë e reale (konform kapaciteteve të tyre perceptuese) situata jetësore nga më të ndryshmet, me kompleksitetin e tyre, të cilat edhe po të jetonte njeriu me shekuj, nuk do të mund t'i haste. Prandaj, në mungesë të edukimit estetik, e brenda këtij edhe edukimit etik e moral (këto kategori nuk i kanë ndarë plot filozofë dhe estetë botërorë), pasojnë çrregullime esenciale të personalitetit të fëmijës, ai pastaj mund të orientohet kah fenomenet degjeneruese, që shpijnë deri te devijimet e natyrave të ndryshme, të cilat i shohim me të madhe në përditshmërinë e familjes, shkollës dhe shoqërisë sonë. Kjo ndodh, sepse në kohën tonë, si çdo gjë tjetër, janë politizuar e komercializuar edhe arti letrar dhe tekstet shkollore. Kjo ka bërë që të kemi lexues të paformuar, që lexuesit t'i dëmtohet e t'i prishet edhe shija e tij, dhe të dëmtohet edhe kultura shoqërore në përgjithësi. Nuk ka tash, shumë dhunti për krijim, sa ka shumë dhunti për përfitim material. Materializimi i gjithçkaje, komercializimi i jetës në tërësi, ei çdo aspekti të jetës në veçanti, e shtynjë edhe nxënësin të mendojë, vetëm për anën materiale, që i sjell dobi atij (d.m.th. obsesion nënkuptues, edhe nxënësit kanë kënaqësinë, pushtetin, paranë...). Kështu, edhe shkolla është e fiksuar më shumë në treg të punës, duke e përforcuar edhe më tej këtë boshësi edukative dhe estetike. Sepse, nxënësi formohet-rritet, i kushtëzuar me idenë fikse, se gjithçka duhet t'i shërbejë diçkaje tjetër dhe gjithësesi të jetë e dobishme materialisht. Kjo shkakton mjerimin estetik dhe etik të shoqërisë. Në këtë situatë krizash, të shumanshme shoqërore, është tepër i rëndësishëm edukimi shpirtëror i nxënësve dhe ndërgjegjësimi i tyre, përmes mënyrës më spontane, më sublime, përmes metodës së edukimit estetik (e artit letrar në veçanti), e cila është një mënyrë e veçantë, e këndshme, e thellë dhe e qëndrueshme e edukimit. Kur është fjala për nivelin e edukimit estetik, të fëmijëve-nxënësve dhe te njeriut tonë në përgjithësi, rreziku më i madh është, te neglizhimi i këtij lloj edukimi nga ana e kompetentëve tanë arsimorë, përderisa shkenca e pedagogjisë moderne, edukimin estetik, nuk e sheh vetëm përbrenda kufijve të artit, por edhe jashtë tij, tek e bukura në natyrë, në shoqëri dhe në jetë përgjithësisht.

Realizimi i këtij punimi, është bërë duke i kombinuar dy lloje të studimit (literatura përkatëse dhe të dhënat empirike të dala nga mulumtimi në shkolla). Kjo ka mundësuar që përmbajtja



dhe konstatimet e punimit, të jenë origjinale dhe të reflektojnë gjendjen reale, në të cilën ndodhet objekti ynë i studimit. Thënë më konkretisht, konkludimet përfundimtare janë:

1 - Është evidentuar rëndësia dhe roli i pazëvendësueshëm i edukimit estetik në formimin e personalitetit të fëmijës.

2 - Janë paraqitur disa nga veçoritë e letërsisë për fëmijë, e si më e veçanta e saj është që, kjo letërsi nuk është art i pastër letrar, por është edhe pedagogji e ndonjëherë edhe didaktikë.

3 - Është reflektuar përciptazi mbi disa lëshime profesionale në përpilimin e teksteve shkollore të letërsisë

4 - Është konstatuar (në bazë të komunikimit me bibliotekat e shkollës dhe me mësimitdhënësit) se lista e lekturës shkollore, është pothuajse e pandryshuar me dekada, apo ka ndryshuar pak e në ndonjë rast, ndryshimet e bëra, kanë bërë që ajo të mos përkojë me moshën e nxënësit as me kapacitetet intelektuale e psikike të tyre.

5 - Të dhënat nga shkolla, kanë vërtetuar se edukimi estetik dhe leximi i letërsisë, përveç në karakterin dhe personalitetin e nxënësit, ndikon edhe në suksesin e përgjithshëm të tij në shkollë.

6 - Po ashtu nga intervistat me mësimitdhënësit, kanë dalë fakte se mësimitdhënia e letërsisë, në shumicën e rasteve, zhvillohet në mënyrë tradicionale e shumë pak, është në funksion të edukimit estetik e stilistik.

Rekomandim i përgjithshëm: Ndërgjegjësimi i institucioneve shoqërore, edukative dhe familjeve, për krijim dhe konsumim më të madh të letërsisë për fëmijë, në mënyrë që më pas të konsumohet edhe letërsi për të rritur (sepse lexuesi i rritur krijohet që në fëmijëri), e si rezultat i kësaj, të kemi shoqëri më të fisnikëruar, më të avancuar emocionalisht, shpirtërisht, moralisht e intelektualisht, d.m.th. të kemi shije, nevojë e motiv për të bukurën, krahas nevojave të tjera të jetës.

## XII. LITERATURA

- Aliu, A. (1986). Teoria e letërsisë. Prishtinë: Rilindja.
- Bishqemi, A. (2008). Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinjë. Elbasan: Aleksander Xhuvani.
- Boriqi, H. (1977). Formimi i letërsisë së re gjatë viteve 1945-1960. Nëntori nr. 4/1977.
- Brada, R. (2005). Edukimi. Prishtinë.
- Dedja, B. (1978). Shkrime mbi letërsinë për fëmijë. Tiranë.
- Deva, A. (1982). Poezia shqipe për fëmijë, 1872-1980. Prishtinë: Rilindja.
- Elshani, Y. (1985). Rruga e zhvillimit të poezisë shqipe. Prishtinë: Jeta e Re nr. 3.
- Grup autoresh. (1978). Pedagogjia. Zagreb.
- Grup autoresh. (2006). Arsimi bazik cilësor. Prishtinë: Qendra për Arsim në Kosovë.
- Grup autoresh. (2008). Letërsia në shkolla dhe fakultet. Prishtinë: IAP.
- <http://www.gjuhashqipe.net/albanologji/albanologji.aspx?id=275>, qasur me 26.05.2018 . (a.d.).
- <http://www.gjuhashqipe.net/albanologji/albanologji.aspx?id=275>, qasur me 26.05.2018 . (a.d.).
- <http://www.gjuhashqipe.com/sg/Albanologji/Letërsia-moderne-shqiptare>, qasur me 26.05.2018 . (a.d.).
- <http://www.gjuhashqipe.com/sq/Albanologji/Letërsia-moderne-shqiptare>, qasur me 26.05.2018 . (a.d.).
- <https://adriana-letersia.blogspot.com/p/letersia-e-moderne.html>, qasur me 26.05.2018 . (a.d.).
- <https://adriana-letersia.blogspot.com/p/letersia-e-moderne.html>, qasur me 26.05.2018 . (a.d.).
- Matoshi, H. (2008). Mjeshtërit themelore të mësimdhënies.
- Musai, B. (2003). Metodologjia e mësimdhënies. Tiranë.
- Qemiri, B. (2011). Letërsia për fëmijë. Në G. f. autorve, *Rozafa* (f. fq. 85). Prishtinë.
- Qosja, R. (2006). Realiteti i shpërfillur. Prishtinë.
- Qosja, R. (1986). Historia e Letërsisë Shqipe III. Në Romantizmi. Prishtinë: Rilindja.
- Rexhepi, N. (2002). Letërsia Shqipe në tekstet shkollore të Kosovës 1945-1990. Prishtinë: Logos.
- Shita, V. (1980). Gjurmët e letërsisë. Prishtinë: Rilindja.
- Statovci, S. (2005). Kritika.

- Vinca, A. (1985). Qasje. Rilindja.
- Zejnullah, Rr. (2009). Gjurmët e letërsisë. Prishtinë: Rilindja.
- Zuna, A. (2009). Partneriteti shkollë familje komunitet. Prishtinë.
- Aliu, Ali: Kritika, “Rilindja”, Prishtinë, 1980
- Berisha. Anton Nikë: “Poeza për fëmijë e Mark Krasniqit”, “Faik Konica”, Prishtinë, 2002
- Bishqemi, Astrit: “Hyrje në Teorinë e letërsisë për fëmijë”, “Sejko”, Elbasan, 2004
- Bishqemi, Astrit: “Historia e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj”, “Sejko”, Elbasan, 2008
- Bishqemi, Astrit: “Autorë të letërsisë shqiptare për fëmijë”, Tiranë, 2009
- Çaushti, Tefik: Fjalori I Estetikës, “Onufri”, Tiranë, 1998
- Dedaj, Bedri: “Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1971
- Dedja, Bedri: “Burimet e letërsisë shqipe për fëmijë”, “Rilindja”, Prishtinë, 1978
- Demiri, Qibrije-Frangu: “Letërsia për fëmijë (gjeneza, fenomene, autorë)”, “Rozafa”, Prishtinë, 2011
- Deva, Agim: “Poezia shqipe për fëmijë (1872-1980)”, “Rilindja”, Prishtinë, 1982
- Duraku, Nebil: “Shkrimtarët shqiptarë të Kosovës, -48-83”, “Rilindja”, Prishtinë, 1984
- Elsie, Robert: “Historia e letërsisë shqiptare”, “Dukagjini”, Pejë, 2001
- Lishani, Ymer: “Aspekte të poezisë sonë për fëmijë (1945-1976)”, “Andena”, Prishtinë, 2013
- Eco, Umberto: “Si shkruaj”, “Aikd”, Prishtinë, 2003
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, ASHSH dhe IGJL, Tiranë, 2005
- Grillo, Odhise: “Shkrimtarët shqiptarë për fëmijë (leksion)”, botimet enciklopedike, Tiranë, 1997
- Grillo, Odhise: “Panoramë letrare, 3”, Tiranë, 2000
- Grup autorësh: “Letërsia në shkolla dhe në fakultet”, IAP, Prishtinë, 2008
- Halili, Erenestina: “Triologji ilire - Teuta, Pirua, Genci - e Ymer Shkreli”, Tiranë, 2012
- Hasani, Hasan: “Leksikon i shkrimtarëve shqiptarë, 1501-2001”, “Faik Konica”, Prishtinë, 2003

### XIII. SHTOJCA

Pyetësor i realizuar me mësimdhënësit e Gjuhës dhe letërsisë shqipe:

1. Cila është kultura e të shprehurit tek nxënësit e shkollave tona?	a. Janë shumë të përfaqësuar b. Nuk janë shumë të përfaqësuar c. Deri diku
2. Sa i njohin nxënësit autorët e letërsisë së sotme shqipe?	a. Po b. Jo c. Deri diku
3. Çfarë ndikimi kanë arsimtarët në formësimin e kulturës së të lexuarit dhe të shprehurit tek nxënësit?	a. Mjaftueshëm i merituar vendi në program b. I pa merituar sa duhet c. Pak i merituar
4. Sa ndikojnë prindërit në formësimin e kulturës së të lexuarit dhe të shprehurit tek nxënësit?	a. Shumë (rol kyç) b. Pak c. Deri diku
5. Cilët janë autorët që i preferojnë më shumë nxënësit tuaj?	a. Temë dashurie b. Temë patriotike c. Temë sociale